

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

FIGURA POLIEDRIKE E PROFESOR XHEVAT GEGËS

(tribunë shkencore – 1 shtator 2021)

34



Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 34 – 2022
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Hidajete Azizi

Këshilli redaktues:
Avzi Mustafa
Sevdail Demiri
Zeqirija Ibrahimi
Shpresa Purde–Memedi

Sekretar i redaksisë:
Laura Papraniku Bejtullau

Copyright©ITSHKSH, 2022
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–57–6
www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:

Република Северна Македонија
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Kulturës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

FIGURA POLIEDRIKE
E PROFESOR
XHEVAT GEGËS

(tribunë shkencore – 1 shtator 2021)

34

SCUPI

Shkup, 2022

PËRMBAJTJA:

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM	9
FJALË PËRSHËNDETËSE	15
– SKENDER ASANI	17
– YLBER SELA	19
– ISMET OSMANI	21
– LEONTINA GEGA–MUSA	23
– ARBEN GEGA	27
 KUMTESA	 29
Avzi MUSTAFA: PROF. DR. XHEVAT GEGA MODEL NJERIU, PEDAGOGU E SHKENCTARI	31
Hysen MATOSHI: NAIM FRASHËRI DHE GRIGOR PËRLIÇEVI NË STUDIMET E PROFESOR XHEVAT GEGËS	40
Xheladin MURATI: PROFESOR XHEVAT GEGA, ME MISION KONKRET PËR ARSIMIN, GJUHËN DHE KULTURËN	46
Zeqirja NEZIRI: XHEVAT GEGA PROFESOR DHE STUDIUES I LETËRSISË SHQIPE.....	53
Nebi DERVISHI: STRUGANI PROF. DR. XHEVAT ISMAIL GEGA – NJË GJYSMË SHEKULLI JETË DUKE KALITUR GJENERATA	57
Haki YMERI–BINA: PROFESOR XHEVATI, PEDAGOGU SI AI .	68
Asllan HAMITI: PROFESOR XHEVAT GEGA – GOJËTAR I SHQUAR	73

Ismet OSMANI: RRETH NDIHMESAVE TË PROFESOR XHEVAT GEGËS PËR GJUHËN DHE LETËRSINË SHQIPTARE	79
Mirlinda KRIFCA BEQIRI: KONTRIBUTI I PROF. XHEVAT GEGËS NË FUSHËN E STUDIMEVE LETRARE	83
Valbona TOSKA: PROF. XHEVAT GEGA DHE GJUHA SHQIPE	91
Berton SULEJMANI: PROFESOR XHEVAT GEGA BASHKAUTOR I GRAMATIKAVE TË SHKOLLAVE FILLORE.....	98
Afrim REXHEPI: KRITIKA LETRARE E XHEVAT GEGËS	107
Ajten HAJDARI QAMILI: PROF. XHEVAT GEGA PËR KULTURËN E GJUHËS DHE NORMËN LETRARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	115
Zeqirija IBRAHIMI: ILUMINISTI XHEVAT GEGA.....	122
Sevdail DEMIRI: XHEVAT GEGA, NJË GAZETAR I GUXIMSHËM DHE MJESHTËR I FJALËS SË SHKRUAR	129
Hidajete AZIZI & Laura PAPRANIKU BEJTULLAU: ABETARJA E PROFESOR XHEVAT GEGËS VAZHDIMËSI E ABETAREVE SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT	137
Shpresa PURDE MEMEDI: XHEVAT GEGA – KOLOS I ARSIMIT SHQIP.....	148
Farketa DIBRA–ZEQIRI: ZBATIMI I METODËS ANALITIKE – SINTETIKE NË ABETAREN E PROFESOR XHEVAT GEGËS ...	156
Lindita AHMETI: EROTIKA SI HARMONI E BOTËS NJERËZORE.....	177
SHTOJCË	185



Prof. Dr. Xhevat Gega (1934 – 2017)

DY FJALË PËR KËTË VËLLIM

Vëllimi 34 i edicionit “Scupi” vjen në dorë të lexuesit si përmbledhje e kumtesave të prezantuara në tribunën shkencore “Figura poliedrike e profesor Xhevat Gegës” e organizuar më 1 shtator të vitit 2021 nga ana e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Synimi i Këshillit organizues në krye me prof. Avzi Mustafën, për të përkujtuar, nderuar e vlerësuar ndihmesën e prof. Xh Gegës si një trashëgimi e çmuar për brezin e sotëm, u jetësua me sukses pas jehonës pozitive që pati ftesa për pjesëmarrje në këtë tribunë. Me këtë rast, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup e nderoi prof. Gegën me një mirënjohje postmortum për veprimtari jetësore “Për kontributin e veçantë në sferën e arsimit dhe kulturës shqiptare”. Intelektualë, miq, kolegë, bashkëveprimtarë e ish-studentë të profesor Gegës, të cilët me kumtesat e me fjalët përshëndetëse të tyre vulosën respektin që vazhdojnë ta kenë për profesorin, s’do mend se janë më meritoret që ky vëllim i “Scupit” sot po e sheh dritën e botimit.

Është një histori përpjekjesh e përgjegjësie profesionale dhe kombëtare e brezit të intelektualëve i cili në shumë drejtime ishte prijatar në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore, atëbotë kur për shqiptarët në Maqedoni e më gjerë në ish-Jugosllavi shumë çështje do të nisin nga e para. Mungesa e kuadrit arsimor dhe e vet shkollave e institucioneve universitare e shkencore, mungesa e teksteve shkollore, madje edhe e abetareve, bëri që barra që do të bartte mbi supë ky brez të ishte e rëndë. S’do mend se këtë barrë

do ta rëndonin shumë më shumë trazirat e njohura të kohës. Pjesë e kësaj historie do të bëhet edhe prof. Xhevat Gega. Emri i tij është sinonim i intelektualit shqiptar të Maqedonisë së Veriut që me përkushtim prej iluministi do të përballlet me sfidat jo të lehta të procesit të zhvillimit dhe përparimit arsimor e kulturor të popullatës shqiptare. Rrethanat në të cilat do të realizonte misionin e tij për ngritjen arsimore e kulturore të kësaj popullate do të diktojnë që prof. Gega të angazhohet në vazhdimësi dhe në më shumë drejtime. Gjithkund ku u angazhua, si në rrafshin shkencor, në atë pedagogjik e mediatik, la pas emrin e një profesionisti të mirëfilltë. Që nga mësuesi e deri te profesori universitar, nga hartuesi i Abetares, që krijoi traditën më të gjatë të përdorimit në këto troje, e deri te tekstet shkollore, nga studimet për gjuhën shqipe e letërsinë shqiptare deri te sprovat monografike, nga përkthimi i teksteve shkollore e deri te përkthimet letrare në gjuhën shqipe dhe nga gjuha shqipe, nga publicisti e deri te redaktori e kryeredaktori i institucionit më të rëndësishëm informativ në gjuhën shqipe në Maqedoni, nga pjesëmarrja në ngjarjet më të rëndësishme për njësimin e gjuhës standarde me qëndrimin: “Një komb – një gjuhë letrare!” e deri te funksionet drejtuese e udhëheqëse të institucioneve arsimore e organizatave kulturore, ndër të cilat edhe kryetar i Unionit të Inteligjencies Shqiptare në Maqedoni, ai mbeti shëmbëlltëyrë e intelektualit të përkushtuar, deri në frymën e fundit.

Nga ana e studiuesve të pranishëm në tribunën shkencore kushtuar prof. Xhevat Gegës, emri i tij u kujtua jo vetëm si një profesionist i përkushtuar e me një bagazh të pasur profesional, jo vetëm si një pedagog model i ligjëruesit universitar, në veçanti si një orator i përkryer e me aftësi komunikuese që të bën për vete, por edhe si një personalitet i cili do të kujtohet me respektin më të thellë për

anën njerëzore të tij, për gatishmërinë për t’u sakrifikuar për të tjerët dhe për energjinë pozitive që rrezatonte, ndër të tjera, edhe përmes korrektësisë e pedanterisë.

Artikujt e botuar në këtë vëllim të revistës “Scupi” do ta thonë vetë fjalën e vet, ndërsa ne shpresojmë që duke e vlerësuar ndihmesën e profesor Xhevat Gegës si trashëgimi të çmuar për shoqërinë tonë, kontribuojmë jo vetëm në njohjen e vlerave tona kulturore, por edhe në avancimin e tyre.

Redaksia



Drejtori Asani në mesin e të birit Arbenit dhe bijës Leontinës, pas ndarjes së mirënjohjes post-mortum për prof. Xhevat Gegën



Pamje nga konferenca





Pamje nga konferenca



FJALË PËRSHËNDETËSE

SKENDER ASANI

Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

–FJALË PËRSHËNDETËSE–

Të nderuar profesorë e studiues, e nderuara familja Gega!

Sot jemi më 1 shtator, në një ditë të veçantë, kur fëmija për herë të parë shkon në shkollë, nis nxënien e diturive në rrugëtimin e gjatë të jetës. Prandaj, jo rastësisht Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, e ka përzgjedhur këtë ditë të veçantë, që të organizojë këtë konferencë shkencore kushtuar formësuesit të parë të Abetares ndër nde, profesor Xhevat Gega.

Duke e pasur parasysh biografinë e pasur arsimore, kulturore e shkencore të prof. Gegës, unë lirisht mund ta krahasoj veprimtarinë e tij me atë të rilindësve tanë, të cilët në rrethana specifike kur populli ynë kishte nevojë për arsimim dhe zhvillim, u deshtë të merren me gazetari, me shkollë, me kulturë, me shkencë dhe me elementet tjera shtetndërtuese të kombit shqiptar. Prandaj, jorastësisht edhe tema kyçe e konferencës së sotme është figura poliedrike e prof. Xhevat Gegës, meqë vepra e tij u shtri në shumë fusha, e që kryesisht u artikulluan në kryeqendrën shpirtërore të shqiptarëve – në Shkup, aty ku që në periudhën e Rilindjes Kombëtare, u bën përpjekje të mëdha për liri dhe çlirim kombëtar, aty ku u themelua Klubi arsimor “Bashkini” dhe gazeta “Shkupi”, që edhe pse në kohë të shkurtër, dhanë një kontribut të madh në emancipimin tonë kulturor dhe arsimor, duke u përpjekur të hapnin shkollë shqipe. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, nga pushtuesi serb këtu u ngulfat çdo përpjekje arsimore

dhe kombëtare, për të rinisur puna gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe veçanërisht pas mbarimit të saj. Gjatë periudhës së LDB-së, edhe pse këtu sundonte fashizmi, kishte një ministër shqiptar (Ernest Koliqi), i cili dha një kontribut të madh në mbjelljen e farës kombëtare, duke sjellë një armatë të tërë mësuesish këtu në trevat shqiptare të Maqedonisë. Atë mision të shenjtë ata e vazhduan edhe pas krijimit të shtetit të ri (pas mbarimit të luftës), duke zhdukur analfabetizmin dhe duke nxjerrë gjenerata të arta arsimitarësh dhe profesionistësh të profileve të ndryshme. Pikërisht këto gjenerata, vazhduan me zell punën në vitet e 50-ta, 60- e 70-ta të shekullit të kaluar, duke i vënë themelet e orientimit të shqiptarëve të Maqedonisë, sepse kishin nevojë për ngritje arsimore e shkencore, që të jenë bartës të proceseve të mëvonshme shoqërore.

Ne e çmojmë kontributin e secilit në periudha të caktuara, dhe nuk guxojmë për asnjë çast ta mohojmë sakrificën e gjeneratave para nesh. Ne si Institut e çmojmë shumë çdo kontribut që kanë dhënë gjeneratat e mëhershme, prandaj ato i trajtojmë në mënyrën e duhur, meqë pa kontinuitet nuk mund të ketë prosperitet. Në këtë kuptim, edhe kjo konferencë e sotme është një uverturë e kontributit të mëhershëm që kanë dhënë gjeneratat e mëhershme, meqë vetëm në këtë mënyrë mund ta trasojmë drejtë rrugën e ardhmërisë sonë. Aty ku ne do të arrijmë pastaj do t'ia përcjellim stafetën gjeneratës tjetër. Ky Institut do të jetë një ombrellë e ruajtjes së këtij kontinuiteti dhe prosperiteti të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

YLBER SELA*Drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Shkup***–FJALË PËRSHËNDETËSE–**

Të nderuar miq! Kam privilegjin dhe kënaqësinë e veçantë që ta përshëndes këtë tribunë shkencore kushtuar jetës dhe veprës së profesor Xhevat Gegës.

Duke qenë në krye të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së, më duhet patjetër të shpreh respektin dhe kujdesin tim ndaj kësaj figure të arsimit, të letërsisë, të kulturës dhe, veçanërisht, të gjuhës shqipe. Aq më tepër ndiej detyrim edhe si bashkëvendës i tij, për ta përkujtuar bashkë me ju si një njeri dhe si një intelektual, i cili la gjurmë të pashlyera në jetën tonë shoqërore, për arsye se kontributi i tij si mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë, është tejet i madh. Në këtë mënyrë ai edukoi e mësoi breza të tërë, sidomos në Katedrën e Albanologjisë në Shkup, ku edhe e mbylli karrierën e tij si profesor duke u pensionuar.

Duke e përkujtuar nga kjo distance kohore, mund të themi me gojën plot se njohuritë për gjuhën shqipe dhe për letërsinë që i përcolli dhe që i rrënjosi te studentët, sot i gëzojmë të gjithë ne si fryte të përgjithshme shoqërore, për arsye se shumë nga ish-studentët e tij sot punojnë në institucione të ndryshme arsimore, shkencore e kulturore, madje edhe në institucionin që e drejtor unë, të cilët çdo ditë e japin ndihmesën e tyre profesionale. Duke u nisur nga kjo perspektivë, sot unë bashkë me ju, përuleni para personalitetit dhe veprës së tij, duke e përkujtuar me dinjitet, si dhe duke shprehur mirënjohjen dhe respektin më të thellë.

Nuk dua ta zgjas më tepër, por thjesht dua t'i uroj mbarësi kësaj tribune shkencore, e cila shpresoj të mos jetë e fundit për profesor Xhevat Gegën.

Ju faleminderit!

ISMET OSMANI

Shef i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare – Shkup

–FJALË PËRSHËNDETËSE–

I nderuar drejtor i ITSHKSH–së, z. Skender Asani!

Të nderuar profesorë, studiues e të pranishëm në këtë tribunë!

Pa dyshim që tribunat, tryezat, përvjetorët janë ngjarje të shënuara e mjaft të rëndësishme në jetën individuale e familjare të personaliteteve të ndryshme. Por vlerat rriten dhe shtohen kur bëhet fjalë për njerëz të përkushtuar në shërbim të arsimit e të kulturës shqiptare, të studentëve e shoqërisë në përgjithësi.

Në këto hapësira të zhvillimit dhe të arritjeve të gjuhës dhe të letërsisë shqiptare, një vend të nderuar zë edhe vepra e prof. Xhevat Gegës, gjuhëtar dhe filolog i çmuar, për të cilin Instituti i Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve në bashkëpunim me Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, organizon këtë tribunë shkencore kushtuar prof. Xh. Gegës. Prof. Xhevat Gega, ishte një ndër studiuesit e shquar të gjuhësisë dhe letërsisë shqiptare, i cili, për rreth 40 vjet punoi për ngritjen e arsimit shqip në fshatrat e Manastirit dhe të Strugës, në Normalen “Zef Lush Marku” të Shkupit, në Akademinë Pedagogjike “Kliment Ohridski” në Shkup, por një kohë më të gjatë në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, njësi pedagogjiko–shkencore me emër, që në fillim drejtohej nga prof. Petro Janura, e më pas edhe nga prof. Xhevat Gega i cili me zell e punë këmbëngulëse, arriti të bëhet një zë i

gjuhës dhe i letërsisë shqiptare. Prof. Xh. Gega, me punën dhe angazhimin e tij shumë shpejt vendoste autoritetin e vet në auditor, duke arritur që, me korrektesën shembullore, mbi të gjitha me një retorikë bindëse, të gëzonte respektin dhe besimin e studentëve.

Ne që studiuam para viteve 90-të, u formuam në një mjedis të mbyllur, pa kontakte me botën shkencore as në përfundim, as në lindje, pa folur për mungesën e kushteve të nevojshme për punë shkencore dhe për shpërdorimin e kohës, megjithatë, patëm disa shembuj që na frymëzonin dhe na nxitnin të punonim për t'u ngritur shkencërisht e profesionalisht. Këta qenë profesorët tanë P. Janura, Xh. Gega, Remzi Nesimi, Haki Ymeri, Zeqirja Neziri, Avzi Mustafa etj. Erudicioni i tyre dhe sjelljet korrekte në marrëdhëniet me studentët kanë lënë gjurmë të thella jo vetëm tek unë. Ata qenë mësuesit tanë, po sipëria e tyre intelektuale nuk i pengonte të uleshin në konsulta e mbledhje pune me ne, që sapo ishim futur në hulli të studimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

I uroj tribunës sukses të plotë dhe ju faleminderit për vëmendjen!

LEONTINA GEGA–MUSA

E bija e prof. Xhevat Gegës, studiuese

–FJALË PËRSHËNDETËSE–

I nderuar drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, z. Skender Asani;

I nderuar drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV, z. Ylber Sela;

Të nderuar kolegë e bashkëpunëtorë të prof. Xhevat Gegës dhe pjesëmarrës në këtë tribunë;

Të nderuara Zonja e zotërinj të pranishëm,

Më lejoni që sot, t'ju drejtohem nga kjo foltore, jo vetëm si studiuese, por edhe si vajza e profesor Xhevat Gegës, i cili për mua dhe vëllain tim, qe një baba i devotshëm, ndërsa për nënën tonë një bashkëshort i denjë, të cilit i qëndroi pranë deri në frymën e fundit. Babai, por edhe nëna, si kontributdhënës të dëshmuar në arsimimin dhe emancipimin e gjeneratave të tëra të shqiptarëve në Maqedoni, veçanërisht në Shkup, secili në nivelet e veta akademike, na udhëzuan me shumë përpikëri në rrugëtimin tonë shkollor dhe ngritjen profesionale. Ky udhëzim, u bë udhërrëfyes imi, që të ndjek ngritjen profesionale e akademike në shkencat albanologjike. Dhe po ky udhëzim i prindërve tanë, nuk u kursye në asnjë moment, as në rritjen dhe shkollimin e tri mbesave dhe nipit të tyre, për të cilën u jemi përjetësisht mirënjohës.

Prandaj sot, po ju drejtohem me një përshëndetje të veçantë, të gjithëve që keni ardhur për të marrë pjesë në këtë Tribunë shkencore kushtuar *“Figurës poliedrike të profesor Xhevat Gegës”*.

Kjo Tribunë shkencore që ka për temë bosht *“Kontributin e prof. dr. Xhevat Gegës në zhvillimin dhe ngritjen e arsimit shqip”*, ka paracaktuar si synim të ndriçojë dhe trajtojë në një, të gjithë fushëveprimtarinë e njërit ndër intelektualët, me shkollim të lartë të nivelit universitar, që nga vitet e pesëdhjeta të mileniumit të kaluar, dhe i cili iu përkushtua jetësisht punës intelektuale për të mirën e popullit të tij. Kjo kohë dhe dekadat në vijim, lidhen me shumë aspekte të zhvillimit në fushën e arsimimit, shkencave albanologjike, gazetarisë dhe asaj kulturore e shoqërore të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, sot e njohur si Republika e Maqedonisë së Veriut. Në të gjitha këto aspekte, profesor Xhevat Gega, si intelektual i formuar dhe me mençuri vizionari, u hapi shtigjet e diturisë brezave të ri të intelektualëve që u formuan në rrethana më të avancuara, falë punës së tij dhe kolegëve e bashkëpunëtorëve. Kontributi i tij në këto aspekte, trajtuar si shprehje e ndërgjegjes intelektuale të tij, në një emision dokumentar të realizuar sa që në këtë jetë nga Radio Televizioni i Maqedonisë, Redaksia Shqipe, bëri që të cilësohet si kontribut i një iluministi.

Virtytet e tij, si disiplina në punë, ligjërimi cilësor dhe me nivel gjuhësor të shqipes deri në shkallë purizmi, thellësia dhe saktësia e hulumtimit dhe shtjellimit thelbësor të çështjeve letrare e gjuhësore, gjykimi i drejtë dhe guximi për të pohuar të vërtetën edhe përkundër pasojave, e karakterizuan gjatë tërë jetës figurën e tij. Dhe mu këto virtyte, bënë që profesor Xhevat Gega të konsiderohet ndër studentët e tij, si pedagogu model i ligjëruesit

universitar. Këtë figurë të pedagogut model, ai e ndërtoi gradualisht që nga kthimi i tij pas përfundimit të studimeve të larta në Universitetin e Beogradit, duke u punësuar fillimisht në Normalen e Shkupit si profesor, pastaj edhe në Akademinë e Lartë Pedagogjike dhe Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit, ku pati një rol konstruktiv në avancimin dhe institucionalizimin e studimeve shqipe.

Vullneti i pashoq që posedonte në ngritjen dhe në zhvillimin cilësor të shkollimit në gjuhën shqipe, u bë shkas që ai të përpilojë Abetaren për nxënësit shqiptarë në Maqedoni, e cila mu për shkak të cilësisë mbeti për dekada të tëra në përdorim dhe vazhdon të jetë e preferuar për mësuesit edhe në kohën e sotshme. Prandaj, profesor Xhevat Gega mbetet përpiluesi simbol i Abetares së gjeneratave të tëra ndër shqiptarët në Maqedoni.

Vullneti i tij, u dëshmuar edhe në përpilimin e një varg tekstesh shkollorë të domosdoshme për nivele të ndryshme arsimore. Në kujtesën time fëmijërore, ende jehojnë të rrahurat e makinës së shkrimit të babait, trashëgimi kjo simbolike e shtëpisë prindërore, me të vetmin qëllim, që viti i ri shkollor të fillojë për nxënësit me tekste të përgatitura. Por, kur që e nevojshme ai iu rrek përkthimit, jo vetëm të teksteve shkollorë, po edhe veprave letrare, duke u dëshmuar si shqipërues i përsosur, për të cilin kontribut edhe u vlerësua lart nga institucione përkatëse deri në shpërblime me “Pendën e artë”.

Pos kontributit në çështjet arsimore dhe kulturore, profesor Xhevat Gega u dëshmuar edhe si studiues i dukurive gjuhësore. Dhe kur jemi te çështjet gjuhësore, sidomos e sensibilizimit dhe angazhimit të tij në unifikimin e gjuhës shqipe, më lejoni që të parafrazoj

dëshminë e profesorit dhe letrarit Agim Vinca nga kumtesa e tij me rastin e shënimit të dyzet vjetorit të Konsultës gjuhësore të Prishtinës së vitit 1968, shënuar në vitin 2008 në Institutin Albanologjik në Prishtinë, kur thotë se ishin diskutimet si, ai i Pjetër Janurës, doktor Xheladin Dedës, Ali Hadrit dhe Xhevat Gegës që e orientuan drejt punën, duke i dhënë tonin dhe kahen e duhur Konsultës, me moton Një komb – një gjuhë – një drejtshkrim.

Po me të njëjtin seriozitet, ai u dëshmuar edhe në studimin e fenomeneve letrare, personaliteteve të letërsisë shqipe, si: De Rada, Kristoforidhi, Naimi, Noli, Gurakuqi, Migjeni e kështu me radhë, e deri te studimet e letërsisë krahasuese. Ndërsa, adhurimi i tij i veçantë për periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe përfaqësuesve të saj në letërsinë shqipe, bëri që profesor Xhevat Gega që në vitin 1975, të marrë iniciativën e vënies së lidhjes së shkëputur nga trangu amë, me arbëreshët e Sicilisë dhe Kalabrisë në Itali. Shkrimet e tija nga ky qëndrim hulumtues, njohja me personalitete të shquara arbëreshe të asaj kohe, bashkëbisedimi dhe intervistat e realizuara me ta, u botuan në disa vazhdimë në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, në të cilën që edhe kryeredaktor për disa vjet.

Dhe në fund, dua të theksoj dhe besoj se brenda kumtesave që do të paraqiten sot në këtë Tribunë shkencore kushtuar ***“Figurës poliedrike të profesor Xhevat Gegës”***, do të trajtohen me shumë sukses, secili aspekt i kontributit profesional të babait. Prandaj, duke ju falënderuar secilin nga ju në emër të familjes Gega, të gjithë pjesëmarrësit, si kolegë e bashkëpunëtorë të tij dhe ish-studentë, me gatisshmërinë e tyre në këtë Tribunë, dëshmojnë se duke vlerësuar kontributin e gjeneratave të kaluara, të lëna si trashëgimi shoqërisë sonë akademike, kontribuojnë në avancimin e vlerave tona kulturore.

ARBEN GEGA*I biri i prof. Xhevat Gegës***–FJALË PËRSHËNDETËSE–**

Ne emrin e mamasë sime, në emrin tim dhe në emër të tërë familjes Gega, ju them Faleminderit:

Instituti të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, drejtorit Skender Asani, punëtores shkencore Laura Papraniku, si edhe të gjithë punëtorëve të tjerë shkencorë në Institut, të përfshirë në organizimin dhe mbështetjen e punës së kësaj tribune shkencore kushtuar jetës dhe punës profesionale të bashkëshortit dhe babait, pedagogut e profesorit, letrarit e gazetarit, kritikut të letrave, poliedrit Xhevat Gega.

Falënderim i veçantë gjithashtu edhe për angazhimin e profesorit Avzi Mustafa në koordinimin me përkushtim për organizimin e kësaj tribune.

I drejtoj falënderimet edhe drejtorit të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zotëriut Ylber Sela, për fjalën e tij të rastit.

Falënderime të sinqerta edhe deri te të gjithë pjesëmarrësit, të cilët do të paraqiten me vështrimet e tyre për aspektet dhe fushat e veçanta të punës së babait, ose ashtu siç ne fëmijët e tij, pastaj edhe mbesat Rina, Julinda, Dora dhe nipi Elion, e quanim – Tati!

Dhe emri Thoti – Tati, ashtu siç filologu nga Roma, Xhysepe Katapano, në veprën e tij studimore kushtuar kulturës së lashtë ilire

“TATI fliste shqip” e zbërthen, ishte emri ilir i perëndisë egjiptiane të mësimi, shkathtësisë së të shkruarit e të shkencës filologjike.

Dhe Tati ynë i vuri shkronjat shqip në Abetaren e tij, në librat e shumtë didaktikë si autor apo bashkautor për të gjitha ciklet mësimore, nga ai fillor, i mesëm dhe universitar, e deri te përmbledhja apo Antologjia e parë e Lirikës Erotike Shqipe.

Dhe përmes të gjithë këtyre titujve, veprave dhe akteve,
Xhevat Gega, gjithnjë veproi dhe foli shqip!

Tati të faleminderit!

Në emër të Tatit, Ju faleminderit!



KUMTESA

AVZIMUSTAFA*Profesor dhe studiues***PROF. DR. XHEVAT GEGA MODEL NJERIU,
PEDAGOGU E SHKENCTARI¹**

Është një fakt i pamohueshëm se figurat e mëdha të tabanit kombëtar asnjëherë nuk zbehen, por me kalimin e kohës rrezatojnë edhe më tepër. Një figurë e tillë emblematike mbetet edhe profesori, Xhevat Gega, një emër i shquar i arsimit tonë kombëtar.

¹ Prof. dr. Xhevat Gega lindi në Strugë më 1934. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa Normalen në Shkup dhe Tetovë. Pas diplomimit, punon si mësues në fshatin Kishavë të Manastirit dhe në f. Velehtë të Strugës. Pas dy viteve në mësuesi, në vitin 1953 Xhevat Gega regjistrohet në Fakultetin e Filozofisë në Beograd, kur në vitin 1957 diplomon në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare. Pas diplomimit, ka punuar si profesor i Gjuhës dhe Letërsisë në Normalen “Zef Lush Marku” të Shkupit, ndërsa ka ligjëruar edhe në Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare pranë Akademisë së Lartë Pedagogjike “Kliment Ohridski” të Shkupit. Vite me radhë ka qenë redaktor i rubrikës kulturore në redaksinë e gazetës “Flaka e Vëllazërimit”. Që nga tetori i vitit 1969 e deri më 1974 ka punuar si profesor i lëndëve Histori e letërsisë shqiptare dhe Teori e letërsisë pranë Akademisë Pedagogjike “Kliment Ohridski” në Shkup, ku gjatë një mandati ka qenë edhe zëvendësdrejtor i Akademisë Pedagogjike.

Në periudhën ndërmjet viteve 1974-1978 ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, si dhe i edicioneve të tjera në gjuhën shqipe, të cilat botoheshin në Maqedoni. Gjatë periudhës së lartpërmendur, si bashkëpunëtor i jashtëm, ka ligjëruar Metodikën e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Fakultetin e Filologjisë në Shkup. Që nga viti 1978 e deri në pensionim (tetor 1996), Xhevat Gega punoi në Fakultetin e Filologjisë në Shkup si ligjërues i lartë e në fund edhe si profesor i Historisë së letërsisë shqiptare, duke e kryer për vite të tëra edhe detyrën e shefit të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare. Nga tetori i vitit 1979 e deri në shtator të vitit 1981 Xhevat Gega ka qenë prodekan, pastaj Kryetar i Këshillit të Fakultetit, si dhe kryesues i disa komisioneve në Fakultetin e Filologjisë në Shkup.

Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane, me seli në Nju-Jork, ia ndau Prof. dr. Xhevat Gegës titullin më të lartë shkencor **Akademik** (post mortum).

Për profesorin Xhevat Gega kisha dëgjuar shumë herët nga bashkëqytetarët e mi, që mësonin në Normalen e Shkupit. Meqenëse edhe unë u regjistrova në këtë Normale, mezi prisja ta takoja Profesorin. Kjo ndodhi që ditën e parë kur filloi mësimi në Shkollën Normale, pikërisht në orën e tretë, në orën e gjuhës amtare. Që në takimin e parë te profesori Xhevat më bëri përshtypje pamja e tij e jashtme, trupi i tij mesatar dhe fytyra e qeshur, me sy shqiponje e shikim depërtues, me një karizëm të veshur me shqimezë dhe shumë elegant. Pasi e regjistroi orën në ditar, u çua dhe filloi të na prezantohet. Që në prezantim më la përshtypje zëri i tij kumbues derisa sytë e tij të qetë e të shndritshëm na vështronin ëmbël. Ishte kënaqësi vetëm ta dëgjosh.

Kur i shpjegonte leksionet, të linte përshtypje të thellë për njohuritë enciklopedike që kishte për problemet e letërsisë e të gjuhës. Me sjelljen dhe qëndrimin e tij të lirshëm, me fjalën e ëmbël dhe plot dashamirësi, ai të linte përshtypjen e një intelektual largpamës, që unë nuk kisha pasur rastin të njihja ndonjë të tillë si ai deri atëherë.

Ne, brezi që kemi pasur fatin që të marrim njohuri e dituri nga profesor Xhevat Gega, ishim në përparësi, qoftë në shkollë të mesme, në Akademi e në Universitet. Por, jo vetëm kaq. Ne që kemi pasur rastin të punojmë me profesorin e kemi ndier nga afër përkujdesjen, mbështetjen dhe inkurajimin e tij, ndaj edhe mirënjohja për të ishte pjesë e një marrëdhënieje të veçantë, të krijuar në vite. Gjithë kjo do të jetë edhe pjesë e kujtesës që do të na shoqërojë derisa të jemi gjallë. Të gjithë jemi krenarë që kemi qenë bashkëkohës, nxënës e kolegë të Profesorit, sepse një pjesë të një jete që e kemi ndërtuar e kemi marrë përmes shëmbëlltyrës, fjalës dhe dijes së profesorit Xhevat.

Profesor Xhevat Gega, gjatë punës së tij, ishte korrekt në detyrë dhe shumë i aftë profesionalisht. Kishte kulturë të gjerë profesionale dhe të përgjithshme, por ishte edhe i dashur dhe komunikues.

Ai kishte një shikim dhe një gjuhë të ëmbël, gjithnjë i natyrshëm, asnjëherë kërcënues, tepër i sjellshëm, kurrë i acaruar dhe gjithnjë i gatshëm për të ndihmuar çdokënd. Prof. Xhevat Gega, deri në momentin e fundit si pedagog, qëndroi pranë studentëve.

Si njeriu që aq shumë ka bërë për ta ngritur kulturën tonë, gjithmonë i papërtuar, i gatshëm në çdo moment për të ndihmuar me ide, këshilla, vërejtje, sugjerime e literaturë. Xhevat Gega ishte dhe do të mbetet model i pedagogut të urtë e të mirë, i cili rrezatonte tek studentët dashamirësi, humanizëm, kulturë, sinqeritet, komunikim e, mbi të gjitha, të impononte respekt me personalitetin e tij të padiskutueshëm intelektual e shkencor.

Prof. Xheva Gega ishte model i njeriut të mirë, me zemër të madhe, shpirt krijues, shkencëtar dhe intelektual, qytetar, i urtë, me vizion, xhentil, i shkathtë, energjik, me edukim dhe kulturë të gjerë perëndimore, familjar i shkëlqyer, si dhe mik dhe profesor i përkryer. Ai ishte një shëmbëlltyrë jo vetëm për nxënësit e studentët, por edhe për të gjithë ata që e kanë njohur, sepse ai posedonte cilësi të çmuara shpirtërore e morale.

Prof. Xhevat Gega ishte një emër me prestigj të lartë, një autoritet shkencor e didaktik. Jo çdokush mund ta arrijë një profil të tillë. Ndërtimi i personaliteteve të tilla nuk është i rastësishëm: i tillë bëhet ai që i ka bazat e mira për të ecur në fushën e vet; i tillë bëhet ai që e investon kohën dhe jetën e vet; i tillë bëhet ai që e lidh mësimdhënien me punën e tij hulumtuese e kërkimore. Personalitete të tilla akademike, siç ishte profesori Xhevat Gega,

vendi ynë i ka pasur të rrallë, andaj ai mbetet pasuria jonë kombëtare.

Ai mbetet i paharrueshëm nga aspekti human, njeriu që e njohte vetëm tolerancën, respektin për talentin, urtësinë, bashkëpunimin, paqen, mirësinë dhe forcën e karakterit. Gjatë gjithë jetës dhe punës e vetnaja moto e tij ishte: “punë e ndershme, sinqeritet dhe miqësi”.

Prof. Xhevat Gega si profesor

Si mësimdhënës, ai kishte aftësi dhe cilësi të veçanta që t'i paraqiste çështjet në mënyrë të atillë që të bëheshin interesante edhe kur nuk ishin të tilla. Me intonacion dhe me një gjuhë të kulluar në të folur, gjithmonë në këmbë pranë ose para katedrës, duke ligjruar, ai ishte në gjendje që t'i mbajë studentët sy e veshë drejt tij. Në pamjen dhe sjelljen e tij kishte diçka madhështore, që të tërhiqte e të bënte për vete. Leksionet e tij, ndoshta të vështira, ishin të kuptueshme. Në to sundonte analiza logjike, argumentimi, thjeshtësia dhe qartësia. Në marrëdhëniet e tij me studentët, ai i trajtonte si të barabartë dhe nuk bënte dallime. Ai të krijonte kushte dhe të aftësonte për të mësuar. Dhe, këtë e bënte me shumë ngrohtësi dhe profesionalizëm. Të mësonte me zemër dhe jo me libër. Të mësonte se si duhet të mësosh, ta tregonte sekretin e punës, çelësin e efektivitetit – metodën shkencore – mënyrën për ta eliminuar atë që nuk ishte e rëndësishme, rrugën më të shkurtër të studimit. Ai të udhëzonte dhe të drejtonte në rrugën e drejtë dhe ta jepte gjithmonë atë që të shtynte për të menduar më thellë në problemin që duhej të trajtohej.

Dhe, këtë e konsideronte jo si detyrë thjesht pedagogjike, por si një detyrë qytetare, prindërore dhe edukative. Prandaj, atë e respektonin të gjithë studentët e të gjithë brezave që ai u ka dhënë

mësim. Ai respektohej dhe nderohej, sepse në këtë respekt dhe nderim përfshihej autoriteti dhe jo forca, toleranca dhe jo abuzimi, afërsia komunikuese, dashuria, ngrohtësia, barazia e, mbi të gjitha, drejtësia. Për ne ai ka qenë pedagog, por edhe prind.

Studentët e Gjuhës e Letërsisë Shqipe asnjëherë nuk mund ta harrojnë punën e tij, por gjithmonë do ta vlerësojnë për leksionet, për udhëheqjen e magjistrantëve e doktorantëve e për të gjitha këshillat dhe mendimet racionale që i përçonte në auditor. Por, jo vetëm studentët. Atë e vlerësojnë edhe kolegët, bashkëpunëtorët, por edhe magjistrantët dhe doktorantët. Ai bëhej miku dhe udhëheqësi i tyre, duke i ndihmuar për çdo problem. Ai kujtohet me respekt si një vlerë për Universitetin e Shkupit. Dhe, vlerat i dallon vetëm ai që është i ditur, i mençur, human e, mbi të gjitha, intelektual. Ka shumë pedagogë e profesorë, por secili nuk mund ta posedojë thirrjen *profesor*, sepse për të qenë profesor i mirë duhet të kesh diçka të veçantë. Këtu do t'ju flas për “fshehtësitë” që unë i mësova nga profesori Xhevat. Për ta miratuar titullin profesor duhet të jesh i motivuar, i vyer, i drejtë, komunikues, i përgjegjshëm, kreativ, pozitiv, sistematik, profesionalist, energjik, inovativ, frymëzues, elokuent, me plot ide, me vullnet e entuziast, si dhe i përgatitur për mësim gjatë gjithë jetës.

Duke i pasur të gjithë këto cilësi, prof. Xhevati gëzonte respekt dhe mirënjohje si mësues, respekt dhe mirënjohje si profesor dhe respekt e mirënjohje si udhëheqës shkencor, por edhe respekt dhe mirënjohje si model pedagogu! Ai ishte një profesor me cilësi e inteligjencë prej mësuesi të vërtetë, njohës i profesionit, i përkushtuar në punë me ndërgjegje e dashuri për studentët, i durueshëm, me qëndrim të drejtë dhe të sinqertë.

***Prof. dr. Xhevat Gega si shkencëtar, autor tekstesh
shkollore dhe si përkthyes***

Në pasqyrën e bibliografisë së prof. dr. Xhevat Gegës përfshihen mbi 200 punime profesionale dhe shkencore. Ai ka marrë pjesë në mbi 50 simpoziume shkencore në vend dhe jashtë, ndërsa ka përkthyer mbi 20 libra nga maqedonishtja dhe serbokroatishtja në shqipe, si dhe nga shqipja në maqedonishte (B. Koneski, S. Janevski, T. Arsovski, M. Krlezha, G. Todorovski, J. Plevnesh, R. Shabani, etj.)

Listën e punimeve të tij mund ta grupojmë në tri fusha të ndara, duke i veçuar më karakteristiket:

Punime nga letërsia e vjetër dhe e re shqiptare;

Punime për pikat përbashkëta ndërmjet letërsisë shqiptare dhe asaj maqedonase;

Punime nga fusha e letërsisë shqiptare në Maqedoni.

Dr. Xhevat Gega, në veprimtarinë e tij shumëvjeçare pedagogjike e shkencore, ka treguar interes të theksuar dhe afinitete të veçanta në paraqitjen, kërkimin dhe shpalljen e rezultateve nga proceset zhvillimore të letërsisë shqiptare me tërësinë e saj, nëpërmjet përfaqësuesve të saj më të spikatur. Vëmendje të veçantë meritojnë punimet mbi Jeronim De Radën, Fan Nolin, Naim Frashërin, Luigj Gurakuqin, S. Spasen, etj.

Vend qendror në këto punime zë studimi shkencor “Mbi poezinë origjinale të Fan Nolit dhe gjenezën e saj politike”, të botuar në “Jehona”, që është përfshirë edhe në vëllimin mbi kritikën e Nolit, të botuar në veprat e zgjedhura të akademik Rexhep Qosjes.

Ai ka shkruar edhe mbi opusin letrar të Adem Gajtanit, mbi letërsinë shqiptare krijuar në Maqedoni në vitet 1945–1975, e ka vështruar në mënyrë kritike veprimtarinë e Murat Isakut, Abdulazis Islamit etj.

Prof. Dr. Xhevat Gega, brenda aktiviteteve të tij pedagogjike e profesionale shkencore, zhvilloi edhe një veprimtari të rëndësishme lidhur me tekstet mësimore për nevojat e nxënësve, duke bashkëpunuar me NB “Prosvetno dello”, ka botuar një numër të teksteve shkollore, duke filluar që nga Abetarja e deri tek tekstet shkollore të letërsisë. Po ashtu edhe për Entin për Botimin e Teksteve Mësimore nga Prishtina ai ka përkthyer 15 tekste mësimore për arsimin fillor e të mesëm.

Më të rëndësishmet ndër tekstet e tij është Abetarja, që e shënoi botimine parë në vitin 1970. Pas kësaj do të pasojnë ribotime gjatë viteve edhe adaptime sipas plan–programeve mësimore të arsimit fillor tetëvjeçar e nëntëvjeçar deri në ditët tona, fletore pune, si dhe tekste për mësimin e gjuhës.

Prof. Xhevat Gega, si të gjithë autorët e abetareve shqipe në gjitha trevat shqipfolëse, e përdori metodën analitike–sintetike. Mësimi, sipas kësaj metode, zhvillohej në dy etapa: në etapën përgatitore dhe në atë të mësimin të shkronjave. Në të gjitha abetaret e trevave shqipfolëse mësimi i shkrimit do të zhvillohej paralelisht, ndërsa në abetaren e prof. Xhevat Geges mësimi i shkronjave do të mësohej veçmas: së pari gerमत e mëdha dhe të vogla të shtypit e pas këtyre shkronjat e dorës. Po ashtu profesori Xhevat do t’i bëjë në mënyrë të pavarur mënyrat e veçimit të tingujve, ashtu që do t’ua mundësojë fillestareve që sa më lehtë ta bëjnë sintezën e tingujve jo vetëm për nga njohja e tyre, por, para së gjithash, në perceptimin pamor e deri në të menduarit logjik të nxënësit.

“Letërsia me teorinë e letërsisë për klasën e parë të shkollave të mesme”, “Gramatika për klasën IV dhe V”, “Letërsia me shembuj për klasën e parë të arsimit të mesëm” ishin tekste të prof. Xhevat Gegës, që ishin të kapshme e të adaptuara sipas fuqive psikike-fizike të nxënësve.

Ai ka qenë bashkëpunëtor edhe në përgatitjen e planeve e programeve mësimore për gjuhën dhe letërsinë shqiptare, si dhe bashkëpunëtor dhe pjesëmarrës në seminare për ngritjen permanente të arsimit për shkollat e mesme me tema të ndryshme nga fusha e letërsisë dhe metodikës së mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare, të organizuar nga ana e Entit Pedagogjik Republikan të Maqedonisë.

Është autor i një veprimtarie madhore përkthyes. Ka me dhjetëra tituj të përkthyer nga maqedonishtja dhe letërsitë jugosllave. Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zgjedhjen dhe përkthimin e materialeve për “Mbrëmjet Strugane të Poezisë”, “Takimet e Racinit”, “Grigor Përliçevit” në Institutin e Letërsisë të Fakultetit të Filologjisë në Shkup (si udhëheqës i projektit), etj., ndërsa për gjithë punën e tij përkthimore nga Shoqata e Përkthyesve është dekoruar me mirënjohjen “Penda e artë”.

Prof. Xhevat Gega ka qenë anëtar i Komisionit të Ortografisë, të vitit 1963, i themeluar për të dhënë kontributin në vendosjen e rregullave dhe shmangies së lëkundjeve në drejtshkrimin e gjuhës shqipe, ku ai ka dëshmuar kontribut profesional për përgatitjen dhe punën e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, mbajtur në vitin 1968, në të cilën ai ka marrë pjesë duke e mbështetur qëndrimin: “Një komb – një gjuhë letrare!”, një gjë që do të realizohet në vitin 1972, kur do të marrë pjesë edhe në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë si intelektual nga radhët e shqiptarëve të Maqedonisë dhe si

një ndër përçuesit dhe zbatuesit e gjuhës letrare shqipe, si në të folur ashtu, ashtu edhe në të shkruar. Në të vërtetë, i tillë mbeti deri në frymën e fundit.

Prof. Xhevat Gega, si njohës i profesionit, i përkushtuar në punë me ndërgjegje e dashuri për studentët, i durueshëm, me qëndrim të drejtë dhe të sinqertë, do të mbetet personalitet i veçantë akademik në fushën e letërsisë, personazh i dashur dhe i respektuar për të gjithë studentët që kanë pasur fatin ta kishin pedagog. Ai është përfaqësuesi më i shquar dhe më i denjë i shkollës shqiptare, ku ka punuar e krijuar me tri gjenerata, duke mbetur miku, mbështetësi dhe modeli i tyre, si dhe modeli i intelektualit e njeriut me vlera të çmuara.

I dashuri profesor Xhevat, edhe pse fizikisht nuk gjendesh midis nesh, prehu në paqe e qetësi. Unë dua të ta them një gjë me plot bindje “Derisa të ketë gjuhë shqipe e shkollë e kulturë shqiptare, emri juaj do të shkruhet me **Shkronja të Mëdha**”.

HYSEN MATOSHI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

NAIM FRASHËRI DHE GRIGOR PËRLIÇEVI NË STUDIMET E PROFESOR XHEVAT GEGËS

Zhvillimi i përgjithshëm i shqiptarëve të mbetur në ish–Jugosllavi ndërlihet me emra të personaliteteve që dhanë ndihmesën e tyre në fusha të caktuara. Veçmas pas Luftës së Dytë Botërore këtij zhvillimi i paraprinë projektet në fushën e kulturës e të arsimit, ndaj secila arritje në këtë drejtim do të çmohej si një hap në drejtimin e duhur. Hapja e shkollave, hartimi, a përkthimi i teksteve mësimore dhe literaturës tjetër, sidomos pas pamundësimit të komunikimit të shqiptarëve me shtetin amë, Republikën e Shqipërisë, u bë përgjegjësi profesionale dhe kombëtare e brezit të intelektualëve të parë, të cilët morën rolin e rilindësve në kohë të vështira historike.

Këto rrethana e karakterizuan veprimtarinë e prof. dr. Xhevat Gegës dhe të brezit të tij të albanologëve shqiptarë, të cilët diplomuan në një kohë kur mbi kombin e tyre gjithanshëm po zbatohesh një politikë e dhunës sistematike, e shpronësimit dhe e dëbimit drejt Anadollit. Puna si pedagog, si autor studimesh e si autor a përkthyes tekstesh shkollorë, si redaktor e kryeredaktor i institucionit më të rëndësishëm informativ në gjuhën shqipe flet për një angazhim të vazhdueshëm në rrugën plot sfida të shqiptarëve të mbetur në kuadër të Maqedonisë. Rrugëtimin profesional nga Kishava e Manastirit e deri te Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Shkupit, nga tekstet shkollorë deri te punimet studimore, nga abetarja e gjuhës shqipe deri te sinteza e madhe letrare e shqiptarëve

në Maqedoni, përbën itinerarin jetësor të përkushtimit të paluhatshëm të intelektualit shqiptar që ecën vëmendshëm nëpër kohë trazirash e tronditjesh të mëdha, natyrisht jo rrallë duke ruajtur vijimësinë e atij rrugëtimit edhe me çmimin e mospajtimit me gjithçka ndodhte atëkohë.

Jam i bindur se për të trajtuar këto aspekte, shpeshherë dramatike e plot sfida, më meritore janë kolegët e tij bashkëkohës dhe bashkëveprimtarë, ata me të cilët ndau hidhësitë e shumta që asokohe vinin nga anë të ndryshme, por edhe arritjet vendimtare në jetën arsimore, kulturore e shkencore të shqiptarëve të kësaj hapësire, sado të vështira dhe të pamundura dukeshin ato. Krahas veprimtarisë pedagogjike emancipuese, prof. dr. Xhevat Gega dha një ndihmesë të çmueshme edhe në fushën e studimeve letrare. Ato ofrojnë një gamë të gjerë të interesimeve që shtrihen nga tekstet shkollore të letërsisë, duke përfshirë edhe kontribute teorike, studime për autorë të periudhave të ndryshme të letërsisë shqipe e deri te sprovat monografike. Përkthimet letrare në gjuhën shqipe përbëjnë një interesim tjetër dhe një kontribut domethënës për pasurimin e bibliografisë letrare në gjuhën shqipe. Megjithatë, vetë sinteza e tij për letërsinë shqipe në Maqedoni (1945–1985) përbën një makroprojekt që ofron në një trajtë kronologjike e tipologjike autorët dhe veprat letrare të këtij krahu të rëndësishëm të letërsisë shqipe për një periudhë kohore disadekadëshe. Klasikët e albanologjisë në Kosovë e në Maqedoni, e në këtë kontekst edhe historianët e letërsisë shqipe, kam bindjen se ishin më të guximshëm dhe më sakrifikues pikërisht për faktin se u rrekeshin projekteve të mëdha, sintezave gjithëpërfshirëse në një disiplinë të caktuar.

Përkthimet letrare, krahas përkthimeve të teksteve mësimore, përbëjnë një sferë të rëndësishme të veprimtarisë profesionale e

artistike të Profesor Xhevat Gegës, njëkohshëm veçmas për relacionet kulturore shqiptaro-maqedonase e përgjithësisht shqiptaro-sllave një kontribut të pamohueshëm. Fakti se përkthente nga gjuhët sllave në shqip dhe anasjelltas dëshmon se kapacitetet zotëruese të këtyre gjuhëve, pra të serbokroatishtes dhe të maqedonishtes, krahas gjuhës amtare, i kishte tejte të larta, ndërsa këtë e dëshmon ardhja në shqip e autorëve si Miroslav Kërlezha, Blazhe Koneski, Sllavko Janevski, Gane Todorovski etj.

Duke pasur për synim që të sjell për këtë kumtim vetëm një pjesë të punës studimore letrare të Xhevat Gegës, u përqendrova që të sillja një vrojtim mbi studimin kushtuar kryeautorit të letërsisë shqipe, Naim Frashërit, dhe studimit mbi shkrimtarin maqedonas Grigor Përliçev, përkatësisht studimin mbi poemën e tij për “Skënderbeun”.

Ndonëse është i madh numri i historianëve tanë të letërsisë që e kanë bërë objekt studimi veprën e Naim Frashërit, e për rrjedhojë mund të thuhet se Naimi është ndër shkrimtarët tanë më të studiuar në aspekte e në kontekste të ndryshme, qasja studimore e Profesor Xhevat Gegës e bën objekt trajtimi dimensionin përndriçues të veprës së rilindësit tonë. Krahas Akademik Rexhep Qosjes, edhe studiuesi Gega në strukturën titullore të punimit të tij e ka përfshirë fjalën **porosi**. Krahaso “Porosia e madhe” dhe “Porositë humane të Naimit”. Në të vërtetë, duke pasur synim parësor, ngritjen e kombit shqiptar, vepra letrare e Naim Frashërit, merr përmasa të përgjithshme frymëzuese kombëtare e humane. Pavarësisht nëse porosia e veprës së tij shpërfaqet si detyrë, si kërkesë, si këshillë, si udhëzim, si mësim, apo edhe si amanet, ajo në krye të herës merr funksionin e një mjeti udhëzimi, edukimi e formimi i lexuesit të saj. Xhevat Gega, duke e njohur mirë këtë aspekt të veprës së

Naimit, i ka identifikuar vlerat e përgjithshme, do të thosha tejkombëtare, pra humane e të gjithmonshme, të autorit që e bëri shqipen gjuhë të njëmendtë të letërsisë. Ndonëse një punim jo gjithaq i gjatë, mund të thuhet se autori ka ofruar sinteza të qëndrueshme dhe përfaqësuese të totalitetit letrar e mendimor naimian: “Naimi është poet, i cili intelektin e vet e brumosi me ato koncepte e botëkuptime filozofike, të cilat si qëllim më vete gjithmonë e patën humanizimin e jetës, të kontribuojnë në formimin e njeriut dhe të tërë shoqërisë njerëzore, në të cilën do të sundojnë urtësia, mirësia, dituria, mirëqenia, njerëzia, vëllazëria, dashuria e sa e sa sinonime të ngjashme, të cilat aq shpesh i përdor Naimi në tërë krijimtarinë e vet poetike. Kështu mendimi i tij filozofik del prej qaveve të nacionales dhe merr dimensione internacionaliste, bëhet i përbotshëm, bëhet mendim altruist si rrallë te ndonjë autor tjetër.”²

Përgjithësisht në këtë studim për Naim Frashërin, sikurse edhe në studimet për aurore të tjerë të letërsisë shqipe, sikundër janë Jeronim de Rada, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Sterjo Spasse etj., Profesor Xhevat Gega shpalos kapacitetet e tij njohëse e interpretuese të vlerave e të autorëve të traditës sonë letrare.

Krahas interesimit të vazhdueshëm për letërsinë shqipe, qoftë si pedagog, qoftë si autor studimesh, Xhevat Gega shfaq interesime shkencore edhe për letërsitë e kombeve të Ballkanit. Bie në sy sprovat për figurën e Vuk Karaxhiqit dhe në mënyrë të veçantë ajo për epin “Skënderbeu” të Grigor Përliçevit. Duke mos u marrë me çështjen e diskutuar gjithandej lidhur me identitetin kombëtar të këtij autori të lindur në Ohër, i cili, thënë kalimthi, për studiuesin tonë është në mënyrë të padyshimtë romantik maqedonas,

² Jehona, nr. 1, Shkup, 1991, f. 17 – 18.

vëmendja vihet te vepra në fjalë, përkatësisht burimet e frymëzimit, përkthimi në shqip dhe te receptimi i saj në kritikën tonë dhe në atë ballkanike. Njohja pothuajse shteruese e bibliografisë skënderbejane, në kontekstin ballkanik, i ka bërë të mundur Xhevat Gegës që t'i vërë në korrelacion burimet e frymëzimit të Përliçevit me veprat që i janë kushtuar heroit kombëtar të shqiptarëve Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, por në ndërlidhje edhe me kohën kur u shkrua ky ep, që përkon me paraqitjen e lëvizjeve kombëtare për çlirim nga Perandoria Osmane dhe për krijimin e shteteve kombëtare të ballkanasve. Natyrisht ky konstatim nuk mund ta përjashtojë as njëfarë afiniteti të Përliçevit për epikën, veçmas kur dihet se ai ishte përkthyes i epit “Iliada” për çka edhe i është njohur në këtë studim epiteti i “Homerit të dytë”. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe përkthimit të veprës së Përliçevit në shqip, varianteve të saj, sikurse edhe veçantive metrike me të cilat ajo vjen në gjuhën shqipe. Studimi i titulluar “Burimet e inspirimit poetik të Përliçevit për poemën “Skënderbeu” dhe përkthimi e mendimi kritik për të në gjuhën shqipe”,³ shquhet edhe në aspektin referencial, si njëri ndër kontributet që ofron burime të shumta dhe shumëplanëshe që vijnë nga anë të ndryshme. Pikëpjekjet e këtilla kulturore ndërmjet kombeve të Ballkanit Xhevat Gega i shihte jo vetëm në rrafshin historik dhe jo vetëm si fakte kulturore, por edhe si mundësi ndërveprimi, si ura afrimi ndërmjet tyre. Duke përfunduar këtë vështrim të shkurtër lidhur me modelin studimor letrar të Profesor Xhevat Gegës, shpreh gjithë konsideratën për Institutin e Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve, si organizator i këtij aktiviteti, i cili nderon veprën dhe veprimtarinë e njërit ndër bërësit e albanologjisë institucionale në Republikën e Maqedonisë,

³ Jehona, nr. 4, Shkup, 1988, f. 30 - 45.

me shpresë që, veçmas trashëgimia filologjike e Profesorit të nderuar, të botohet në një format përmbledhës dhe funksional si pjesë e korpusit të dijes shqiptare, e cila, në kohë dhe në rrethana specifike, lindi dhe u zhvillua në këtë hapësirë.

*XHELADIN MURATI**Profesor dhe studiues*

**PROFESOR XHEVAT GEGA,
ME MISION KONKRET PËR ARSIMIN,
GJUHËN DHE KULTURËN**

Në vend të hyrjes

Profesor Xhevat Gegën e njoha që kur isha nxënës i normales së Shkupit, shkollës elitare të mësuesisë “Zef Lush Marku” (kl. III dhe IV 1960 – 1962) i cili na ligjëronte gjuhën shqipe. Si profesor i gjuhës shqipe ishte i mrekullueshëm dhe këmbëngulës, meqë përpiqej që të mësonim të flasim bukur e drejt sepse nesër do të edukonim nxënës.

Puna dhe vepra e profesor Xhevat Gegës shquhet për lidhshmërinë me aktualitetin e kontrasteve që mund t’i hasim shpesh sot. Si një profesor i gjeneratës së vjetër, ai tregoi se ishte në botën e sotme dhe i frymëzuar rreth gjërave të reja. Ai shpreh një lidhje trekëndëshi në mes Nxënësit (Studentit), Dijes dhe Punës.

Normalja e Shkupit ka qenë historikisht ndër më të mirat e shkollave në Maqedoni, falë punës e pasionit të profesorëve dhe pedagogëve që punonin me nxënësit. Ajo reflektonte si vatra e dritës dhe e diturisë, e përparimit dhe e kulturës që rrezatonte në mbarë viset shqiptare të Maqedonisë. Pedagogjia dhe gjuha ishin dy shtyllat e saj kryesore të barabarta me njëra-tjetrën.

1. Kultura gjuhësore – shtylla e parë

Profesor Xhevati me qasjen e tij e bënte tërheqëse dhe të dashur gjuhën shqipe dhe letërsinë. Ai kultivoi tek nxënësit dashurinë për gjuhën, kureshtjen për ta përdorë drejtë.

Kultura gjuhësore përbënte një aspekt të rëndësishëm për normalistët e asaj kohe dhe të rëndësishëm të personalitetit të profesor Xhevat Gegës si profesor i gjuhës, që vlerësohej si bazë e zhvillimit intelektual, emocional, shoqëror e kombëtar për ne si nxënës të normales së Shkupit.

Gjuha është një mënyrë apo instrument komunikimi me të tjerët, një element universal dhe një lloj deklarimi kulturor, etnik, social apo individual. Mosnjohja e gjuhës amtare shkakton pakënaqësi që pastaj reflektohet në mënyra të ndryshme në shoqëri dhe në marrëdhënie me të tjerët. Me këtë mendim besoj se do të pajtohej edhe profesori im i nderuar.

2. Premisat

1. Profesor Xhevat Gega me librat e tij kreu edhe një funksion didaktik shumë të dobishëm për nxënësit dhe mësuesit.

2. Profesor Xhevati kishte vetëbesim për ta çuar realitetin drejt ideale.

3. Kultura kombëtare nuk duhet të harrohet, të lihet mënjanë.

4. Te profesor Xhevati hetohej një sens përgjegjësie dhe etike pune.

3. Qasjet dhe aspektet

Për profesor Xhevat Gegën mund të flitet shumë jo vetëm pse e pata profesor. Më ka pëlqyer sjellja e tij dhe puna e tij që bënte me nxënësit, disiplina dhe qëndrimi i pjekur prej edukatori. Ai kishte

mënyrë më të mirë dhe ishte këmbëngulës për ta mësuar gjuhën shqipe, për ta folur drejt me nxënësit nesër. Me sjelljen e tij na e mësoi dhe zhvilloi dashurinë për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Ai krijoi një stil dhe identitet edhe në aspektin gjuhësor.

Në orën e gjuhës shqipe, profesor Xhevati tërë rolin e tij e lidhte me bukurinë e gjuhës duke na udhëzuar se me anë të fjalës dhe vetëm nëpërmjet saj, do të ndryshosh diçka për mire. Thoshte ju do të bëheni mësues nesër dhe në fshat do ta zbatoni gjuhën letrare shqipe, me vështirësi dhe përbuzje, gjithsesi.

Më kujtohen shumë qartë udhëzimet që na jepte për punën tonë të mëtejme si mësues të së nesërmes. Ai na thoshte:

“Marrëdhënia juaj me nxënësit do jetë më e bukur po ta flisni gjuhën shqipe letrare”.

“Do t’i kushtoni më shumë rëndësi drejtshkrimit të gjuhës shqipe sepse gjuha është baza themelore për ngritjen e vetëdijes kombëtare”.

“Do të tregoheni më të kujdesshëm në të folur sepse fjalët e zgjedhura janë të veçanta në raportin që ndërtoni me nxënësit dhe insistoni që nxënësit ta përdorin gjuhën drejt e pastër edhe jashtë orës mësimore, jashtë shkollës.

Shumë më vonë, me profesor Xhevat Gegën vazhduam punën bashkërisht në Akademinë Pedagogjike të Shkupit ku unë ligjëroja metodikën e mësimdhënies së matematikës për ciklin e ultë të fillores dhe metodikën e dituri shoqërisë (1971– 1974).

Profesor Xhevat Gegën e njoh si unë ashtu edhe të tjerët si autor i Abetares, e cila përdorej nga nxënësit shqiptarë në shkollat fillore me mësim në gjuhën shqipe.

Dhe njohjen tonë, bashkëpunimin e vazhduam në aktivitetin shoqëror pas inaugurimit të demokracisë (1991) kur ne fituam një të drejtë të flasim lirshëm, të artikulojmë interesat kombëtare, kulturore, arsimore e të ngjashme.

Për shqiptarët e RMV-së, marrëdhëniet me maqedonasit dhe çuarja përpara e bisedimeve ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve të udhëhequra nga PPD-ja, u bënë përparësi dhe angazhim i përhershëm i shumë intelektualëve, përfshi këtu edhe prof. Xhevat Gegën. Ata që i dolën në rrugë procesit të barazisë dhe ngritjes kulturo-arsimore të shqiptarëve, u panë si pararojë e zhvillimit dhe njerëzit me ndikim duhej të inkuadroheshin nga postet udhëheqëse. Arsini, shkolla, lëvizjet kulturore dhe Unioni i Inteligjencies shqiptare, gjatë kohë e udhëhequr nga prof. Xhevat Gega, ishin rrugë për të arritur qëllimet e barazisë kombëtare, për të afirmuar vlerat e mirëfillta kombëtare.

Në takimet e shumta me prof. Xhevat Gegën në fakultet apo në Parlamentin e Maqedonisë, kur unë isha nënkryetar i tij, kemi biseduar gjerësisht për problemet e kulturës, arsimit, të shkollës e të gjuhës. Ai ishte shumë i matur por edhe i vendosur për realizimin e barazisë kombëtare. Madje edhe këshillonte për veprimet tona. Në një takim të radhës me të biseduam shtruar për problemet e shqiptarëve në Maqedoni dhe në një rast më tha: “Kështu do të ndodhë gjithnjë kur bëhej fjalë për barazinë e shqiptarëve dhe angazhimin e PPD-së në politikën e barazisë kombëtare, sidomos në sferën e kulturës, arsimit, shkencës, shkollës, gjuhës etj. Duhet luftë e përhershme dhe këmbëngulësi. Me maturi do të vijë koha kur punët do të fillojnë nga e mbara. Aktiviteti që realizon PPD-ja dhe angazhimi i saj do të korrë sukses. Mbeteni të qëndrueshëm dhe mos humbisni nga vizioni që keni projektuar. Rruga juaj është

e drejtë. Kulturën, arsimin, shkencën, shkollën shqipe dhe gjuhën e pret një punë e madhe. Këto kanë nevojë më tepër se kurrë për fjalën dhe angazhimin e njerëzve të ditur, profesorë, doktorë, në të mirën e zhvillimit të tyre”.

Profesor Xhevati nuk ishte drejtpërdrejt i lidhur në skenën politike, por kërkonte dhe angazhohej për realizimin e platformave politike të partive shqiptare në të mirë të përmirësimit të statusit të tij në të gjitha fushat, me theks të veçantë, në arsim, në kulturë. Ai kishte synime të qarta politike dhe kërkonte renditjen e aktiviteteve kulturore. Si kryetar i Unionit të intelektualëve shqiptarë, ai dha një sërë mendimesh dhe idesh që ishin një koleksion mendimesh të bazuara mirë në gjendjen reale të shqiptarëve dhe institucioneve në shtet. Mendimet e tij personale shpejt kapeshin nga të tjerët dhe shërbenin si koncepte e qëllime për të mbrojtur kërkesat që pretendonin shqiptarët.

Unioni i Inteligjencies shqiptare kishte për qëllim t’u shërbej interesave dhe qëllimeve publike të shqiptarëve. Dhe unë këtë shoqatë e shikoja si një përpjekje për të zhvilluar barazinë dhe konceptin se kultura kombëtare, arsini dhe shkolla duhet të vihen në plan të parë. Angazhimi i tij në misionin kombëtar ishte si një reflektim i pakënaqësisë së statusit dhe gjendjes së kulturës, arsimit dhe shkollës shqipe.

Cilat ishin kërkesat themelore të Unionit të Inteligjencies Shqiptare e cila sot nuk funksionon?

E para, se krijimtaria dhe inteligjenca shqiptare, kultura dhe arsini po e jetojnë jetën vetë, por kanë nevojë për organizim të mirëfilltë.

E dyta, Unioni i Inteligjencies Shqiptare ishte përpjekje për afirmimin e artit, kulturës, interesave dhe nevojave kulturore e arsimore të shqiptarëve në RMV.

E treta, Unioni i Inteligjencies nuk dëshmoi konsekuencë mbase se intelektualët nuk ishin të prirë t'i udhëheqë dikush, dhe sot po vazhdojnë aktivitetet vetë në forma e mënyra të ndryshme.

Unë mendoj se Unioni i Inteligjencies, në atë formë siç ishte apo në ndonjë formë të moderuar, ka nevojë të funksionojë dhe të elaborojë problemet që u përkasin kulturës, arsimit, shkollës, zhvillimit të shqiptarëve, sidomos mbijetesës së trashëgimisë sonë.

Një nga të veçantat e prof. Xhevat Gegës që e dallon atë nga shumë aktivistë të tjerë për të drejtat kombëtare është se veprimtaria e tij mund të shqyrtohet nëpërmes veprave të shkruara, librave shkollorë, fotove, materialeve, letrave nëpërmes të cilave e formojmë kujtimin ndaj tij.

Natyrisht, personaliteti krijues i prof. Gegës nuk është i ndarë nga jeta politike, arsimore e kulturore. Ai u bë i njohur edhe me botimet profesionale të literaturës metodike për nxënës e për mësues të shkollave fillore. Është autor i abetares në versionin e zhvillimit paralel të shkronjave të shtypit e të dorës dhe abetares në versionin e zhvillimit veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës dhe autor i fletoreve të punës “Shkronjat e para” nga gjuha shqipe për klasat e ulëta. Këto tekste kanë rëndësi për zhvillimin e kulturës gjuhësore të nxënësit. Njëherazi, profesor Xhevati është përkthyes i teksteve shkollorë nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe, siç janë njohuri shoqërie për klasën IV dhe V.

Një rëndësi të veçantë ka studimi shkencor “Letërsia e kombësisë shqiptare në RS të Maqedonisë prej çlirimit dhe Revolucionit popullor e deri në vitin 1985”, botuar më 1989.

Ka edhe shumë publikime të ndryshme si gazetar dhe kryeredaktor i gazetës “Flaka e vëllazërimit”, të vetmes gazetë shqipe deri në atë kohë në gjuhën shqipe në Maqedoni.

4. Përfundim

Profesor Xhevat Gega kishte forcë kulturore dhe dije të gjerë që mund të bartej në drejtime të ndryshme të bazuara gjithashtu në forcën kulturore dhe arsimore.

Ndikimi i tij psikologjik me taktin pedagogjik bënte që nxënësit të përvetësonin mire kulturën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Në fakt, me angazhimin e tij këmbëngulës, ai synonte që ne si normalistë, si mësues të së nesërme, të shërbejmë si model në zbatimin e gjuhës shqipe kudo që do të punojmë. Pra, ndikimi kulturor, arsimor e gjuhësor i prof. Xhevat Gegës forcohet dhe ajo forcë vjen nëpërmjet rrugëve të ndryshme tërthorazi apo drejtpërdrejt, duke përballuar një gamë të gjerë veprimtarish.

ZEQIRIJA NEZIRI*Profesor dhe studiues***XHEVAT GEGA PROFESOR DHE STUDIUES
I LETËRSISË SHQIPE**

Profesor Xhevati i përket brezit të parë të arsimdashësve shqiptarë, të cilit pas LDB-së i ra barra e rëndë e arsimimit të shqiptarëve të këtij krahu të kombit. Ai jetoi e veproi në një periudhë shumë të vështirë të shqiptarëve të Maqedonisë, por nuk u dorëzua. Shkriu gjithë jetën për ta çuar përpara arsimimin e tyre. Veprimtarinë e tij e zhvilloi në tri fusha kryesore: (a) në arsim, (b) në jetën publike dhe (c) në studimin e përkthimin e letërsisë shqipe në maqedonisht, si dhe të asaj maqedonase në gjuhën shqipe.

(a) Punoi si profesor në Shkollën Normale “Zef Lush Marku”, në Akademinë Pedagogjike “Kliment Ohridski” dhe në Fakultetin e Filologjisë “Blazhe Koneski” të Universitetit të Shkupit. I pajisur me një fjalor të pasur e retorikë të zhvilluar kudo që punoi si mësues i letërsisë, shënoi rezultate të lakmueshme: zëri radiofonik e bënte të afërt, ndërkaq aftësia komunikuese e bënte të pranueshëm për nxënësit e studentët. Me këto cilësi u shqua si profesor me emër që bëri përpjekje të mëdha të japë ndihmesën e tij në modernizimin e procesit mësimor dhe në implementimin e zbatimin e metodave e të standardeve moderne në mësim. Duke i pasur këto aftësi me vite ishte i angazhuar prej Entit Republikan të Përparimit të Shkollës në përgatitjen e planeve e të programeve mësimore të gjuhës e të letërsisë shqipe për shkollat parauniversitare, si në organizimin e seminareve të mësuesve të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë.

(b) Si punonjës publik u dëshmuua me përfshirjen në veprimtari të ndryshme profesionale e shoqërore. Ushtroi detyrën e redaktorit e të kryeredaktorit të gazetës “Flaka e vëllazërimit” (1974–1978); zëvendës drejtor i Akademisë Pedagogjike (1979–1981); prodekan e kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Shkupit dhe disa mandate ishte shef i Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe pranë këtij fakulteti.

Vite me radhë ishte anëtar i Këshillit Botues të revistës “Jehona” e të revistave shkencore “Shqyrtime Albanologjike” dhe “Spektar”; anëtar i fletores “Mlad borec”, si dhe anëtar i përkthyesve të letërsisë e të Kryesisë së këtij asociacioni.

Ka qenë anëtar i Këshillave republikane të ndarjes së dekoratave “11 tetori” dhe “Sh. Klimenti i Ohrit”, si dhe anëtar i komisioneve të dekorimit e të mirënjohjeve të Presidentit të Republikës dhe të Komisionit të dhënies së çmimit “Vëllezërit Miladinov” të Mbrëmjeve Poetike të Strugës.

(c) Një veprimtari të begatë profesor Xhevat Gega ka shënuar edhe në fushën librare, duke hartuar abetaren dhe fletoren e punës për klasën e parë; librin e leximit për klasat e larta, si dhe librin e letërsisë me teorinë e letërsisë për shkollat e mesme.

Me karrierën e tij shumëvjeçare universitare, prof. dr. Xhevat Gega zhvillon edhe një veprimtari të dendur e të rëndësishme profesionale e kërkimore shkencore dhe ka botuar një numër të konsiderueshëm studimesh të fushave të letërsisë. Kjo veprimtari shkencore shtrihet në tri fusha të veçanta:

(c.1) letërsia shqiptare në përgjithësi,

(c.2) letërsia krahasimtare; dhe

(c.3) letërsia shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(c.1) Ndër punimet që ka trajtuar çështje të letërsisë shqipe janë studimet mbi Teodor Kavaliotin e Mjeshtër Dhanilin, Jeronim de Radën e Naim Frashërin, Ndre Mjedën e Fan Nolin, Haki Stër-millin e Sterjo Spassen. Në këtë drejtim një vëmendje të veçantë meritojnë edhe artikujt mbi letërsinë e arbëreshëve të Italisë.

(c.2) Në veprimtarinë e tij të gjatë hulumtuese kërkimore shkencore, duke përkthyer në vijimësi tekste letrare nga letërsia maqedonase dhe duke marrë pjesë në tubime shkencore, si dhe duke e njohur në thellësi letërsinë shqiptare, prof. Xh. G. me një kulturë njohjeje të thelluar edhe të kulturave letrare të sllavëve të jugut, madje të asaj botërore, tregoi një shije të jashtëzakonshme edhe në studimet krahasimtare. Kjo veprimtari, sidomos është shprehur në hulumtimin e elementeve të përbashkëta letrare shqiptare maqedonase, ku do të rrahë çështje të pikëtakimeve të këtyre dy letërsive. Në këtë drejtim, nuk e teprojmë nëse themi se meriton epitetin e njërit prej hulumtuesve të rrallë e të vetëm në Maqedoninë e Veriut që kësaj fushe të dijës i është përkushtuar me një vëmendje të veçantë dhe, si rrjedhojë, pati sukses të sjellë rezultate të lakmueshme e të çmueshme. Midis punimeve të kësaj fushe po veçojmë punimet “*Elemente sociale në poezitë e Migjenit dhe të Racinit*”, “*Inspirimi i Përliçevit në poemën «Skëndebeu», parë nga konteksti i kritikës shqiptare*”.

(c.3) Prof. dr. Xhevat Gega me një vëmendje të veçantë ka përcjellë ecurinë e letërsisë shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë drejtim është e lakmueshme puna e tij shumëvjeçare në studimin e prurjeve të autorëve të saj. Është për t’u përmendur ndihmesa e tij në Institutin e Letërsisë në udhëheqjen dhe realizmin e projektit: “*Letërsia e shqiptarëve të Maqedonisë nga LNÇ dhe Revolucioni Socialist deri me 1985*”, që është edhe punim doktore.

Ky studim shumë i gjerë dhe i thelluar shkencor është përpjekja e parë nga mjedisi ynë, në mënyrë kritike të interpretohet e të studiohet letërsia e shqiptarëve të kësaj ane të kombit në një kontekst më të gjerë shkencor. Kjo veprimtari e gjerë shkencore është rezultat i një varg studimesh mbi veprën e autorëve të ndryshëm që krijuan në Maqedoni, siç janë studimet “*Opusi letrar i Adem Gajtani*”, “*Luan Starova dhe vepra e tij*” etj.

Në veprimtarinë e disallojshme të prof. dr. Xhevat Gegës një vend me rëndësi zë edhe veprimtaria përkthyesë. Ka përkthyer në gjuhën shqipe tekste letrare të rreth 20 autorëve të letërsisë maqedonase, kroate, serbe e botërore; si dhe të autorëve shqiptarë në maqedonisht. Midis tyre po përmendim: B. Koneskin, S. Janevskin, T. Arsovskin, R. Kërren, M. Gorkin, A. P. Çehovin, Kërlezhen, B. Nushiqin, P. Koçiqin. Për këtë veprimtari, nga Shoqata e Përkthyesve Letrarë të Maqedonisë, dy herë është shpërblyer me çmimin “Penda e artë”: (1) për punën e gjatë përkthyesë; dhe (2) vetëm për veprën e G. Todorovskit.

Ndihmesa e prof. dr. Xhevat Gegës është e rëndësishme edhe në fushën e gjuhës së sotme shqipe, sidomos në fushën e alfabetit, të drejtshkrimit e të leksikut. Ai është midis autorëve të drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1964) dhe redaktor i *Fjalorit maqedonisht – shqip*.

Emri i prof. Xhevat Gegës me pietet, respekt e dashuri përmendet nga nxënësit, studentët, kolegët, miqtë e dashamirët e letërsisë jo vetëm si mësues e profesor i shkëlqyer, i cili shumë lehtë të bënte për vete. Nuk kemi thënë asgjë nëse nuk përmendim se emri i tij do të mbahet mend si një studiues i zellshëm e i përkushtuar i letërsisë shqiptare, parë nga shumë aspekte ndërdisiplinore.

NEBI DER VISHI*Profesor dhe studiues***STRUGANI PROF. DR. XHEVAT ISMAIL
GEGA – NJË GJYSMË SHEKULLI JETË DUKE
KALITUR GJENERATA**

Në plejadën e arsimitarëve shqiptarë që iu përkushtuan arsimit të gjeneratave të reja, jo vetëm në Strugë e rrethinë, por edhe më gjerë, këtij profesioni që jo rastësisht merret si një profesion fisnik e human, është edhe strugani prof. dr. Xhevat I. Gega, i cili plot 40 vjet, deri në momentin e pensionimit, (tetor 1996), duke mos kursyer mundin dhe veprimtarinë, tërë aktivitetin punues e shkriu për arsimin e brezit të ri.

Pas Luftës së Dytë Botërore, struganët kanë dhënë një kontribut të çmuar në përhapjen e dijes dhe arsimit në mesin e popullsisë shqiptare nëpër fshatra dhe qytete të Maqedonisë. Ata, pa dyshim dhe hezitim, larg familjes, i janë përkushtuar arsimimit të shumë gjeneratave, ku ndihej mungesa e mësuesve vendas. Sipas të dhënave të dokumentuara historike, Struga, Ohri e Dibra, kanë dhënë një ndihmesë të çmuar në arsimin e popullit shqiptar në trevat lindore. Sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, numri i arsimitarëve shqiptarë nga qytetet e Strugës, Ohrit e Dibrës, që kanë shërbyer ndër vite në viset e tjera shqiptare të trevave lindore, ka qenë mbi 200, të cilët janë angazhuar në vendbanimet shqiptare nga Mexhitlia në jug të Manastirit, e deri në Tabanovcë, në veri të

Kmanovës. Në mesin e këtyre mësuesve pishtar e veteran ka qenë edhe strugani prof. dr. Xhevat Gega.⁴

Prof. Xhevat Gega lindi në Strugë, më 30 maj 1934, në një familje qytetare me taban kombëtar dhe arsimdashëse. Shkollimin fillor e kreu në qytetin e lindjes, në Strugë, në shkollën pesëvjeçare “Kongresi i Manastirit (1941–1944).⁵ Edhe shkollën shtatëvjeçare e kreu në Strugë, në shkollën “Liria” në vitet 1945–1948, ku së bashku me shumë nxënës të tjerë patën fatin të kenë pedagogë, si: Xhaferr Narazani, Zuhdi Kajanakun, Myfyt Sinojmerin, Enver Palluqin, nga Shqipëria, si dhe Sami Shehun, Avni Selamanin, Xhevat Shashkon, Refik Palloshin, Hysen Kaleshin etj.⁶

Fill pas mbarimit të shtatëvjeçares në shkollën “Liria” në Strugë, në shtatorin e vitit 1948, u regjistrua në shkollën normale “Nikolla Karev”, paralele në gjuhën shqipe në Shkup, si gjenerata e dytë me radhë.⁷ Kjo shkollë ishte hapur ekskluzivisht për fëmijët maqedonas, të cilët kishin më shumë paralele në një vit shkollor. Në vitin 1947, u hap paralelja e vetme në gjuhën shqipe, dhe në vitin 1948 edhe e dyta, që ishte gjenerata e cila kishte gjithsej 18 nxënës: katër nxënës nga Shkupi, tre nga Gostivari, 2 nga Kërçova, 7 nga Struga (Xhevat

⁴ Nebi Dervishi, Arsimi në gjuhën shqipe në Strugë e rrethinë (1941-2021), Punim në dorëshkrim.

⁵ Abdulaziz Veseli “Shkolla dhe arsimi shqip në Maqedoni (1941-1944), Tetovë 2000, f. 80-89; Nebi Dervishi, “Struga me rrethinë në vitet e Lftës së Dytë Botërore (1941-1944), Strugë, 2012, f. 188-190.

⁶ Nebi Dervishi – Mehmet Latifi, “Myfit Sinojmeri (1923-1954), pishtar I arsimit”, Shkup 2018, ITSHKSH, f. 47-42.

⁷ “Tridhjetë vjet arsim në gjuhën amtare -25 vjet veprimtari e Gimnazit Zef Lsh Marku” – botuar në Sht. Botuese “Nova Makedonija”- Shkp, 1975, f. 82.

Gega, Nexhat Mustafa, Petrit Bauta, Alinaxhi Sulo, Muhamer Vishku, Abduladi I. dhe Mehmet Berberi.⁸

Për shkak të nevojës së madhe për kuadrin arsimor, Normalja atëherë ishte tre vjeçare, kështu që kjo gjeneratë atë e kreu në vitin 1951, në Tetovë dhe i takon gjeneratës së parë të normalistëve që u diplomuan në shkollën normale “Liria”. Sipas kujtimeve të shokëve të gjeneratës (prof. Mahmut Hysa,⁹ prof. Masar Kodra, Prof. Nexhat Mustafa, etj), prof. Xhevat Gega ka qenë ndër më të mirët, i shkëlqyeshëm në sjellje e në mësim në gjeneratën e dytë, i cili me përkushtim iu rrek detyrës së shenjtë të arsimit të gjeneratave.

Me prof. Xhevatin takoheshin shpesh gjatë muajve të verës, në kohën e pushimeve. Duke pirë kafënë, ai shpaloste kujtimet për këtë periudhë të jetës së tij. Fjalët e tij ishin plot dashuri sidomos për vitet e para, pas kryerjes së Normales, ku do të ndalemi në veçanti në fund të kësaj kumtese modeste, për punën e tij në shkollën fillore në Kishavë në rrethin e Manastirit dhe në shkollën fillore “Fejzi Vinca” në Veleshtë të Strugës,¹⁰ në vitet 1951–1953.

Dëshira për zgjerimin e njohurive, e shtyn prof. Xhevatin që të ngjitet edhe më shkallëve të diturisë. Kështu që në vitet 1953–1957, është student i albanologjisë në Fakultetin Filozofik në Beograd. Pas diplomimit emërohet profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në shkollën normale “Liria” (më vonë “Zef Lush Marku”), në Shkup, ku punoi gati një dekadë të tërë.¹¹

⁸ Mahmut Hysa, Normalistët e parë shqiptarë në Maqedoni “në shërbim, të misionit të shenjtë”, në gazetën “Fakti”, dt. 31.XII.2001, f. 58-59.

⁹ Po aty.

¹⁰ Zejnulla Qyra, Veleshta në histori, Strgë, 2000, f. 282-283.

¹¹ Lljeta Jusufi, Skicë për një biografi të një pedagogu prof. dr. Xhevat Gega, në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, dt. 30.XII.1996, f. 12.

Një kohë, si i rregullt apo si bashkëpunëtor i jashtëm, prof. Xhevati ka ushtruar edhe detyrën e redaktorit të gjuhës shqipe për gazetën “Flaka”, që ishte e përjavshme, dhe për emisionet në gjuhën shqipe të Radio Shkupit.

Gjatë kësaj periudhe, këto dy redaksi vendosin t’i bëjnë hapat e parë drejt zbatimit në praktikë të gjuhës së njësuar shqipe, edhe pse drejtshkrimi ende ishte në fazën e projektit. Në këtë fushë prof. Xhevati dha një kontribut dhe angazhim të palodhshëm dhe ishte pjesëmarrës në Konsultat e Prishtinës, si dhe pjesëmarrës në hartimin e ortografisë së gjuhës shqipe, që shërbeu mjaft për periudhën tranzitore e përkohësisht deri në vitin 1972, kur u mbajt Kongresi i Drejtshkrimit në Tiranë, pjesëmarrës i të cilit ishte edhe profesor Xhevati.

Në vitet 1969–1974, punoi si profesor i letërsisë dhe i teorisë së letërsisë, e pas kësaj, deri në vitin 1978, qe kryeredaktor i redaksisë së “Flakës së Vëllazërimit”.

Në periudhën prej janarit të vitit 1979 e deri në momentet e pensionimit (tetor 1996), prof. Xhevat Gega ishte profesor i historisë së letërsisë shqipe, pranë Katedrës së Gjuhës Shqipe në Universitetin “Qirili e Metodi”, në Shkup, në ç’kohë disa herë ka qenë edhe shef i Katedrës. Angazhimi i prof. Xhevat Gegës nuk ishte i kufizuar vetëm në punën e profesorit, por, ai është marrë edhe me përpilimin e një varg teksteve mësimore për shkolla fillore e të mesme, si dhe autor i më se 130 njësive bibliografike të botuara nëpër revista dhe gazeta.¹²

Pas daljes në pension, pushimet e verës i kalonte në vendlindje, në kasabanë e Strugës, siç e quante dikur dr. I Temo. Shpeshherë

¹² “Shuhet profesor Xhevat Gega” në gazetën Koha, dt. 24. X. 2012, faqe 7.

takoheshim dhe kuvendonim gjerë e gjatë për shumë çështje. Një herë më kujtohet se u takuam në gushtin e vitit 2011.¹³ Duke pirë kafe në një lokal buzë Drinit të Zi, zhvilluam një bisedë të gjatë rreth angazhimit të tij të shumanshëm, për punën në arsim që filloi në kohën kur në Maqedoni ndihej me të madhe mungesa e kuadrit arsimor shqiptar. Për kryerjen e Normales “Liria” – në Tetovë – Shkup, fidanishtja e kuadrove që ishin në shërbim të misionit të shenjtë, për angazhimin e tij për gjuhën e njësuar shqipe, për aktivitetin e tij edhe në fushën e gazetarisë e publicistikës, në përpilimin e teksteve mësimore për shkollat fillore e të mesme etj.

Pasi dëgjoi pyetjen e radhës, prof. Xhevati nisi evokimin: “...Në qershorin e vitit 2011 mbushen plot 60 vjet kur nga shkolla normale “Liria” e Tetovës dolën maturantët e parë të një institucioni në vete e të pavarur nga të tjerët, siç ishin maturantët para nesh, të vitit shkollor 1949/50, që diplomuan si paralele e veçantë pranë shkollës normale “Nikolla Karev” në Shkup. Është një kohë tepër e largët për të përkujtuar në detaje ngjarjet e shumta që përjeton njeriu në një kohë të caktuar, aq më tepër që ajo kohë “ishite e ngatërruar me probleme të shumta të formimit të shtetit, të shpërblimit objektiv dhe real të atyre që morën pjesë në vitet e luftës antifashiste, të ndërtimit të marrëdhënieve ndërnacionale, në prioritet që duhet të përcaktohen për këtë apo për atë etnitet, në rrugën që duhej të trasohej për perspektivën e afërt e të largët të parullave që u fetishizuan dhe u bënë të paprekura e të pacenueshme, aq sa u sanksionuan me ligj si të dënueshme, siç ishin: “vëllazërim–bashkimi”, “barazia nacionale”, ndërtimi i socializmit”, “zhdukja e kulakëve për përfitime para e gjatë luftës”,

¹³ Nebi Dervishi, “Takim miqsh në Strugë, 11 gusht 2011, në Lokalin Art Kafe, në Strugë.

“sekuestrimi i pasurisë së tregtarëve”, “ndërtimi i institucioneve të sistemit socialist”, “kolektivat bujqësore”, “detyrimi i bujqve të punojnë si argat në tokat e tyre” etj. Regjimi represiv i ndjekjes dhe i mbikëqyrjes ishte më vigilent se kurrë më parë për të dëshmuar se janë më ideologë të socializmit se vetë të tjerët.

Në shtatorin e vitit 1948 u regjistruan në paralelen e dytë me radhë, pranë shkollës “Nikolla Karev” në Shkup. Ishim pra, disa muaj pas ngjarjes së madhe tronditëse të Rezolutës së Informbyrosë, apo të ndarjes së Jugosllavisë, AVNOJ-it, nga kampi i shteteve socialiste. Ishte kohë e arrestimeve, e fushatave për “gjuajtjen e shtrigave”, të atyre që nuk mund të mendonin ekzistencën e Jugosllavisë pa miqësinë e Stalinit e me tërë shtetet socialiste, ishte koha e burgosjes masive për të vetmin faj pse ishin ithtarë të vërtetë të Stalinit dhe të stalinizmit, po më shumë që stuhia i kishte fshirë përpara ideologë naivë e të paformuar që verbërisht i besonin parullave të fetishizuara, luftëtarë që kishin dalë nga lufta të zhgënjyer, po që nuk kishin forca t’ia kthejnë shpinën një ngrehurine artificiale që mund të bëhej ashtu siç ngjau më vonë, “varri më i madh” i shqiptarëve”. Shkupi për mua dhe për moshatarët e mi ishte një qytet i panjohur ose më mirë i njohur vetëm si emër. Natyrisht se Struga me Shkupin as që mund të krahasohej, sepse në këtë kohë Struga ishte kthyer në një kasaba e vogël, me një histori të lashtë, që jetonte, lundronte dhe ëndërronte me atë histori të pasur që rrebeshet e kohës, si: luftërat ballkanike, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Kryengritja e Shtatorit më 1913 dhe disfata e saj, Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, izolimi nga vendi amë pas vitit 1945, e kishin dërrmuar dhe degraduar në një vend të parëndësishëm që ishte bërë një “zonë qorre”, ku nuk qarkullonte gati asgjë, me përjashtim të trenit me binarë 60 cm (i

quajtur nga popullsia me emrin “Qiro”) si dhe shpresave që vdesin të fundit. Struga me rrethinë gjatë luftës së fundit kishte qenë një “oazë” e lëvizjes partizane, ku, mes tjerash, u formua edhe Brigada IV (VII) Sulmuese Shqiptare (10.09.1944). Dhe gjithë ai aktivitet politik tani i hakmerrej në mënyrë më brutale, ashtu si edhe në qytetet e tjera me popullsi dominante shqiptare, pa ekonomi të vogël, me bujqësi ekstensive, me grabitje konstante e të pandryshuar të pasurisë së tregtareve, duke u dhënë dëftesa të shkruara me dorë, me një rënie rapide të standardit për shkak të kolektivizmit, që shpesh shoqërohej me arrestime, tortura e burgosje. Ekonomikisht dhe politikisht Struga, si edhe qytetet e tjera kishin rënë në abisin më të thellë; papunësia ishte në shkallën më të lartë dhe shumë të rinj shkonin në Bosnjë e në vende të tjera për punë, ku një pjesë mbetën atje bashkë me familjet e reja që i krijuan.

Pasi u regjistruam në shtatorin e vitit 1948 në Shkollën Normale “Nikolla Karev”, Shkupi na u duk i madh, me ndërtesa të mëdha, me shumë rrugë që të shpinin në qendër, te Ura e Gurit. Në sheshin e madh, afër urës, që është edhe sot, në të djathtë ishte Shtëpia e Oficerëve, në të majtë banka, dy ndërtesa të mëdha që u rrënuan në tërmetin e madh të vitit 1963. Në ballë të sheshit ishte rruga e trenit, me ndërtesa të larta në të dy anët...

Në atë kohë qarkullonte vetëm një autobus me “hundë” përpara, me 30 ulëse që nisej në mëngjes dhe arrinte në mbrëmje në Strugë. Kishte edhe trenin e Vogël (Qiron) që po ashtu një herë në ditë qarkullonte. Por, ishte shumë vështirë të siguronim bileta, sepse në fillim u jepnin “udbashëve”, pastaj atyre me urdhëresa udhëtimi, atyre me vërtetim udhëtimi dhe në fund “të tjerëve” që merrte kush ishte më i fortë të shtyhej. Ne shtatë shokët nga Struga

zakonisht udhëtonim me kamionë të pambuluar dhe bëheshim tërë pluhur, sa nuk mund ta njihnim njëri-tjetrin.

Ndërtesa e shkollës ishte imponante, me panje të një oborri mbretëror, dhe se ishte me të vërtetë ndërtesa e ish-Medresesë së Madhe Mbretërore, ku ishin shkolluar fëmijët myslimanë nga tërë Jugosllavia e Versajës. Vendosi ishte e tipit konviktor të mbyllur, ku kishim fjetjen, ushqimin dhe pjesërisht edhe veshjen. Për pastrim na dërgonin bashkërisht në banjë të qytetit, të tipit të hamameve, që gjendej afër Postës dhe shtëpisë arabe, tanimë e rrënuar tërësisht. Ishim të mbyllur gjatë tërë javës. Në qytet dilnim të shëtisnim vetëm ditën e diele dhe të enjte nga 14:00 deri 16:00. Kur dikush vinte në vizitë, na thërrisnin në derën hyrëse. Mësimi zhvillohej paradite, ndërkaj pasdite organizoheshin në çdo klasë orët e studimeve, të cilat kontrolloheshin nga edukatori dhe nxënësit kujdestarë. Dhomat e fjetjes ishin në katin e tretë, ishin shumë të mëdha, ku flinim së bashku 50 nxënës. Dhomat ishin me shumë dritare, me xhama të vegjël dhe nuk kishim nxehje. Krevatet ishin prej hekuri, dyshekët prej kashte dhe mbuloheshim me disa batanije.

Ushqimi në konvikt ka qenë një kapitull në vete. Në vitin e parë erdhëm me lugë nga shtëpia. Në mensë hynim me radhë për të marrë te dera bukën dhe uleshim jo në karrige me tavolina, po në dërrasa të gjata. Ushqimi na shpërndahej me tenxhere të mëdha, një për dhjetë (10) persona dhe atë e shpërndante njëri prej nesh, dikush më shumë e dikush më pak. Ndodhte që bukën ta hanim para se të shpërndahej gjella, pse një kg bukë ndahej në dhjetë pjesë. Në rresht dëshironim të na binte qoshja e bukës, se ishte më e madhe. Na mungonte shumë buka. Shpesh na sillnin bukë nga shtëpia, por edhe gurabija, pite, etj.

Pas mbarimit të klasës së parë dhe manifestimit gjimnastikor, nuk na u lejua të shkojmë në shtëpitë tona. Na dërguan detyrimisht në punë vullnetare. Kishte filluar ndërtimi i autostradës Beograd – Zagreb dhe neve na kishin caktuar të punojmë në rajonin e Zhupanjës, në Kroaci. Na futën në trenat e kafshëve, pa ulëse e pa dritare, dhe pas një rrugëtimi të gjatë, të ngadalshëm e të mërzitshëm, arritëm më në fund në vendin e caktuar. Na qëllloi muaji me shi, puna e rëndë, shtruarja e rrugëve me gurë të thyer, vendosja e keqe në barakat me krevate prej dërrase. Dy krevate, njëri mbi tjetrin, dhe ushqim mjaft i dobët. Meqë shkolla jonë kishte më shumë vajza, nuk arritëm rezultate dhe nuk u shpallëm asnjëherë brigadë sulmuese. Për shkak të rezultateve të dobëta të punës, po më tepër pasi e panë se u dobësua shumë nga shëndeti, vendosën të na kthejnë më herët, se sa ishte paraparë. Në po ata vagonë të kafshëve na kthyen në Shkup.

Vitin e dytë shkollor 1949 / 1950 e vazhduam po në Shkup. Në fund të vitit shkollor na lajmëruan se në shtator do të vazhdojmë mësimet në Tetovë, ku do të themelohet shkolla normale e veçantë për shqiptarët. Atë verë shkuam në Strugë, unë me shokët e mi, Nexhatin, Petritin, Alinaxhiun etj.

Klasën e tretë e vazhduam në Tetovë në vitin shkollor 1950/1951, në Shkollën Normale që u themelua si institucion në vete, i pavarur, vetëm për nxënësit shqiptarë. Shkolla në Tetovë e mori emrin Shkolla Normale “Liria” – sepse u vendos në lokalet e Shkollës Fillore “Liria”. Aty e kishim edhe konviktin. Erdhi edhe fundi i vitit shkollor dhe koha e provimeve të maturës. Kaluam provimet, dhe vetëm dy ishim të shkëlqyer (unë dhe Bardhuli nga Dibra)... Ndarja nga shokët e klasës, nga mësimet, ishte shqetësuese. Më kaploi një brengë dhe një gjendje e pashpjegueshme. Me

shokët e klasës, por edhe me ato para nesh, mbetëm shokë të përjetshëm”.....¹⁴

Në pyetjen tonë se si e sheh këtë periudhë të jetës së vet, profesori na tha: “Ishte kjo një periudhë e entuziazmit të madh dhe e një krenarie që ne të rinjtë po aftësoheshim për misionin e mësuesit të popullit. Pas diplomimit, në shtatorin e 1951, me vendim të Ministrisë së Arsimit, u caktova të punoj në fshatin Kishavë të rrethit të Manastirit, së bashku me Ibrahim Sulejmanin – Pashoja (1923–1999) nga Manastiri, i cili ishte i martuar me motrën e prof. Jusuf Skoros, pra ishte dhëndër nga Struga, për të cilin edhe sot, pas 60 vjetësh, ruaj kujtimet më të mira si personalitet i mrekullueshëm”.¹⁵ Fshati Kishavë, shumë pranë kufirit shtetëror me Greqinë, kufizohet me territorin e Komunës së Resnjës. Fshati ishte kodrinor, me një lartësi mbidetare prej 860 m dhe është 27 km larg qytetit të Alfabetit, me një territor prej 19.6 km².¹⁶

Në vitin shkollor 1951–52, kur isha mësues në këtë fshat, Kishava bënte pjesë në Komunën e Velushinës dhe kishte rreth 899 banorë, të gjithë shqiptarë ku funksiononte shkolla fillore me dy paralele të kombinuara nga kl. I – IV. Banorët e Kishavës ishin njerëz të mrekullueshëm, mikpritës, të besës, na mbanin me bukë dhe na respektonin tej mase, për të cilët tërë jetën i ruaj kujtimet e mia....¹⁷

Një vit më vonë, në vitin shkollor 1952/1953, me vendim të Ministrisë së Arsimit u transferova në fshatin Veleshtë të Strugës,

¹⁴ Po aty, Takim Miqsh.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Митко Панов, Енциклопедија на селата во Р. Македонија, Скопје, 1998, стр. 150.

¹⁷ Takim miqsh në Strugë, Nebi Dervishi e prof. dr. Xhevat Gega, dt. 11 gusht 2011.

qytet i lindjes dhe i fëmijërisë sime, ku bashkë me kolegët Xhemail Oku, Zejnel Lufi, Muxhait Korça, Mehmet Berberi e të tjerë, u përpoqëm dhe në sajë të ndihmës së prindërve dhe fshatarëve veleshtarë, arritëm që shkollën fillore katërvjeçare ta avancojmë në shkollë tetëvjeçare.

Sipas shënimeve të mia, viti shkollor 1952/53 filloi më 15 shtator 1952. Ky vit shkollor për mua dhe për veleshtarët është historik, pasi për herë të parë në Veleshtë hapet kl. V, e cila ua mundësoi nxënësve vleshtarë shkollimin e mëtejshëm në fshat dhe në shkollën e tyre. Për rrjedhojë, nxënësit tanimë nuk ishin të detyruar si më parë të udhëtonin për çdo ditë për në Strugë. Hapja e pesëvjeçares në Veleshtë krijoi mundësi që në vitet që pasuan të kompletohet shkollimi tetëvjeçar në Veleshtë.¹⁸ Për hapjen e pesëvjeçares në Veleshtë, kuptohet se ka pasur një vështirësi, siç shprehej njëri ndër themeluesit e kl. V. prof. Xhevat Gega, i cili u emërua edhe drejtor i parë i tetëvjeçares, e cila shkollë po në këtë vit e merr emrin “Fejzi Vinca”.

¹⁸ Zejnulla Qyra, “Veleshta në Histori”, Strugë, 2000, f. 283.

HAKI YMERI – BINA

Profesor dhe studiues

PROFESOR XHEVATI, PEDAGOGU SI AI

*(Për një ideal që nuk u realizua as në gjallje
të prof. Xhevatit e as deri më tani)*

1) Komemoracioni dhe teksti "Kur të vdes babai"

Sa herë përmendet mbledhja e komemoracionit të profesor Xhevatit, më kujtohen ato fytyra të zymta të anëtarëve të familjes dhe të kolektivit, por mbi të gjitha lotët e asistentes së tij, tani profesor ordinar dhe fjala e mençur dhe dinjitoze e djalit – Arben Gega, i cili pas fjalëve falënderuese, e deklamoi një tekst proze poetike, ose një poezi në prozë me titull, "Kur të vdes babai", mua më kaplojnë emocionet.

Pas vdekjes së babait, zakonisht vijnë pasardhësit, vjen, djali, vajza, vijnë nipat e mbesat dhe jeta prapë vazhdon. Nuk e takova Arbenin që t'i them: ***"nuk shembet bota, nëse vdesim ne pleqtë, mos ndodhtë e kundërta në asnjë familje. Meqë unë në ty shoh zëvendësin e babait, ai duhet të jetë gjallë, i inkarnuar në ty, me të njëjtin trup, me të njëjtin zë, me të njëjtin timbër dhe forcë, me të njëjtën sjellje e kulturë"***. Po, ai i kishte këto karakteristika që e bënin njeri fisnik, të urtë e të qetë, njeri që fliste në dukje me zë deklamues, por çuditërisht me zë të butë, me kumbim të veçantë, e të njëjtin kumbim zëri e dëgjova edhe te i biri, Arbeni.

Profesori Xhevat, siç thotë prof. Mirlinda Krifca–Beqiri me ***"bagazhin e tij profesional, me përkushtimin e tij ndaj punës, me***

gatishmërinë të sakrifikohet për të tjerët, me korrektësinë dhe pedanterinë, me energjinë pozitive që rrezatonte, meriton respektin tonë më të thellë dhe sigurisht do të mbetet gjithmonë në kujtesën tonë ...”

2) Me Profesorin pata fatin të punoj e të bashkëpunoj mbi 20 vjet, përkatësisht:

a) Tri vjet në Shkollën Normale “Liria” për të mbajtur një fond 19 orësh në matematikë;

b) një dy vjet në gjimnazin “Zef Lush Marku”, tani unë i diplomuar në Fakultetin e Filologjisë, në mentorimin e profesor Xhevatit që ushtronte lëndën e Metodikës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, dhe

c) në 16 vitet e fundit në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare, prej ku edhe u pensionova.

3) Për takimin e parë me prof. Xhevat

Në vitin shkollor 1960/61 në Shkollën Normale “Liria”, më thirrën të mbaj një fond 19 orësh nga programi i matematikës për shkollat normale. Atëherë shoqëria e tërë, veças e jona shqiptare, kishte halle të mëdha për të siguruar kuadër dhe për t’i plotësuar kërkesat e mëdha që nevojiteshin, veças për matematikë, prandaj edhe unë, studenti i vitit të dytë, arrita ta kem koleg pune, një profesor sapo të diplomuar në Katedrën e Gjuhës Shqipe në Beograd. Kishte edhe profesorë të tjerë, por prof. Xhevati më ishte më i afërt, edhe për shkak të moshës, dallimit vetëm prej tre vjetësh, po edhe për shkak të kulturës së tij, gjithnjë i gatshëm për bisedë e për ndihmë. Plus kësaj, edhe unë, si ai, u strehova në një dhomë të internatit të kësaj shkolle, kështu që kishim mundësi të takoheshim shpesh, thuaja se në çdo kohë...

4) Dy fjalë për një ide, realizimi i së cilës ngjasonte me utopi

Fjala ishte për formimin e një shkolle normale, jo vetëm më të mirë se normalja jonë ku punonim, por më të mirë se të gjitha shkollat normale të tjera. Edhe këso bisedash bënim me prof. Xhevatit. Për ta arritur këtë, thoshte ai, duhet ndihmë e madhe nga shteti. Duhet krijuar shkollën me kushte të shkëlqyeshme, me mësimdhënës të vyeshëm, të arsimuar dhe të edukuar në pikëpamje pedagogjike. Nxënësit më të mirë të shkollave fillore duhet orientuar në këtë shkollë, e cila do të përgatiste mësues të vyer. Bënim fjalë, madje edhe për gjininë e të zgjedhurve të kësaj shkolle! Pa hamendje, u pajtuam se këtë shkollë duhet ta vijnë kryesisht vajzat e zgjedhura të shkollave fillore. Ato më të aftat në mësim, ato me prire këndimi e recitimi, me vesh muzikor, me aftësi pikturimi, po edhe aktrimi,....

5) Ndarja me profesorin në vitin 1963 dhe takimi me të në vitin 1974

Tërmeti na ndau (1963), mirëpo përsëri u bashkuam në vitin 1974, por tani unë jo si mësues i lëndës së matematikës, por si albanolog i diplomuar, në Gjinnazin “Zef Lush Marku” përsëri nën mentorimin e profesor Xhevatit. Kur profesori e miku im i ngushtë, Xhevati mbante lëndën e fonetikës në Katedrën e Gjuhës Shqipe, unë mbaja orë praktike, për t’u takuar më vonë për së treti herë në Fakultetin e Filologjisë në Shkup, në një periudhë jashtëzakonisht të rëndë të arsimit shqip në Maqedoni, në kohën e diferencimeve të mbi 400 njerëzve të arsimit, tani unë si ligjërues (me magjistraturë) i lëndëve Dialektologji shqiptare, Histori e gjuhës shqipe dhe një Kursi të përkthimit (shqip maqedonisht dhe anasjelltas)...

6) Katedra dhe diferecimi i kuadrit mësimor

Profesor Xhevati në këtë fakultet mbante barrën më të madhe për ta mbajtur Katedrën gjallë. Intenca e politikbërësve të atëhershëm ishte, nëse jo shkatërrimi i Katedrës, bile dëmtimi i saj, duke përjashtuar të parin doktor shkence, të cilin pas një kohe disavjeçare e kthyen përsëri në punë si dhe një ligjëruesi iu shqiptua parapërkashtim. Prof. Xhevati ishte ai që me mençurinë e tij e ndalte turrin e disave që gjithsesi donin shkatërrimin e Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Shkup. Këtë barrë të madhe e mbante duke qenë disa mandate përgjegjës Katedre (shef e quanim atëherë), si dhe një mandat Prodekan Fakulteti.

Edhe me gjithë këto telashe të mëdha, gjenim momente për biseda të lira, për gjendjen e kohës, për të bërë plane arsimore afatgjate, por ndonjëherë edhe për ndonjë shaka. Më kujtohet kur në një moment e pyeta profesorin, çka mendon për atë shkollë normale që e biseduam para vitit 1963, për rrethanat e atëhershme ndërtimi i së cilës mund të bëhej vetëm në Shqipëri e frytet e saj t'i shijojmë edhe ne këtu në Maqedoni. Hesht njëherë më tha, le të shpëtojmë tani prej kësaj telashe të madhe e pastaj shohim se çka duhet bërë.

7) Me keqardhje (pa profesorin) po e tregoj informatën që e dëgjova në Shqipëri duke qenë në pushime

Ministria e Arsimit e Shqipërisë ka vendosur t'u japë bursë studentëve të interesuar për t'u regjistruar në fakultete të mësuesisë. Mua, po edhe prof. Xhevat (sikur të ishte gjallë) do ta gëzonte lajmi, sidomos po të bëhej fjalë për nxënës që kanë kryer shkollën fillore, e më pak për maturantë të shkollave të mesme. Vajzat e mbarojnë njërën, ose të gjitha fazat e arsimit dhe mbeten në atdhe, ndërsa fatkeqësisht shumë meshkuj edhe pasi të mbarojnë studimet

ikin nga atdheu e treten nëpër botë, dhe, për të siguruar më shumë të mira materiale bëjnë punë krah, ndërsa fare pak nga ta arrijnë të sigurojnë punë intelektuale. Ky vizion largpamës i prof. Xhevatit uroj që t'u bie në vesh njerëzve me ndikim të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës për ta bërë një investim të këtillë, që do të ishte ndër investimet më të mira. Duhet ditur se **“godina ndërtohet nga themeli, e jo nga kulmi.”**

ASLLAN HAMITI*Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup*

PROFESOR XHEVAT GEGA – GOJËTAR I SHQUAR

Abstrakt

Kam pasur fatin që të jem student i profesor Xhevatit dhe të ndjek ligjëratat e shkëlqyeshme të tij nga viti i parë e deri në vitin e katërt të studimeve themelore. Studentët e tij e kujtojmë se ishte pedant në veshje, i afërt, i kulturuar, i rregullt në mësimdhënie, pedagog i shkëlqyeshëm. Përveç këtyre cilësive, ai shquhej me kulturën e gjerë dhe gojëtarinë (oratorinë) që kishte.

E folnija e Strugës, baza nyjetimore e tij, është shumë e përafërt me shqiptimin letrar, me leximin e veprave letrare artistike kishte zgjeruar fondin leksikor, me veprimtarinë e shumanshme në hartimin e teksteve shkollore, me përkthim si dhe me shumë aktivitete të tjera redaktuese, botuese, shkencore e shoqërore profesor Xhevati ishte bërë mjeshtër i fjalës. Ai qe gojëtar i shkëlqyeshëm: fliste bukur e rrjedhshëm, i lidhte bukur fjalët e shprehjet, ishte i qartë dhe bindës në atë që thoshte.

Ligjërimi i këtij njeriu të gojës dallohej me shqiptim normativ, diksion mjeshtëror, pasuri leksikore si dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Studentët me shumë vëmendje ndiqnin ligjërimin përmbajtësor, interesant, tërheqës e me plot muzikalitet. Më kujtohet se për të pasuruar fjalorin tim, unë në një fletore të posaçme shënoja çdo fjalë e shprehje të re që dëgjoja nga goja e

profesorit, duke shënuar edhe kuptimin e tyre, kështu që arrita ta hartoja një glosar mjaft të pasur, të cilin e shfletoja shpesh.

Fjalët kyçe: profesor, gojëtar, diksion, bazë nyjetimore, ligjërimit

Në periudha të caktuara të zhvillimit të popullit shqiptar, lindën dhe vepruan njerëz të penës e të pushkës që i dhanë kahen e duhur kombit e gjuhës. Falë tyre ne kemi ruajtur identitetin kombëtar, gjuhën e kulturën dhe sot gjendemi në një stad të lartë zhvillimi, krahas me popuj të tjerë të qytetëruar. Ndër veprimtarët e njohur, që me tërë qenien e tyre punuan për të mirën tonë kolektive, bën pjesë edhe profesor Xhevat Gega.

Njerëzit e mëdhenj dinë se çfarë duhet bërë në rrethana të caktuara. Në kohën kur te ne pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk dinin shkrim–lexim, vitet e pesëdhjeta të shekullit XX, profesor Xhevati punoi mësues në Manastir e Strugë, më pas profesor në normalen e Shkupit, në Akademinë Pedagogjike si dhe në Fakultetin e Filologjisë.

Për të përhapur shkronjat shqipe në Maqedoni e më gjerë, ai që nga viti 1970 botoi një Abetare, që u ribotua disa herë dhe i qëndroi kohës e vogëlushët tanë edhe sot e tutje mësojnë të shkruajnë e të lexojnë shqip. Profesori ynë e dinte se na mungonin edhe tekstet shkollore, andaj me zell të jashtëzakonshëm, përkushtim e profesionalizëm hartoi libra shkollorë për gjuhë e letërsi shqiptare (ndonjë prej tyre në bashkautorësi).

Publicistika shqipe në Maqedoni duhej filluar nga pika fillestare, andaj jo rastësisht profesor Xhevati vite me radhë e kreu me shumë sukses detyrën e redaktorit të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”.

Nevoja e kohës për përhapjen e letërsisë shqiptare te popujt e tjerë si dhe të letërsisë së huaj në shqip bëri që ai të merret edhe me përkthimin e veprave shqip–gjuhë e huaj e anasjelltas.

Padyshim, ndihmesë të madhe profesor Gega ka dhënë edhe në fushën e studimeve të letërsisë shqiptare, veçmas të asaj që krijohet në Maqedoni, po edhe në letërsinë krahasuese, sidomos ndërmjet letërsisë shqipe e asaj maqedonase. Trajtesa me vlerë na ka lënë edhe për kulturën e gjuhës, të normës standarde, si dhe çështjeve e problemeve të tjera të kohës.

Veprimtaria e tij intelektuale shtrihet edhe në jetën shoqërore e kulturore. Të kujtojmë pjesëmarrjen në shumë konferenca shkencore, tryeza të rrumbullakëta, seminare, emisione në radio e televizion, në “Mbrëmjet Strugane të Poezisë“, „Takimet e Racinit“ etj.

Me ndërgjegje, korrektësi e pedanteri ushtroi edhe detyrat redaktuese (të fjalorëve, librave, monografive) si dhe funksionet drejtuese e udhëheqëse të institucioneve arsimore e organizatave kulturore, si shëf i Katedrës (duke u ndërruar me prof. Remzi Nesimin derisa u poqën të rinjtë), zëvendësdekan, kryetar i Unionit të Inteligjencies Shqiptare në Maqedoni etj.

Si student e më pas si koleg, më mahniste se si i shkruante aq mirë e me pedanteri të rrallë shkresat zyrtare, referatet e raportet e punës në makinë shkrimi, duke i sistemuar të gjitha dokumentet e Katedrës në një dosier.

Po të përpiqemi ta përmbledhim këtë që e thamë deri më tani del se profesor Xhevat Gega është pedagog, studiues, hartues tekstesh shkollorë, përkthyes, publicist e veprimtar i shquar i jetës shoqërore e kulturore. Ai është pishtar i arsimit, përhapës i shkronjave shqipe,

i dijes dhe i ngritjes arsimore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni e më gjerë. Iluministët si prof. Xhevati, Remziu, Janura, Sylejmani me shokët ndoqën rrugën e trasuar nga Rilindësit shqiptarë. Rrugën e shkollimit, të emancipimit e të qytetërimit e ndoqën edhe studentët e tyre të Normales, Akademisë Pedagogjike e të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Shkup. Për këtë mendjendritur (bashkë me disa intelektualë të tjerë) lidhen pothuajse të gjitha arritjet arsimore e shkencore të shqiptarëve në Maqedoni gjatë 50 viteve, që nga vitet e 50-ta të shekullit të kaluar e deri në fundin e këtij qindvjeçari (deri në pensionimin e tij, më 1996).

Veprimtaria e Xhevat Gegës është shumëplanëshe. Por, mbi të gjitha për mua dhe për shumë nxënës e studentë të tij ai mbetet model i profesorit të përsosur: pedant në veshje, i rregullt në mësim, pedagog i shkëlqyer, objektiv në vlerësim, i dashur me kolegët e studentët, njohës i mirë i letërsisë shqiptare, me njohuri e kulturë të gjerë.

Në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup që nga viti 1978 e deri në pensionim, tetor 1996; përveç ndonjë lëndë tjetër, profesor Xhevati ka ligjëruar Historinë e letërsisë shqiptare 1, 2, 3, 4; përkatësisht Letërsinë e vjetër, Romantizmin, Realizmin dhe Letërsinë bashkëkohore. Kam pasur fatin që të jem student i profesor Xhevatit dhe të ndjek ligjëratat e shkëlqyeshme të tij nga viti i parë e deri në vitin e katërt të studimeve themelore.



Profesor Xhevat Gega duke më uruar me dashamirësi e përzemërsi mbrojtjen me sukses të disertacionit të doktoratës në Fakultetin e Filologjisë, Shkup, 1999

Përveç shumë vetive të një njeriu ideal, profesor Xhevati shquhej edhe si gojëtar. E folnja e Strugës, baza nyjetimore e tij, është shumë e përafërt me shqiptimin letrar. Me leximin e veprave letrare artistike kishte zgjeruar fondin leksikor, me veprimtarinë e shumanshme në hartimin e teksteve shkollore, me përkthim si dhe me shumë aktivitete të tjera redaktuese, botuese, shkencore e shoqërore, profesor Xhevati ishte bërë mjeshtër i fjalës. Ai qe gojëtar i shkëlqyeshëm: fliste bukur e rrjedhshëm, i lidhte bukur fjalët e shprehjet, ishte i qartë dhe bindës në atë që thoshte.

Ligjërimi i këtij njeriu të gojës dallohej me shqiptim normativ, diksion mjeshtëror, intonacion të përshtatshëm, pasuri leksikore si dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Ne, studentët me shumë vëmendje ndiqnim ligjërimin përmbajtjesor, interesant, tërheqës e

me plot muzikalitet. Më kujtohet se për të pasuruar fjalorin tim, në një fletore të posaçme shënoja çdo fjalë e shprehje të re që dëgjoja nga goja e profesorit, duke shënuar edhe kuptimin e tyre, kështu që arrita ta hartoja një glosar mjaft të pasur, të cilin e shfletoja shpesh.

Ligjërimi i këtij profesori ka shërbyer e do të shërbejë shembull jo vetëm për studentët e tij, por edhe për shumë folës të tjerë të shqipes. Fjalimi i profesorit ishte gjithnjë i strukturuar mirë në mënyrë logjike, drejtshqiptimore, morfosintaksore e tekstologjike. Ligjërimi i tij ishte i gjallë dhe dinamik, asnjëherë nuk bëhej monoton. Me artin e të folurit, kudo që fliste, arrinte rezultate të shkëlqyera dhe u bë një nga oratorët më të mirë të shqipes.

Ndër shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut e gjithandej ka pasur, ka e do të ketë oratorë të shkëlqyer që mendimin e kanë të formësuar, që fjalinë e kanë të saktë, që ato i vargëzojnë me mjeshtëri në periudha, paragrafë e tekste dhe mbi të gjitha që ligjërimin e kanë të nivelit intelektual.

Shqiptarët zbuluan njërën prej perlave të urtësisë për gojëtarinë, se “mijllisin e prishin ata që flasin e nuk dinë, dhe ata që dinë e nuk flasin”. Profesori ynë i nderuar edhe dinte edhe fliste. Megjithëkëtë, me sa dimë, deri më tani nuk është bërë ndonjë përpjekje për ta pasqyruar, përshkruar a hulumtuar gojëtarinë shqipe. Po të bëhej një vëzhgim i tillë, duke përzgjedhur gojëtarët më të mirë shqiptarë, mendoj se prof. Xhevat Gega do të zinte vendin e merituar si njëri ndër oratorët më të mirë në Maqedoni e më gjerë.

ISMET OSMANI

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

RRETH NDIHMESAVE TË PROFESOR XHEVAT GEGËS PËR GJUHËN DHE LETËRSINË SHQIPTARE

Veprimtaria shkencore e prof. Xhevat Gegës spikat me një varg botimesh e tekstesh mësimore si dhe artikuj gjuhësorë e shkrime në shtypin shkencor dhe në shtypin e përditshëm. Në punën e tij shkencore, tërheqin vëmendjen disa trajtesa e studime ku vështrohen mjaft aspekte të procesit krijues të autorëve bashkëkohorë shqiptarë. Veçantia e trajtesave të prof. Xh. Gegës qëndron pikërisht në origjinalitetin krijues që e tipizon këtë pedagog të gjuhës dhe letërsisë shqiptare. Në punën e tij shkencore dhe pedagogjike Xh. Gega shquhet për kreativitetin dhe qartësinë e tij me një shpirt të pasionuar pas gjuhës dhe letërsisë shqiptare.

Fjalët kryesore: *letërsi, kulturë, gjuhësia, normë letrare, tekst shkollor*

Prof. Xh. Gega zë pa dyshim një vend nderi në hapësirën e zhvillimeve dhe të arritjeve të gjuhës dhe letërsisë shqiptare në RMV. Gjuhëtar e filolog me kontribute të njohura, prof. Xh. Gega spikat edhe për organizimin e një sërë veprimtarive dhe botimeve që trajtojnë probleme të gjuhës dhe të letërsisë shqiptare. Veprimtaria kërkimore dhe pedagogjike e profesor Xhevat Gegës është ravijëzuar në gjuhën dhe letërsinë shqiptare me vijimin e gjatë të ecurisë akademike në Katedrën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të

Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Universitetin “Kirili dhe Metodi” të Shkupit, ku ka dhënë lëndë të Historisë së letërsisë shqiptare e të Metodikës.

Puna si mësues e pedagog i gjuhës e ka bërë të jetojë orë e çast me fjalën shqipe, me vlerën, peshën, vitalitetin e qëndresën e saj në shekuj, si dhe ruajtjen e pastërtisë dhe të vlerave të saj. Studimet dhe artikujt që prof. dr. Xhevat Gega ia kushton drejtpërdrejt letërsisë dhe shqipes standarde kanë në themel konceptin modern që kishin Rilindësit për gjuhën si tipari themelor i kombit. Vepra e tij është shprehje e drejtpërdrejtë e motos rilindëse “një komb – një gjuhë letrare kombëtare”, që për kombin tonë nuk e ka humbur vlerën edhe sot. Prof. Gega është njëri ndër pjesëmarrësit e Kongresit të Drejtshkrimit të shqipes dhe redaktor i Fjalorit maqedonisht – shqip.

Në fushën e teksteve shkollore edhe prof. Xh. Gega ka dhënë një ndihmesë të vyer, duke përcjellë në tekstet e tij njohuri për mënyrën se si duhet organizuar ligjërimi dhe si duhet shkruar shqipja. Prof. Xhevati veprimtarinë e tij shkencore e nis me botimin e abetares e fletoret e punës prej klasës së parë deri në të katërtën, gramatikat, librat e leximit e librat e shkollorë, siç janë letërisa me teorinë e letërsisë për shkollat e mesme të Maqedonisë, duke i udhëzuar mësuesit që t’i mësojnë nxënësit si ta përdorin drejt gjuhën shqipe dhe si t’i përzgjedhin mjetet gjuhësore në përshtatje me qëllimin.

Si në çdo fushë të veprimtarisë intelektuale, aq më shumë në atë shkencore, sidomos kur ajo mbërrin një shkallë pjekurie, ndërtohet një raport gati i domosdoshëm mes dy rrafsheve, siç janë: objektiviteti shkencor dhe qëndrueshmëria për çështjet që trajton. Studimet e prof. Xh. Gegës mbi fushën e letërsinë datojnë shumë

herët, kur kritika letrare shqiptare në trojet e ish-Jugosllavisë gjendej në hapat e saj të parë dhe ende nuk kishte arritur të bëjë të qartë fizionominë e vet teorike dhe metodologjike.

Veprimtaria e profesorit tonë në fushën e letërsisë shtrihet në tri drejtime: letërsia shqiptare në përgjithësi, studime të letërsisë krahasimtare (pikëtakimet e letërsisë shqipe me atë maqedonase) dhe letërsia shqiptare në Maqedoni. Si një studiues me shije dhe mendje të hollë, ai ka përzgjedhur e shqyrtuar vëmendshëm fjalë, vargje dhe struktura që mbartin emocione, panje dhe mendime poetike. Fryt i punës së tij shkencore janë një varg studimesh mbi Teodor Kavaliotin e Mjeshtër Dhanilin, Jeronim de Radën e Naim Frashërin, Ndre Mjedën e Fan Nolin, Haki Stërmillin e Sterjo Spassen, një varg artikujsh mbi letërsinë e arbëreshëve të Italisë, studimet mbi veprën e autorëve të ndryshëm që krijuan në Maqedoni, siç janë studimet “Opusi letrar i Adem Gajtani”, “Luan Starova dhe vepra e tij”, “Elemente sociale në poezitë e Migjenit dhe Racinit”, si dhe “Inspirimi i Përliçevit në poemën «Skëndebeu», parë nga konteksti i kritikës shqiptare.”

Në veprimtarinë e prof. Xhevat Gegës një vend me rëndësi zë edhe përkthimi si një ndër faktorët më të fuqishëm të shkëmbimeve kulturore ndërmjet popujve, rrjedhimisht një ndër faktorët vendimtarë për ecjen përpara të kulturës së një vendi, për vetë zhvillimin e tij. Shtrirja në kohë e veprimtarisë përkthimore e prof. Gegës, larmia e fushave kulturore në të cilat ajo është ushtruar, që nga veprat letrare–artistike, publicistika e të tjera, dëshmojnë se përkthimi për Xhevat Gegën ishte një veprimtari e mirëfilltë kulturore dhe shoqërore. Fusha e përkthimit për të ishte një punë e madhe konkrete, ku janë sendërtuar pikërisht parimet e shkencës gjuhësore si dhe të filologjisë e letërsisë në tërësi. Prof. Xh. Gega

përktheu në gjuhën shqipe tekste letrare të rreth 20 autorëve të letërsisë maqedonase, kroate, serbe e botërore, si dhe të autorëve shqiptarë në maqedonisht. Midis tyre po përmendim: B. Koneskin, S. Janevskin, T. Arsovskin, R. Kërren, M. Gorkin, A. P. Çehovin, Kërlezhen, B. Nushiqin etj. Për këtë veprimtari të çmuar në komunikimin midis kulturave letrare, Shoqata e përkthyesve letrarë të Maqedonisë dy herë do ta shpërblejë me çmimin “Penda e artë”: herën e parë për punën e gjatë përkthyesë dhe herën e dytë vetëm për veprën e Gane Todorovskit.

Përveçse një gjuhëtar i shquar dhe studiues i letërsisë, prof. Xhevat ka kontribute të spikatura edhe në gazetari e publicistikë. Një kohë ushtroi detyrën e redaktorit të rubrikës së kulturës, më pas të kryeredaktorit përgjegjës të gazetës “Flaka e vëllazërimit” (1974–1978). Vite me radhë ishte anëtar i Këshillit Botues të revistës “Jehona”, revistave shkencore “Shqyrtime Albanologjike” dhe “Spektri.”

Prof. Xh. Gega është një nga pedagogët dhe studiuesit e spikatur, me një varg studimesh e përkthimesh, ku përfshihen artikuj, kumtesa, referate, intervista, diskutime, në revista shkencore, në gazeta e në përmbledhje, tekste mësimore, botuar kudo, brenda e jashtë Maqedonisë. Studimet e tij janë mirëpritur dhe vlerësuar, janë botuar dhe ribotuar.

MIRLINDA KRIFCA BEQIRI

Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup

KONTRIBUTI I PROF. XHEVAT GEGËS NË FUSHËN E STUDIMEVE LETRARE

Nëse shkrintari hulumton universin, kritiku hulumton letërsinë, do të thotë universin e shenjave“

Gérard Genette

Kontributi i prof. Gegës në fushën e letërsisë metatekstuale është i hershëm dhe permanent. Shkrimi i parë që njohim daton nga viti 1959, pra nga fundi i viteve `50, koha kur kritika letrare shqiptare në trojet e ish-Jugosllavisë gjendej në hapërimet e saj të para dhe kur ajo akoma nuk kishte arritur fizionominë e vet të qartë teorike e metodologjike.

Ajo që hetohet në studimet e prof. Gegës është heterogjeniteti i tyre zhanrovik dhe periodik. Pra, tekstualiteti i tyre prek zhanre të ndryshme. Gjejmë studime që i dedikohen poezisë, prozës, dramës, ashtu siç gjejmë edhe studime që u dedikohen veprave e autorëve të periudhave të ndryshme letrare, duke filluar nga letërsia e vjetër e deri te letërsia bashkëkohore shqiptare. Në të vërtetë, në mesin e studimeve të tij, pavarësisht se në fokus të interesit mbesin studimet nga letërsia shqiptare si fushë e specializimit të tij, megjithatë nuk mungojnë edhe studimet nga fusha e letërsisë së huaj dhe letërsisë krahasimtare.

Edhe për nga lloji i tyre studimet e prof. Gegës kalojnë gati në të gjitha trajtat e shprehjes diskursive letrare, duke filluar nga shkrimet e shkurta informative mbi vepra të caktuara letrare (botuar në “Flaka e vëllazërimit”), drejt recensionit, recensionit të zgjeruar, studimeve të veçanta mbi autorë të caktuar dhe vendin që zënë ata në kontekst të letërsisë shqiptare të kohës apo letërsisë shqiptare në përgjithësi e deri te studimet monografike që kanë për qëllim të studiojnë tiparet e letërsisë së një gjenerate ose një hapësire të caktuar.

Duke qenë përfaqësues i një brezi të letërsisë metatekstuale që, kryesisht, niset nga parimet e mimesisit, është e pritshme që në studimet e tij t’i kushtohet kujdes i dukshëm kontekstit, gjegjësisht të gjejmë një gërshetim të qasjes e analizës sociologjike me impresionet. Janë këto studime të cilat vërehet ndikimi nga teoria e Gj. Lukaçit. Pra, duke pasur parasysh kontekstin, që e konsideronte kritikën letrare si pjesë të programit të përgjithshëm kulturor, ai më tepër se në fenomene e dukuri letrare, u mundua të ndalet në opusin letrar të figurave të caktuara, gjithmonë duke mbajtur llogari për lidhjen e një autori apo të një vepre të caktuar me ambientin kulturor, fryt i të cilit është.

Leximi i shkrimeve metatekstuale të prof. Gegës na bind se lloje të pastra kritike nuk ka, ashtu si nuk ka edhe metoda absolutisht të pastra. I vetëdijshëm se çdo metodë e studimit letrar ka përparësitë dhe mangësitë e veta, gjegjësisht se: *“metoda më e mirë është ajo që në rastin konkret jep rezultatin më të mirë”*,¹⁹ prof. Gega në studime të caktuara shërbehet, jo vetëm me metoda të ndryshme, por edhe me kombinim të më tepër metodave. Nuk është e vështirë të hetohet se mbështetja në metodën kronologjike të kër-

¹⁹ Agim Vinca, *Metoda letrare*, Libri shkollor, Prishtinë, 2016, f. 33.

kimeve teorike e letrare në studimet e tij është një e pranishme. Gjejmë në mesin e këtyre studimeve tipare të kritikës historike, tematike dhe sociologjike, strukturaliste dhe krahasimtare.

Metatekstet e tij karakterizohen me qasje të jashtme edhe të brendshme. Si ithtar i qasjes kulturo–historike është e pritshme që, sidomos në shkrimet e tij më të hershme, të gjejmë elemente të qasjes pozitiviste, në të cilat më shumë është e pranishme premisa e historicizmit që është karakteristikë, në radhë të parë e historianëve të letërsisë dhe që na kujton metodën e historisë së letërsisë dhe Gystav Lansonin e cila, në të vërtetë, është një metodë kulturo–historike, që niset nga bindja se studimi i një veprë apo një krijuesi kërkon që ai të studiohet edhe si trashëgues i gjeneratave të mëparme edhe si sintezë e lëvizjeve bashkëkohore ose nënkupton ndjekjen e ndikimeve që kanë ushtruar të tjerët te ai, por edhe ndikimin e tij në jetën letrare e shoqërore të kohës, meqë shkrimtari është reprezent i një epoke dhe një grupi shoqëror. Kjo qasje, në studimet e mëvonshme suksesshëm zëvendësohet me qasjen tipologjike, që vjen në shprehje sidomos në punimin e tij të disertacionit.

Duke e kuptuar shkrimin metatekstual si vetëdije mbi letërsinë, studimet e prof. Gegës, me kohë, gjithnjë e më tepër, fitojnë tipare të reja metodologjike dhe na vijnë më të konsoliduara teoretikisht dhe metodologjikisht. Janë këto shkrime të shkruara në një periudhë, kur studimet letrare te ne, më tepër se mbështetjen në një metodë, përqafojnë njëloj sinkretizimi metodologjik, pra bëhet fjalë për një kritikë integrale që mundohet të qëndrojë mes qasjes së jashtme dhe asaj të brendshme, pavarësisht se qasja e parë, sikur është më e pranishme. Pra, fitohet përshtypja se një pjesë e madhe e

shkrimeve kritike të prof. Gegës, i takojnë llojit të kritikës integrale, e cila vrojton dhe interpreton fenomenin letrar si totalitet artistik.

Nuk është e vështirë të vrojtohet se me kohë, në këto shkrime metatekstuale paraqitet intenca që impresionet të kthehen në gjykime, që rezultojnë me përfundime sociologjike, filozofike, psikologjike, etj. Pra, është kjo kritikë, ku vendin e impresionit gjithnjë e më tepër mundohet ta zë gjykimi shkencor, i argumentuar edhe me literaturë teorike, pra kritikë që mundohet që nga akti gnoseologjik të kalojë në atë aksiologjik, gjithmonë në kuptimin thjesht estetik. Është kjo kritikë që më shumë se e specializuar në aspekte të caktuara të objektit letrar, synon sintezën mes të jashtmes dhe të brendshmes, duke e kuptuar tekstin letrar jo vetëm si fryt të rrethanave, por dhe si dëshmi të tyre. Pra, studimet e tij, në pjesën dërrmuese të rasteve, mbesin të hapura ndaj orientimeve të ndryshme metodologjike e teorike, duke pranuar kështu konceptin estetik pluralist.

Studimet letrare të prof. Gegës për nga karakteri i tyre mund t'i ndajmë në: 1) studime që i referohen letërsisë shqiptare, duke filluar nga letërsia e vjetër e deri te ajo bashkëkohore, 2) studime që kanë karakter krahasimtar dhe 3) shkrime të shkurtra që kanë karakter informativ dhe prezantues.

Në grupin e parë bëjnë pjesë numri më i madh i shkrimeve metatekstuale të prof. Gegës, që u referohen personaliteteve letrare të periudhave të ndryshme letrare, duke filluar nga poezia e P. Budit, për të vazhduar me fjalorin e Dhanill Haxhiut, pastaj me autorë të romantizmit shqiptar, si: De Radën, N. Frashërin, L. Gurakuqin e F. Shirokën, për të vazhduar me veprën e N. Mjedës, F. Nolit, H. Stërmillit, R. Vokës e J. Bagerit. Nga letërsia

bashkëkohore, në qendër të interesit mbetet vepra e S. Spases, A. Islamit, L. Starovës, A. Gajtani etj.

Në mesin e studimeve të prof. Gegës që për objekt studimi kanë vepra dhe autorë të letërsisë shqiptare të traditës, në pamundësi që në një shkrim të përmasave të këtilla t'i përmendim të gjitha, do të veçojmë vetëm disa, si studimin në të cilin vihen në pah vlerat e poezisë së Naim Frashërit dhe porosia morale e saj²⁰ si dhe studimin që në qendër të vëmendjes ka rolin që luan vepra e Haki Stërmillit²¹ në emancipimin e shoqërisë shqiptare në përgjithësi, pavarësisht elementeve të theksuara sentimentale që i gjejmë në të. Në studimet mbi letërsinë e arbëreshëve të Italisë, qoftë ajo letërsi e traditës ose e kohës, Gega ndalet në tiparet identitare që letërsia e arbëreshëve arriti t'i ruajë edhe përkundër rrethanave të jetës.

Në mesin e shkrimeve metatekstuale të prof. Gegës nuk mungojnë edhe shkrimet që penetrojnë në aspektin konotativ të veprës, sidomos kur bëhet fjalë për vepra poetike. Këtu do të veçonim studimet e tij mbi poezinë e F. Nolit, A. Gajtanit, L. Starovës e A. Islamit. Në dy studimet e para, autori mëton të shpalosë kuptimin e dytë të veprës letrare që shfaqet, kryesisht, nëpërmjet të figuracionit dhe figurabilitetit të shkrimit poetik. Janë këto shkrime që dëshmojnë vetëdijen e autorit se një studiues i mirë, para se të luajë rolin e njohësit të teorive letrare dhe ndërmjetësuesit mes veprës dhe lexuesit, është një lexues i mirë. Janë këto studime në të cilat prof. Gega ndalet edhe në çështjen e gjenotekstit e fonotekstit.

²⁰ Xhevat Gega, "Porositë humane të Naim Frashërit", Jehona, Shkup, 1991, nr. 1, f. 13-18.

²¹ Xhevat Gega, "Vendi i Haki Stërmillit në letërsinë shqiptare të viteve '30", Jehona, Shkup, 1995, nr. 8, f. 21-33.

Derisa te studimi i parë²² prof. Gega fokusohet në raportin tekst – kontekst që është karakteristik për poezinë noline, në të dytin,²³ ai ndalet në tiparet moderne të poezisë së Gajtani, si poezi e simboleve, tablove poetike e imazheve si dhe në raportin tekst – tekst dhe tekst – kontekst, gjegjësisht në raportin me poezinë evropiane, sidomos me poezinë e F. G. Lorkës, si dhe raportin me folklorin, mitet e legjendat shqiptare, me Kanunin e mentalitetin shqiptar. Këtu ai arrin të ndjekë evoluimin poetik që karakterizon poezinë e këtij krijuesi që për shumëçka mbetet i veçantë, duke ndjekur transformimin dhe modernizmin që e ndjekë këtë poezi, e cila dëshmon investim të dukshëm të autorit të saj në fushën e gjuhës poetike. Këto dy studime, janë në mesin e studimeve më të arrira të autorit, që kanë shërbyer si referenca për shumë studiues.

Në studimin dedikuar karakterit universal të poezive të përmbledhjes “Kartagjena nuk mposhtet” të Luan Starovës,²⁴ Gega poezinë e Starovës e konsideron si poezi që karakterizohet me një kohezion ndërmjet subjektives dhe objektives. Autori këtu gjen një përpyetje që mitikja dhe historikja të ndërlidhen me ide dhe fenomene të kohës dhe kështu të ruhet nga harresa e kohës një qytetërim dhe një periudhë historike.

Në studimin “Qëndresa dhe revolta e poetit”,²⁵ Gega pos në veçantitë e intimes dhe rustikales në poezinë e A. Islanit, ndalet në

²² Xhevat Tahir Gega, “Diçka rreth poezisë origjinale të Nolit dhe gjenezës së saj politike”, në *Ndër bashkëkohasit*, Rilindja, Prishtinë, 1968, f. 154-195.

²³ Xhevat Gega, “Ademi Gajtani dhe opusi i tij”, në *Vepra I*, (Adem Gajtani), Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1985, f. 5 -31.

²⁴ Xhevat Gega, “Karakterit universal i një poezie”, Jehona, Shkup, 1992, nr. 4, f. 144 -148.

²⁵ Xhevat Gega, “Qëndresa dhe revolta e poetit”, Jehona, Shkup, 1995, nr. 1, f. 70-77.

ironinë dhe simbolikën e kësaj poezie, që mbetet poezi e revoltës dhe qëndresës, si dhe poezi e dhembjes e melankolisë, poezi kronotopi i së cilës lidhet me mjedisin dhe kohën nga vjen autori, mbi të gjitha me mjedisin rural, sado që nuk mungon edhe ai urban. Ai vjen në përfundim se në bazë të tipologjisë, dallojmë tri lloje të poezisë së A. Islamit: poezinë afirmative; poezinë subjektive dhe poezinë objektive. Është kjo poezi që dëshmon një dialog të realizuar letrar me baladat, legjendat e mitet.

Pos studimeve për shkrimtarë, përfaqësues të fazave e zhanreve të ndryshme letrare, prof. Gega është autor edhe i studimeve që kanë karakter më të përgjithshëm, gjegjësisht që u dedikohen fenomeneve e dukurive letrare, si çështjes së tipologjisë dhe periodizimit. I tillë është studimi mbi veçantitë e realizmit social në letërsinë tone,²⁶ studimi mbi kontinuitetin letrar shqiptar sipas shembullit të poezisë bashkëkohore të arbëreshëve të Italisë si dhe studimi që i dedikohet zhvillimit historik të letërsisë shqipe të krijuar në trojet e Maqedonisë, që paraqet edhe temën e tij të disertacionit. Duke qenë se natyra dhe mbi të gjitha, gjerësia e problemit që merr në vështrim në studimin e fundit është e karakterit historiko-letrar, shqyrtimi vetvetiu nënkupton analizë që kërkon aftësi për sintezë historike dhe mbështetje në një material të pasur letrar e teorik.

Nëse studimet e grupit të parë janë të shumta dhe përfshijnë vepra dhe autorë të zhanreve e periudhave të ndryshme, prej të cilave në këtë rast veçuam një numër të vogël, në studimet e grupit të dytë që kanë karakter krahasimtar prof. Gega ndalet, në radhë të parë, në

²⁶ Xhevat Gega, "Nota sociale në krijimtarinë e Mgenit dhe Racinit", Jehona, Shkup, 1987, nr. 10, f. 150-162.

raportet krahasimtare mes letërsisë shqipe dhe asaj maqedonase. Në këtë mes do të veçonim studimin me titull “Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit”, në të cilin ndalet në afritë mes veprës së K. Racinit dhe Migjenit, duke u ndalë në rrafshin tematik. Ajo që i afron këta dy krijues është tema e mjerimit si temë dominante e krijimtarisë së tyre.

Pos llojit të recensionit dhe studimeve të mirëfillta kritike, Gega është autor edhe i shkrimeve që për nga karakteri u takojnë teksteve të shkurtra me karakter informues dhe prezantues që praktikoheshin në faqet e kulturës së gazetave e revistave të kohës, siç ishte “Flaka e vëllazërimit”, e cila mendohej të ndjekë shembullin e “Rilindjes”, “Jetës së re” e “Fjalës” së Prishtinës. Në këtë grup, do të kishim përfshirë edhe parathëniet e shkurtra që shoqërojnë botimet apo ribotimet e veprave letrare, përfshirë këtu edhe veprat për fëmijë. Në këto shkrime, autori mban llogari për moshën e recipientëve të veprave në fjalë.

Sa i takon ligjërimit ose gjuhës me të cilën karakterizohen shkrimet e prof. Gegës, mund të themi se më tepër dominon ligjërimi shkencor, si për nga aparatura, ashtu edhe përn ga terminologjia, kurse elementet e një shkrimi hibrid janë më të pakta. Qartësia e synimeve dhe mbështetja teorike e këtyre shkrimeve bën që rezultatet e tyre të jenë të qëndrueshme dhe të pritshme.

VALBONA TOSKA*Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup***PROF. XHEVAT GEGA DHE GJUHA SHQIPE**

Epiqendra e interesimit shkencor të prof. Xhevat Gegës pa dyshim që është letërsia shqiptare. Por Profesori ynë i takon atij brezi që nuk e kishte rehatinë të përqendrohet në një segment të veçantë veprimtarie. Shtrirja e gjerë e veprimtarisë së tij është rezultat sa i kontekstit shoqëror, po aq edhe i potencialit dhe kompetencës individuale të profesor Gegës për të qenë pjesë markante

e zhvillimeve arsimore, shkencore, kulturore e shoqërore në Maqedoninë e Veriut e më gjerë. Profesori ynë zgjodhi të studiojë pikërisht gjuhën shqipe dhe letërsinë shqiptare dhe kështu shprehu vlerësinin e tij për këto shtylla të rëndësishme të identitetit tonë kombëtar. Kurse gjuha dhe letërsia nuk shkojnë dot njëra pa tjetrën. Edhe pse, siç thamë, shqyrtimi i krijimeve letrare përbën strumbullarin e veprimtarisë së prof. Xhevat Gegës, në gjithë veprimtarinë e tij shumëvjeçare dhe shumëdimensionale mund t'i lexojmë lehtë edhe raportet e prof. Xhevat Gegës me gjuhën shqipe.

Qëndrimi i tij rreth procesit të njësimit të gjuhës shqipe, flet qartë për vetëdijen e tij të lartë për rëndësinë e standardizimit të gjuhës shqipe. Suksesi i *Abetares/ve* të tij zbulon sa i përkushtuar ka qenë profesor Gega në gjetjen e metodologjisë më të përshtatshme për t'ua prezantuar shkronjat e gjuhës shqipe fëmijëve të moshës së vogël. Në përputhje me moshën e tyre, hartoi edhe tekste shkollore për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, në të cilat njësitë mësimore nga letërsia dhe gramatika nuk përmbajnë vetëm të

dhëna dhe fakte, por njëkohësisht bartin edhe shumë mesazhe për vlerën e letërsisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe. Me cilësinë e tyre, përkthimet e shumta të prof. Xhevat Gegës e pasuruan literaturën në gjuhën shqipe dhe njëkohësisht gjuha e bukur në to, e pasuroi edhe gjuhën tonë. Në Maqedoninë e Veriut çështja e përdorimit të gjuhës shqipe nuk paraqet sfidë vetëm për aktualitetin tonë. Madje, në kohën e prof. Xhevat Gegës „beteja” për përdorimin e gjuhës shqipe ka qenë shumë më shumë se një sfidë. Mirëpo kjo nuk e ka penguar Profesorin tonë të hyjë në këtë „betejë” dhe në qarqet më antishqiptare të dalë faqebardhë në mbrojtjen e gjuhës shqipe. Nuk mungojnë as punime shkencore që trajtojnë çështje nga gjuhësia shqiptare dhe ballkanike, ku do të kishim veçuar kontributin e tij në hedhjen dritë mbi kronikën e alfabeve të gjuhës shqipe. Kur flasim për standardin e gjuhës shqipe, mund të konstatojmë me gojën plot se mënyra si prof. Xhevat Gega e zbatonte normën, është pasqyra e modelit të synuar për një kulturë të lartë të gjuhës.

Këto, bashkë me shumë aktivitete të tjera të prof. Xhevat Gegës që i referohen gjuhës shqipe, flasin se qasja e tij ndaj gjuhës shqipe nuk ka qenë vetëm një qasje e pritur dhe spontane, por, do të kishim thënë se më parë kemi të bëjmë me një strategji të ideuar mirë e që ka pasur edhe qëllime të qarta: të mbjellë dashuri për gjuhën shqipe, të ngrejë vetëdijen e të tjerëve për rëndësinë e saj dhe me përkujdesjen e tij për kultivimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e gjuhës shqipe të shërbejë si shembulli më i mirë.

Qëndrimi ndaj standardit të gjuhës shqipe

Kontributi i prof. Xhevat Gegës në kuadër të gjuhës shqipe në radhë të parë shihet në rolin e tij të rëndësishëm në ndërtimin e qëndrimit rreth **standardit të gjuhës shqipe** mes shqiptarëve të

Maqedonisë së Veriut. Nga pozita e një profesori autoritar që bën pjesë në ajkën e intelektualëve të vendit tonë, prof. Xhevat Gega ka ushtruar ndikim të madh në gjeneratat e shumta që u edukuan me dashurinë dhe vlerësimin e tij për gjuhën shqipe. Përkrahja e idesë *një komb – një gjuhë* e pozicionoi Profesorin në anën e atyre që njësimin e gjuhës e shohin si krijim të një indi të fortë bashkues të shqiptarëve. Përfshirja e prof. Xhevat Gegës në vendosjen e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe daton që në v.1964 në cilësinë e anëtarit të Komisionit të ortografisë kur u përpilua *Ortografia e gjuhës shqipe* (Beograd). Më pas, në vitin 1968 prof. Gega mori pjesë aktive në përgatitjen Konsultës së Prishtinës. Në këtë Konsultë ai mbajti qëndrimin se “shqipja letrare, kudo që të përdoret, duhet të ketë një drejtshkrim të njësuar... dhe bashkë me përfaqësuesit e tjerë nga Maqedonia e Veriut nguli këmbë për të bërë edhe hapin e fundit – të njësohet jo vetëm drejtshkrimin, por edhe gjuha letrare.”

Prof. Gega është edhe redaktor i Fjalorit të parë maqedonisht – shqip (të M. Qorvezoroski dhe L. Rusi, botuar nga *Prosvetno dello*, 1967). Kjo vepër leksikografike për shumë vite ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në gjithë veprimtarinë përkthyesë në RMV.

Duhet të theksojmë se edhe në fushën e gazetarisë, ku prof. Xhevat Gega dha një kontribut të çmueshëm, edhe në detyrat udhëheqëse që ushtroi në shoqëri, Profesori është shquar për promovimin, zbatimin me korrektësinë më të madhe dhe për kujdesin rreth ruajtjes së gjuhës shqipe.

Roli i Abetares

Shumë gjenerata në botën e shkrim leximit dhe kështu edhe në botën e shkronjave shqipe, hynë pikërisht me ***Abetaren*** e prof. Xhevat Gegës. Duke u nisur nga fakti se *Abetarja* paraqet kontaktin e parë të fëmijëve me shkronjat në kuadër të institucioneve arsimore, profesor Gega është kujdesur që kjo lidhje të fillojë me një qasje shumë graduale dhe të pranueshme për botën fëmijërore. Gradual është edhe prezantimi i fondit të fjalëve dhe i strukturave gramatikore të gjuhës shqipe. Përmabajtjet e teksteve të leximit janë në përputhje të plotë me zhvillimin kognitiv të fëmijëve dhe me kontekstin shoqëror të kohës së përpilimit dhe të përdorimit. Ajo që bie në sy është se elementët e përmabajtjeve si p.sh. momentet e historisë, festat shtetërore, heronjtë etj., marrin një konotacion universal dhe mesazhet e dhëna gjithashtu orientohen nga vlerat universale, siç janë: libri, kënga, dituria, nderi etj. Një moment tjetër për t'u vlerësuar *Abetarja* e prof. Xhevat Gegës, është roli i saj në emancipimin e gruas. Përmabajtjet, ilustrimet, emrat individualë janë në funksion të promovimit të barazisë gjinore, gjë që, në kohën për të cilën flasim, ka paraqitur një largpamësi dhe vizion. I përmendim këto, sepse duam të vëmë në pah mjeshtërinë e shkathtësinë e prof. Gegës në gjetjen e mediumit – mësimi të shkrim leximit, përkatësisht mësimi të gjuhës shqipe, për t'i transmetuar të gjitha këto mesazhe të rëndësishme për brezin në formim e sipër.

Tekstet shkollore

Pothuaj e gjithë karriera e prof. Xhevat Gegës lidhet me procesin edukativo–arsimor. Edhe pse kontributi i tij më i madh ka të bëjë me nivelin e arsimit të lartë, përkatësisht me ligjëratat e tij të realizuara në katër dekada, prof. Gega la gjurmë të pashlyeshme edhe në kuadër të arsimit fillor dhe atij të mesëm.

Përveç *Abetares*, edhe një varg tekstesh shkollore të hartuara për lëndën e gjuhës shqipe në arsimin fillor e të mesëm, mbajnë autorësinë dhe bashkautorësinë e prof. dr. Xhevat Gegës (Fletë pune, Gramatika, Libra leximi).

Të gjitha këto tekste, ashtu si edhe *Abetaja* e tij janë ribotuar nga disa herë, gjë që flet për vlerat dhe sukseset e tyre. Tekstet, përveç për aparaturën përkatëse didaktike, shquhen edhe për cilësinë e gjuhës dhe stilit me të cilin janë shkruar. Dhe kjo gjuhë e zgjedhur, është gjuha të cilën e transmetuan shumë mësimdhënës dhe të cilën e njohën dhe e përvetësuan shumë gjenerata nxënësish.

Në kuadër të mësimdhënies së gjuhës dhe të letërsisë shqiptare vlen të theksojmë se Profesori ynë ka qenë edhe bashkëpunëtor në përgatitjen e planeve e programeve mësimore për gjuhën dhe letërsinë shqiptare, bashkëpunëtor dhe pjesëmarrës në seminare për ngritjen permanente të arsintarëve për shkollat e mesme me tema të ndryshme nga fusha e letërsisë dhe metodikës së mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare të organizuar nga ana e Entit Pedagogjik Republikan të Maqedonisë.

Përkthimet

Një veprimtari mjaft e frytshme dhe cilësore e prof. Xhevat Gegës është edhe ajo e përkthimit. Përveç tekste mësimore, prof. Gega përktheu edhe një varg veprash të rëndësishme nga të cilat i veçojmë *Historia e letërsisë së vjetër greke*, Shkup, Flaka 1990, f. 288 nga Kohan P.S. dhe krijimet e emrave të njohur të letërsisë maqedonase dhe jugosllave, siç janë B. Koneski, G. Todorovski, S. Janevski, T. Arsovski, M. Kërlezha, J. Plevnesh e shumë të tjerë. Duke i sjellë në shqip veprat e tyre, profesor Gega pasuroi edhe fjalën shqipe. Nga ana tjetër përkthimet e tij nga gjuha shqipe në

gjuhën maqedonase (A. Gajtani, R. Shabani etj.), kanë mundësuar që edhe lexuesi maqedonas, nëpërmjet profesorit tonë, ta njohë fuqinë shprehëse të gjuhës shqipe.

Kur jemi te përkthimet, të përmendim edhe punimin e prof. Xhevat Gegës *Fan S. Noli si përkthyes* ("Flaka e Vëllazërimit", Shkup, 10.01.1960).

Betejë për barabarësinë e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut

Gjatë gjithë jetës së tij prof. Xhevat Gega shprehu hapur qëndrimin e tij për nevojën e trajtimit të barabartë të gjuhëve. Që në vitin 1968 në shkrimin e tij *Për një barabarsi sa më besnike dhe sa më efikase të gjuhëve* ("Flaka e Vëllazërimit", Shkup, 10.10.1968), ai shpalosi këtë qëndrim të drejtë, duke hapur kështu rrugën edhe për avancimin e statusit të gjuhës shqipe. Kur pas demonstratave të vitit 1981 që u bënë në Kosovë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut u ndërmorën shumë masa të dhunshme në sferën e kulturës, të shkencës dhe të arsimit shqip, mes të cilave edhe toponimia e imponuar, profesor Xhevat Gega u rreshtua në anën e intelektualëve që i prinë kundërvënies së këtij absurditeti. Kështu, kur u mor iniciativa të sillet edhe një ligj për shkrimin dhe përdorimin e toponimeve në gjuhën shqipe sipas natyrës së gjuhës maqedonase, me arsyetimin se toponimet e gjuhës shqipe janë përkthime, profesorët e Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në mbledhjen e Komisionit të Marrëdhënieve Ndërnacionale të Kuvendit të RSM-së, të mbajtur më 1987, i shprehën argumentet shkencore të cilat penguan nxjerrjen e ligjit në fjalë. Ishte pikërisht prof. Xhevat Gega ai që e lexoi materialin e përgatitur. Përzgjedhja që ai ta bëjë këtë në një ambient aq acarues,

ishte bërë ngaqë kolegët e tij kishin vlerësuar se të gjitha argumentet do të kishin qenë edhe më bindëse, në qoftë se do të ishin shqiptuar nga ana e tij.

Këto beteja për përdorimin e duhur të gjuhës shqipe, të zhvilluara në një kontekst shoqëror krejt ndryshe nga ky i sotmi, flasin për vizionin, vendosmërinë dhe përkushtimin e Profesorit për gjetjen e rrugës më të përshtatshme dhe të pranueshme nga ana e pushtetit për realizimin e kësaj të drejte themelore të shqiptarëve në RMV. Të mos harrojmë se e gjithë kjo, në atë kohë, përveç dije e kompetencë, ka kërkuar edhe shumë guxim.

Zbatues i standardit – model për të ndjekur

Dhe në fund, është diçka shumë e veçantë që prof. Gegën e ngre mbi normat standarde që lidhen me gjuhën shqipe. Kjo është mënyra aq unike e artikulimit të fjalës shqipe. Nuk besoj se ka student që nuk i kujton me admirim ligjëratat e profesorit tonë, sa për përmbajtjen e tyre, po aq edhe për mënyrën e transmetimit të saj. Me një fjalor të zgjedhur, me një diksion të përkryer, me një zë melodik e shumë autoritar, ligjërimi i prof. Xhevat Gegës, jo vetëm që përmbushi misionin për mbjelljen e dashurisë për letërsinë tonë kombëtare, por ky ligjërim njëkohësisht shërbeu edhe si një **model i zbatimit të denjë** të gjuhës sonë.

Duke i parë gjithë këto dimensionë të veprimit të prof. Xhevat Gegës në raport me gjuhën shqipe, mund të konstatojmë se e gjithë veprimtaria e profesor Xhevat Gega në fakt mishërohet me gjuhën shqipe, gjuhën të cilën ai e deshi, e respektoi, e kultivoi dhe për zhvillimin e për ruajtjen e së cilës kontribuoi deri në fund të jetës së tij.

BERTON SULEJMANI

Universiteti "Fadil Sulejmani" – Tetovë

PROFESOR XHEVAT GEGA BASHKAUTOR I GRAMATIKAVE TË SHKOLLAVE FILLORE

Në këtë punim do të trajtojmë kontributin e profesor Xhevat Gegës si hartues i teksteve shkollore, përkatësisht "Gramatikës së gjuhës shqipe për klasën V" (në bashkautorësi me prof. dr. R. Nesimin dhe H. Rekën) e botuar nga SHB "Prosvetno dello", Shkup (1982, 1997). Thelbi i punimit do të jetë këndvështrimi i prof. Gegës për temat që lidhen me drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e gjuhës shqipe. Ky fakt, na lë të kuptojmë e të besojmë se edhe studiuesit e letërsisë, siç është rasti me prof. dr. Xhevat Gegën, por edhe me shumë të tjerë, ndonëse fusha më e gjerë e hulumtimeve ka qenë letërsia, nuk ka ngelur jashtë vështrimit të tij, asnjëherë, madje dhe nuk e kanë quajtur të huaj e të panevojshme që gjatë karrierës së tyre të trajtojnë dhe të shkruajnë për çështjet të cilat lidhen me drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e gjuhës shqipe.

Fjalë kyçe: gramatikë, drejtshkrim, drejtshqiptim, gjuhë shqipe.

Prof. dr. Xhevat Gega punoi pa u lodhur në shërbim të shkollës, shkencës dhe kulturës shqiptare. Veprimtaria e tij shkencore është e gjerë dhe e shumanshme. Askush nga intelektualët shqiptarë të këtyre trevave (që në atë kohë numëroheshin me gishtat e dorës), cilido që të jetë vokacioni a fusha themelore e kërkimit të tyre, nuk e ka quajtur dhe nuk e quan të tepërt ose të panevojshme që t'u

kushtojnë vëmendje edhe çështjeve që kanë të bëjnë me normën e shqipes standarde. Prof. Xh. Gegës së bashku me shumë personalitete të rëndësishme të këtyre trevave shqiptare u kishte rënë barra që të përballojnë çështjen e ndërlikuar, kisha thënë edhe nga faktorë jashtëgjuhësorë, të zhvillimit të shqipes standarde në Maqedoni (sot Maqedonia e Veriut, përkatësisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë), përkatësisht, të rregullave gjuhësore të shqipes që u vendosën në kongresin mbarëkombëtar të 1972-ës në Tiranë. Luhatjet e shumta drejtshkrimore që viheshin re në praktikën shkollore dhe në shtypin tonë, i dhanë një detyrë kombëtare plejadës së intelektualëve të kohës, pra edhe prof. Xhevatit, që nëpërmjet shkrimeve të ndryshme të botuara në shtypin e kohës, nëpërmjet intervistave të shumta në Radiotelevizionin e Shkupit etj., të bëjnë përpjekje që të ngrenë vetëdijen e dashurinë ndaj gjuhës amtare në rend të parë, e pastaj edhe përpjekjet për ngritjen e nivelit të zbatimit të standardit gjuhësor dhe t’ua bëjnë me dije studentëve, mësueseve, arsimtarëve etj., se kujdesi për shqipen standarde, për njohjen e për zbatimin e normës gjuhësore, mbi të gjitha, është edhe detyrë kombëtare për të gjithë.

Temat që lidhen me drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe në tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe për klasën V” gjithsej janë 17. Disa janë të emërtuara si *drejtshqiptim dhe drejtshkrim*, disa jepen si *shënime* (në fund të një njësie mësimore) edhe disa vetëm si *drejtshkrim*. Tema e parë ka të bëjë me përdorimin e drejtë të zanores *y*, që shpesh ndodh që në vend të saj të përdoret zanorja *i*. Jepen këta shembuj:²⁷

²⁷ R. Nesimi, H. Reka, Xh. Gega, *Gramatika e gjuhës shqipe për klasën V të shkollës fillore*, “Prosvetno dello”, Shkup, 1997, f. 15.

Kështu:	dhe jo kështu:
yll	ill
ylber	ilber
lyp	lip
sy	si
hymë	himë
tym	tim
këlysh	këlish etj.

Nëpërmjet shembujve të dhënë, në mënyrë të shkëlqyeshme, nxënësve, u jepen mundësi që variantin dialektor të zhbuzorëzimit të *y-së* në *i*, që është dukuri e shumë nxënësve të disa nga fshatrat e qytetit të Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit etj., ta tejkalojnë në mënyrë më të lehtë e më të qartë.

Në vazhdim jepen shembuj që t'i shqiptojmë dhe t'i shkruajmë drejt tingujt *gj* e *q* e të mos i ngatërrojmë *xh* e *ç*. Këto jepen si shënime.

Prandaj duhet përdorur:²⁸

Duhet të kemi kujdes që t'i shqiptojmë dhe t'i shkruajmë e të mos i ngatërrojmë me tingujt *xh* e *ç*.

Prandaj duhet përdorur:

gjak	dhe jo	xhak
gjethe	" "	xheth
gjumë	" "	xhum
gjuaj	" "	xhuj
gjej	" "	xhej
qafë	" "	çafë
qepë	" "	çepë
qen	" "	çen
qiell	" "	çiell
unë qesh	" "	unë çeshi

Në disa të folme shqipe disa herë në vend të tingullit *h* përdoret tingulli *f*. Prandaj, në gjuhën letrare (do të shkruhej atëherë, sot:

²⁸ R. Nesimi, H. Reka, Xh. Gega, *Gramatika e gjuhë shqipe për klasën V të shkollës fillore*, "Prosvetno dello", Shkup, 1997, f. 20.

shqipe standarde ose gjuhë standarde shqipe) duhet shqiptuar e shkruar drejt fjalët, si:²⁹

xhell – gjelle; i gjane – i xhell; gje – xheq.	
im:	
Në disa të folme shqipe disa herë në vend të tingullit h	
lli f. Prandaj në gjuhën letrare duhet shqiptuar dhe shkruar d	
drejt:	gabim:
i ftohtë	i ftoftë
i ngrohtë	i ngroftë
e nxehtë	e nxeftë
njoh	njof, (por njoftoj, njoftim)
shoh	shof
krihem	krifem
Ushtrimi 25. – Gjenerimi pesë fjalë dhe formoni fjali duke përdorur shkëtingëlloren h.	

Si shënim jepet edhe rregulli se si t'i shqiptojmë e si t'i shkruajmë togjet e zanoreve, pra t'i përdorim të plota, si:³⁰

përru-, thu-, më p-etën, fit-es, e fitu-r, kapr-all, d-ar.		
Shënim:		
Edhe kur flasim edhe kur shkruajmë, togjet e zanor përdorim të plota.		
Prandaj duhet përdorur:		
dua	dhe jo	du
duar	" "	dur
ftua	" "	ftu
bluaj	" "	bluj
kam lyer	" "	kam lyrë
krye	" "	kry
përrua	" "	përru
diell	" "	dill
miell	" "	mill
mësues	" "	mësus
kallëzues	" "	kallxus

Në gjuhën tonë kemi edhe togje bashkëtingëlloresh, siç janë: **mb**, **nd**, **ng** e të tjera. Të gjitha këto togje i shqiptojmë dhe i shkruajmë të plota, si: **i ëmbël**, **këmba**, **nderi**, **këndoj**, **ngroh**, **këngë** etj.³¹

Përveç togjeve të bashkëtingëlloresh që i përmendëm më lart, në gjuhën shqipe kemi edhe disa togje të tjera bashkëtingëlloresh, si: **pl**, **bl**, **fl**. Në disa të folme shqipe të vendit tonë, sot Maqedonia e Veriut, këto togje përdoren gabimisht. Prandaj, shkruhet në tekstin

²⁹ Po aty.

³⁰ R. Nesimi, H. Reka, Xh. Gega, *Gramatika e gjuhë shqipe për klasën V të shkollës fillore*, "Prosvetno dello", Shkup, 1997, f. 23.

³¹ Po aty.

që e kemi hulumtuar, se duhet t'i shqiptojmë e t'i shkruajmë si duhet:³²

blej	dhe jo	bjej, as bgjej, as gcej
bletë	" "	bjetë, as bgjetë, as gjetë
bli	" "	bji, as bgji
bluaj	" "	bjuj, as bgjuj, as gjuj
flakë	" "	fjakë
fletë	" "	fjetë
fle	" "	fje, (por fjeta)
flokë	" "	fjokë
flutur	" "	fjutur
plas	" "	pjas, as pqas, as qas
pak	" "	pjak, as pqak, as qak
pleh	" "	pjeh, as pqeh, as qeh
plumb	" "	pjumb, as pqumb, as qum

Duhet të kemi kujdes që t'i përdorim drejt edhe togjet *dj* dhe *tj*, të cilat në disa të folme përdoren gabimisht si *gj* dhe *q*. Kështu duhet shqiptuar dhe shkruar:³³

djalë	dhe jo	gjalë
djem	" "	gjem
djathë	" "	gjath
djep	" "	gjep
dje	" "	gje
ose		
tjetër	dhe jo	qetër, as tjtër
atje	" "	aqe, as agje
tungjatjeta	" "	tungjatqeta, as tungatjeta
tjegull	" "	qegull
24		

Rregulli tjetër drejtshkrimor ka të bëjë me shkrimin e fjalëve njësh, si një fjalë e vetme, pa vizë në mes. Të gjitha fjalët e prejardhura që formohen me anë të parashtesave shkruhen bashkë. P.sh.: **përparim** e jo: ***për parim**; **nëndrejtor** dhe jo: ***nën drejtor**; e **paarsyeshme** dhe jo ***e pa arsyeshme** etj.

Rreth ndarjes së fjalëve të prejardhura në fund të rreshtit, jepen këta shembuj dhe tregohet se ndahen në kufirin e pjesës përbërëse të tyre. P.sh.: **mos-pajtim** dhe jo ***mo-spajtim**; **shpër-ngulje** dhe jo ***shpë-rngulje** dhe as ***shpërn-gulje**.

³² R. Nesimi, H. Reka, Xh. Gega, *Gramatika e gjuhë shqipe për klasën V të shkollës fillore*, "Prosvetno dello", Shkup, 1997, f. 24.

³³ Po aty.

Parashtesat që përbëhen prej një tingulli të vetëm bashkëtingëllor, gjithnjë shkruhen bashkë: **çlirim, skamje, zmadhim, zvogëlim** etj.

Vazhdohet me drejtshkrimin e fjalëve të përbëra. Shkruhen bashkë fjalët e përbëra: **udhëheqës, bashkëpunëtor, kryengritje, besëlidhje** etj. Do të shkruhen me vizë në mes disa fjalë të përbëra, si: **qytet-muze, qytet-hero, organizatë-bazë, qen-ujk, ndihmës-mjek**³⁴ etj.³⁵

Në fund të rreshtit fjalët e përbëra duhet të ndahen në rrokje sipas përbërjes, p.sh.: **dorë-shkrim**, e jo ***do-rëshkrim**, **bukë-pjekës** e jo ***bu-këpjekës**.

Në këtë tekst shkollor nxënësit do të mësonin drejtshkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve si dhe llagapet, emrat e kafshëve, emrat e vendeve gjeografike, emrat e shkollave, të ndërmarrjeve, të revistave, të librave, të rrugëve, institucioneve shtetërore etj. Jepen rregullat e shkrimit të shkurtesave të organizatave të ndryshme, si: OKB, SHBA etj. dhe se të njëjtat duhen të shkruhen pa pikë në mes tyre. Emrat e popujve, të ditëve të javës, të muajve e të stinëve të vitit që duhet shënuar me shkronjë të vogël, si: shqiptar, e hënë, mars, pranverë e dimër.³⁶

Si rregull i drejtshkrimit të gjuhës shqipe jepet për emrat që mbarojnë me temë në **-ë**, dhe se në trajtën e shquar **ë-ja** bie para mbaresës. P.sh.: **vajzë – vajza, besë – besa, burrë – burri, lumë – lumi**.

³⁴ Ky shembull do të duhej të shkruhej: **ndihmësmjek**.

³⁵ R. Nesimi, H. Reka, Xh. Gega, *Gramatika e gjuhë shqipe për klasën V të shkollës fillore*, "Prosvetno dello", Shkup, 1997, f. 41-42.

³⁶ Po aty, f. 50-51.

Njashtu, **ë-ja** bie edhe te disa emra të gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në **-ë**, si: **ballë, brumë, djalë, gjumë, grurë, gjalpë, mjaltë** etj., te këta emra në trajtën e shquar para mbaresës **-i**, bie ë-ja: **balli, brumi, djali, gjumi, gjalpi, mjalti** etj. Po kështu **ë-ja** bie në trajtën e shquar edhe te disa emra që mbarojnë me **-ër** dhe **-ëm**: **libër – libri, emër – emri, urdhër – urdhri, gjarpër – gjarpri**, etj. Ndërsa tek emrat që mbarojnë me **-ës**, **ë-ja** ruhet edhe në trajtë të shquar: **nxënës – nxënësi, shitës – shitësi, korrës – korrësi** etj.

Në mënyrë shumë të qartë për moshën e nxënësve të ciklit fillor, jepet edhe rregulli drejtshkrimor i emrave që në trajtën e shquar mbarojnë me **-i** të theksuar të cilët nuk marrin **-ja** para mbaresës **-a**. Prandaj duhet të themi dhe duhet të shkruajmë:

qershia	dhe jo	qershija
shtëpia	„ „	shtëpia
rinia	„ „	rinia
Maqedonia	„ „	Maqedonija
liria	„ „	lirija

Në gjuhën shqipe kemi disa emra të gjinisë femërore që në trajtën e shquar mbarojnë me **-je** apo me **-jë**, si p.sh.: **fije, anije, batanije, shije** ose **bijë, shkëndijë** etj. Te këta emra në trajtën e shquar para mbaresës **-a** bie **e-ja** dhe **ë-ja**, por ruhet bashkëtingëllorja **-j**: **fija, anija, batanija, shija, shkëndija**.

Disa emra trajtën e shquar të numrit shumës e bëjnë me **-t**. Por, disa emra e bëjnë me **-të**, si: **bari–barinjtë, mulli–mullinjtë, dru–drunjtë, pe–penjtë, ka–qetë, djalë–djemtë, plak–pleqtë, qen–qentë** etj.³⁷ Emrat e gjinisë femërore që në trajtën e shquar mbarojnë me zanore të theksuar, trajtën e shquar shumës e bëjnë

³⁷ Po aty, f. 64.

me –ë, si: **fole–foletë, ide–idetë, kala–kalatë, shtëpi–shtëpitë, qershë–qershitë, kajsi–kajsitë** etj.³⁸

Drejtskrimi i numrave romakë, pra pa nyjën e përparme, jepen në rregullin e radhës. P.sh.: **klasa V, shekulli XX** e jo ***klasa e V, *shekulli i XX** etj. Por, kur shkruhen me fjalë, përdoren nyjat: **klasa e pestë, shekulli i njëzetë**.

Njësitë që lidhen me drejtskrimin e gjuhës shqipe në tekstin të cilin e kemi hulumtuar, mbaron me drejtskrimin e numërorëve themelorë prej **pesë** deri më **nëntëmbëdhjetë** të cilët duhet të shkruhen me –ë në fund. P.sh.: **shtatë, tetë, nëntë, dymbëdhjetë** etj.

Kur numërorët themelorë janë shprehje, atëherë shkruhen veç e veç dhe lidhen me lidhëzën **e**: **njëzet e dy, tridhjetë e një, shtatëdhjetë e pesë** etj.

Kur me numërorët paraqesim ditën e muajin e vitit, pas tyre vëmë pikë: 3. V. 1979, 11. X. 1941 etj.

Në fund të kësaj kumtese shkencore më duhet të them se profesor Xhevat Gega në rend të parë shquhet si studiues i letërsisë e pedagog i shkëlqyer, përkthyes i shumë veprave shkencore, shqipërues veprash letrare, pjesëmarrës në shumë simpoziume shkencore, redaktor (librash, i ***Fjalorit*** (të parë) ***maqedonisht–shqip***, të autorëve Mile Qorvezirovski, Lutfi Rusi, Prosvetno dello, Shkup, 1967), por sinonim i emrit të tij është puna e tij kolosale në hartimin e teksteve shkollore, e në veçanti, abetares simbol në vendin tonë, me të cilën të gjithë ne mësuam alfabetin e gjuhës sonë amtare. Frytet e punës së tij fisnike në shërbim të arsimit dhe

³⁸ Po aty, f. 65.

të shkencës shqiptare, me theks të veçantë arsimit dhe letërsisë shqipe që zhvillohet në këto treva shqiptare me dashamirësinë dhe zemërgjerësinë e tij fisnike ka dhënë një ndihmesë të madhe edhe në përgatitjen e një plejade studiuesish të rinj të letërsisë.

AFRIM REXHEPI*Instituti i Letërsisë Maqedonase – Shkup***KRITIKA LETRARE E XHEVAT GEGËS**

Vepra e profesor Xhevat Gegës është e karakterit poliedrik. Në bibliografinë e tij, shënohen aktivitete letrare të natyrës pedagogjike, përkthyesë dhe shkencore. Prof. Gega ka punuar në tri disiplina kryesore të shkencës së letërsisë: teoria e letërsisë (për qëllime pedagogjike), historia e letërsisë dhe kritika letrare (për qëllime kërkimore – shkencore). Në kuadër të kritikës letrare, sipas një klasifikimi të mundshëm, profesor Gega ka interpretuar shkrimtarë nga tradita e letërsisë shqipe (Jeronim De Rada, Zef Serembe, Naim Frashëri, Luigj Gurakuqi, Fan Noli, Sterio Spase etj.), si dhe shkrimtarë nga letërsia bashkëkohore (Murat Isaku, Abdulaziz Islami, Adem Gajtani etj.) Madje, Studimi *Mbi poezinë origjinale të Fan Nolit dhe gjeneza e saj politike*, mund të konsiderohet si studimi më i cituar i tij. Nuk është e rastit që në kolanën *Fan S. Noli, v. 7*, Prishtinë, 1968, nën redakturë të akad. Rexhep Qosjes, studimi në fjalë, është botuar në pjesën *Kritika letrare për Fan S. Nolin*, fakt ky që tregon për vlerat e qëndrueshme të kritikës letrare, e që prof. Gega i zhvilloi me aq përkushtim. Në kontekst, vëmendjen tonë, në këtë rast prej metakritiku, e ka tërheq studimi *Opusi letrar i Adem Gajtanit* (1985), që konsiderohet interpretimi më cilësor për veprën e njërit nga poetët më të mirë që njeh poezia bashkëkohore shqiptare.

Ajo që intrigon, është fakti i vështirësisë së definimit të kritikës, e në veçanti të kritikës letrare. Teoria e kritikës së sotme, është tejet e rezervuar në varietetet diskursive dhe interpretative, gjë që krijon

edhe konfuzione metateorike. Procedimet e teorisë së kritikës, sot janë bërë të ndryshme, mbase e cenojnë edhe objektin e kritikës. Polivalenca funksionale interpretative, pavarësia e formave dhe zhanreve, tendencat e zgjeruara gjykuese, janë fakte këto të një diskursi të “tjetërsuar” kritik. Në kontekst, në metadiskursin akademik e letrar, kritika vazhdon të përcaktohet si kritikë letrare, sipas planit semantik: gjykim, dallim dhe selektim. Tendenca do të ishte tejet funksionale për një kritikë të pastër, sikur “të përcaktohet, vërtetë të përcaktohet, kritika aktuale që do të preçizojë nevojat pragmatike letrare të momentit, këtu dhe tani”. (Zenet, 1981:404). Ekziston etimologjia e intencionalitetit logjik, mbase sipas konceptit metodologjik të Heidegger-it, pse jo edhe të estetikës subjektiviste të Kantit, e përforcuar me bindjet e kritikës impresioniste franceze, që kritika është gjykim, e gjykimi kriter paragjykes, kriteri paragjykes një mendim konceptual, e mendimi konceptual gjithmonë, në raport me konceptet tjera, e raporti interaktiv i koncepteve, krijon sistemet ideore. Padyshim që idea kreative e T. Eliot-it, me konceptin e aktivitetit kritik, është tejet funksional në polivalencën e teorisë së kritikës letrare, por koncepti teorik “kritika e kritikës” e C. Todorov-it, kalon pozitivitetin e pritshmërive teorike. “Një teori konceptuale tejet provokuese për krizën e vlerave dhe të kritikës, si dhe për hapjen e mundësisë së statusit të kritikës, “sipas kriterit metodologjik “kritika e kritikës”. (Todorov, 1984:7) Në fakt, shqetësimi i Todorovit, është i frikshëm, pasi kritika letrare po e humb kuptimin tradicional të identitetit të vet, kodin e vet, performancën e vet kritike dhe të metodave interpretative. Ajo që do të ishte definale në përcaktimet diskursive të teorisë së kritikës letrare, është çështja e përzierjes së intencave poetike dhe kritike, edhe atë, që nga polivalencat teorike antike, konkretisht, që nga koncepti teorik i Aristotelit. Ç’ështëja

qëndron në faktin që kritika është veprimtari akseologjike dhe informative (gjykim i vlerave të veprës letrare), kurse poetika është veprimtari epistemologjike. Në kontekst, ajo që vlerësohet, si nga ana e poetit, njashtu edhe nga ana e kritikut, është shkrimi.

Në fakt, kritika letrare, realizohet përmes tri funksioneve: e para është interpretative (hermeneutika është instrument i kritikës) dhe akseologjike; e dyta është edukative (pedagogjike, universitare, akademike); e treta është estetike, letrare – artistike, që realizohet atëherë kur teksti kritik i tejkalon kufijtë e perceptimit metaletrar, duke krijuar dimensionin e vet artistik. Intrigon fakti që distinkcioni dhe identifikimi i diskursit letrar, disi mund të funksionalizohet nëse kritika përcaktohet si një fushë e hapur konceptuale, stabiliteti i së cilës është periodik dhe mund të izohet në kuadër të sistemeve të ndryshme letrare dhe kulturore. Në kontekst, është funksional statusi paradoksal i Culler –it, në interaksionin kritikë letrare – teori. “Teoria e letërsisë është në shërbim konstruktiv të kritikës, duke i ndihmuar asaj që të zbulojë dhe reflektojë vepra me vlerë estetike”. (Culler, 1991: 7) Pra, diskursi kritik është metatekstual në raport me tekstet në analizë, por është edhe objekt analitik i diskurseve metatekstuale (teoriko – metodologjike) dhe transtekstuale. Duke i definuar nocionet dhe modelet epistemologjike të kritikës letrare në kohë, studiuesi A. Hoxha, shënon dy koncepte bazike që definojnë historinë e kritikës letrare: koncepti aristotelian (e bukura) dhe koncepti platonian (artistikja). “Me kalimin e kohës, konceptimi i raportit përjashtues të këtyre dy koncepteve njohëse për letërsinë do të reflektohet...në praktikën e interpretimit...si polarizim mes formës dhe përmbajtjes, strukturës dhe kuptimit, aspektit ontologjik dhe akseologjik”. (Hoxha, 2017: 43) Nëse si kriter, shënohet evoluimi nga kritika e

shijes, në kritikën e gjykimit*, sipas studiueses O. Stafasani, modelet jodefinale (në evoluim) të kritikës letrare shqiptare, do të ishin: modeli i kritikës seleksionuese (kritika e shijes) e Arshi Pipës; modeli i kritikës historiko–letrare ose integrale i Rexhep Qosjes; modeli i kritikës semiotike i Ibrahim Rugovës dhe modeli i kritikës krahasimtare i Aurel Plasarit. Është shumë sfiduese tendenca e tekstit, në funksion të kërkimit të një teorie fundamentale të kritikës letrare shqiptare, që realisht mungon.

Është tejet intrigues fakti që kritika letrare shqiptare nuk ka evoluar sipas rendit logjik të gjërave. Skema dialektike tezë – antitezë – sintezë, nuk është realizuar në formën e saj të rregullt, kështu që për zhvillimin e kritikës letrare shqiptare, mund të flasim për një zhvillim atipik. Arsyeja thelbësore e atipizmit janë rrethanat jofunksionale historiko–shoqërore dhe kulturore. Pra, mund të flasim për një strukturë binare të zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqiptare. Studiuesi A. Hoxha, ka të drejtë kur pohon që, “Për shkak të karakterit atipik, trajektorja e zhvillimit kritikë – letrar do të përmbysë rendin dialektik të logjikës: tezë, antitezë, sintezë. Kështu, në praktikën e zhvillimit të mendimit kritik letrar shqiptar...në antitezë do të përfshihen elemente të tezës dhe të sintezës”. (Hoxha, 2017: 345)

* Pa dashur të teoretizoj, ndoshta në të ardhmen, do të duhet të mendojmë për një evoluim estetik që do të çonte në një estetikë më të shpërndarë a më të zhgjeruar. Edgar Moren, në parathënien e librit të tij Estetika (2016), definon: Gjithçka që është estetike, është e integruar dhe njëkohësisht është edhe element integruar në pjesën poetike të jetës. Shija estetike, duhet të përcaktohet edhe përmes përvojës estetike, pra edhe përmes përvojës praktike. Për atë që flet Markuze, për shqisën e re dhe për një etos estetik, duhet të mendohet si për ndonjë praktikë në vepër. Apo të mendohet për faktin që hermeneutikën ta pozicionojmë në estetikë, e estetikën, në hermeneutikë, kurse nocionin bazik të hermeneutikës - interpretimin, ta shkrijmë në përvojën estetike të jetës.

Në kontekst, edhe mendimi kritik letrar i Xhevat Gegës, që kryesisht u zhvillua në gjysmën e dytë të shek. 20, është krijuar në rrethana atipike, tejet jofunksionale për një strukturë epistemologjike të kritikës letrare shqiptare. Fakti që letërsia shqiptare në Maqedoninë e Veriut, nuk ka qenë e përkrahur institucionalisht, e shpjegon më së miri zhvillimin atipik të saj. Bashkë me Ali Aliun, Agim Vincën, Mahmud Hysën, Xhevat Gega, është njëri nga kritikët e parë të këtij krahu të letërsisë shqiptare, të cilët që nga vitet e pesëdhjeta, filluan të zhvillojnë mendimin kritik letrar, krejt në rrethana atipike për letërsinë dhe kulturologjinë shqiptare. Gjenerali i kritikës letrare shqiptare (vlerësim i Alferd Uçit) Ali Aliu, precizon konceptin dhe modelin e kritikës letrare të Xhevat Gegës, që pa ndonjë përcaktim më serioz, për studimin në analizë, mund të definohet si tip i sistemit epistemik imanentist i llojit tematiko – subjektivist. “Xhevat Gega, është ndër të parët që ka botuar shkrime diskurzive, qoftë për autorë dhe vepra nga letërsia jonë bashkëkohore, qoftë për autorë dhe vepra nga tradita jonë letrare...pos informacioneve të bollshme, sjell edhe vlerësimet e veta, qoftë për vepra të veçanta, qoftë për fenomene dhe dukuri në atmosferën krijuese”. (Aliu, 2008: 8) Padyshim që citati i Ali Aliut, është bindës në përcaktim e modelit teorik të kritikës letrare të Xhevat Gegës, pasi modeli i tij epistemologjik, dallohet për nga veçoria metodologjike e sistemit epistemik imanentist i llojit tematiko–subjektivist*, edhe pse duhet

* Përcaktimet e teorisë së kritikës letrare, konceptet dhe modelet, terminologjia përkufizuese e tyre, i takojnë, përveç disa studimeve të tjera, edhe studimit Mendimi kritik letrar shqiptar – Koncepte dhe modele epistemologjike, të studiuesit Arben Hoxha. Zhvillimi i epistemologjisë analitike, shënon prapë diskurzive të A. Hoxhës, që në gjykimin tim, preçizohet përmes tre kushteve bazike: karakter eksplicit i hipotezave; nocionet preçize teorike; verifikimi i vlerësimeve a gjykimeve. Dhe jo vetëm, edhe objektivë e definuar, metoda të veçanta të hulumtimit dhe paradigmë a instrumentarium terminologjik të vetin.

të pranohet fakti që nganjëherë nuk mund të ketë përcaktime të pastra, objektive, në tekste të caktuara siç është edhe kritika letrare e Xhevat Gegës.

Pjesë përbërëse e kritikës së tij subjektive, pra siç thekson edhe kritiku Ali Aliu, është “sjellja e informacioneve të bollshme” për krijimtarinë letrare të Adem Gajtanit, njërit nga poetët më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Në kontekst, kritiku Xhevat Gega, sensi i kritikës së tij me elemente të kritikës akademike dhe objektive, definon veprën e Adem Gajtanit, duke përdorur përcaktimin e kritikut të shquar të akad. Rexhep Qosjes për evoluimin e letërsisë shqipe pas viteve të 60-ta, siç edhe shënon kritiku Gega, pjesë përbërëse e të cilës është edhe Adem Gajtani. “Evolucioni i metodës së tyre krijuese, (kupto edhe i gjeneratës së Adem Gajtanit, shënimin ynë, XH.G.) do të bëhet sa nën ndikimin e proceseve të reja të demokratizimit të marrëdhënieve shoqërore, aq edhe të zgjerimit të përvojës së tyre krijuese, sa nën ndikimin e mirëkuptimit të politikës zyrtare nda novatorizmit letrar, aq edhe nën ndikimin e timbreve të reja që depërtojnë përmes ndikimeve të jashtme”. (Gajtani, 1985:7) Sjellja e informacioneve për krijimtarinë e tij, si dhe përdorimi i citateve nga kritikët e shquar të kohës si, për shembull, Hasan Mekuli, Vehap Shita, Rexhep Qosja, Agim Vinca, Agim Deva etj., mund të gjykojmë që ndoshta preket epistemologjia e kritikës objektive ose e kritikës akademike, por në formë shumë të zbehur, sa që pastaj, bindshëm mbetet nën hijen e kritikës letrare subjektivistë, me elemente të theksuara të kritikës impresioniste.

Distinkcioni dhe identifikimi i diskursit kritik letrar të Xhevat Gegës, si për nga veçoria metodologjike, e precizuar “sistem

epistemik imanentist i llojit tematiko – subjektivist”, ka të bëjë me diskursin kritik të specializuar për të interpretuar a gjykuar, kuptimet dhe vlerat e tekstit. Kritika e tij, mund të definohet si një dimension kërkues që funksionalizon interaktivitetin dinamik midis shkrimit dhe lexuesit. Pragma interpretative e këtyre përbërësve në interaksion, shënon faktin që pozicioni kritik i Gegës, distancohet nga pozicioni i përforcuar (objektiv) shkencor, zhvillon intuitivën, humanistikën dhe potencën individuale të njohjes, duke i zbërthyer çarjet a shtresat kuptimore të tekstit. Këtë e bën, si në kritikën subjektive imanentiste me elemente të kritikës impresioniste, për poezitë me titull *Drita në zemër* (1961), njashtu edhe në poezitë me titull *Ti kangë, ti zog i largët* (1968), *Unaza* (1974), *Në ëndërr kënga* (1975), *Amfora e fundosur* (1977) dhe *Kënga e mjellmës* (1980) etj. Metakritika, shënon faktin që kritika e Gegës, është proces i modifikimeve të interaksioneve objektivo–subjektive, përjetimeve, reagimeve, vlerave dhe intencave. Në fakt, kritika e tij njeh relativizmin akseologjik dhe dëshmon faktin që dimensionet e tekstit letrar: strukturale, estetike dhe semantike, në aktin e leximit kritik, ndryshojnë dhe se teksti identifikohet me transformimet, performansat dhe versionet e ndryshme. Dhe kjo është tejet funksionale, pasi kritika mirë e pozicionuar, mundëson që teksti më mirë të vetëkontrollojë proeksionin e vet deskriptiv dhe rekonstruktiv në kuadër të paradigmave interpretative të kritikës. Metakritika apo kritika e kritikës, në vështrimin tonë, shënon faktin që kritika letrare e Xh. Gegës, bindshëm dallon objektin që përjetohet, nga përjetimi i objektit. Shënon faktin që dialogu midis autorit dhe kritikut është asimetrik, pasi bota tekstuale e poetit është e mbyllur, kurse bota e kritikut është e hapur, është metadiskursive – diskurs për një diskurs, është një interpretim që pafundësisht vazhdon.

Literaturë e konsultuar:

Aliu, Ali. (2008), Kritika letrare, Manastir.

Culler, Jonathan. (1991), Literary Theory, Oxford.

Gega, Xhevat, Opusi letrar i veprave të Adem Gajtani – parathënie, Adem Gajtani, Vepra, Shkup, 1985.

Hoxha, Arben. (2017), Mendimi kritik letrar shqiptar, Prishtinë.

Morin, Edgar. (2016) Sur L'esthétique, Paris.

Todorov, Tzvetan. (1984), Critique de la critique, Paris.

Zenet, Zerar. (1981) Francuska Nova Kritika, Sarajevo.

AJTEN HAJDARI QAMILI*Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski” – Shkup***PROF. XHEVAT GEGA PËR KULTURËN
E GJUHËS DHE NORMËN LETRARE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Merita e prof. Xhevat Gegës në fushën e normës letrare dhe të kulturës së gjuhës është e dyfishtë: nga njëra anë ai është hartues dhe drejtues i teksteve shkollore në fushën e shqipes dhe nga ana tjetër është një ndër mbrojtësit e vendosur të shqipes letrare, duke treguar me argumente shkencore e bindëse zgjidhjet e duhura dhe vendimet që ka marrë gjuhësia shqiptare në këtë fushë në kohën e duhur. Trajtesat e tij për shqipen e sotme sipas gjykimit tonë mbeten themelvënëse e orientuese në mbarë Maqedoninë e Veriut e më gjerë, të cilave u referohen studiuesit tanë të historisë e të kulturës shqiptare, por që duhet t’u referohen patjetër sidomos ata që merren me gjuhën dhe letërsinë.

Fjalët çelës: *gjuhësia shqiptare, normë letrare, tekste shkollore, kulturë e gjuhës, kultura shqiptare*

Është kënaqësi e rrallë të flas, në një rast si ky, për një profesor të veçantë, siç është profesor Xhevat Gega, njëkohësisht bashkëvendasi im, profesor ky, i cili më ka lënë përshtypje të thella qysh kur isha studente. Ai shquhej për pedantëri në veshje, për qëndrim, për zërin e tij kumbues që të kënaqte teksa ligjëronte. Ligjëratat e profesorit Xhevat ishin aq të këndshme për t’i dëgjuar, sa që pavarësisht se kalonin 3 orë as nuk e vëreja kohën. Ato sikur të

joshnin dhe të zgjonin kureshtjen për të dëgjuar akoma më shumë. Profesori Xh. Gega, dallohej për nga gojëtaria e tij, stili i ligjërimit, të shprehurit dhe periudhave të gjata të ndërtuara me shumë saktësi dhe delikatesë gjuhësore. Ai është një nga mendjet më pjellore dhe punëtor i zellshëm në mbrojtjen dhe kultivimin e shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut. Librat e tij janë punuar me përkushtim dhe pedantëri maksimale, ashtu siç ishte edhe vetë.

Në periudhën kur ende formohej Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare në Shkup si e mëvetësishme dhe nuk ishte konsoliduar si duhet, kur ende vendoseshin themelet e para, ndër profesorët e parë që doktoruan dhe ligjëruan në këtë Katedër, është edhe prof. Xhevat Gega, mes prof. P. Janura, R. Nesimi, H. Ymeri, Z. Osmani, Z. Neziri, A. Mustafa, A. Poloska etj. Që atëherë, puna dhe veprimtaria e prof. Xh. Gega, është shumë e frytshme dhe spikatet si në rrafshin shkencor, si në atë pedagogjik, si në atë mediatik etj. Veprimtaria shkencore e tij është kryesisht në fushën e letërsisë (analizë dhe kritikë letrare). Ai ka shkruar mbi 100 punime profesionale dhe shkencore dhe ka marrë pjesë në mbi 30 simpoziume shkencore. Vëmendje të veçantë meritojnë punimet mbi Jeronim De Radën, Fan Nolin, Naim Frashërin, Luigj Gurakuqin, S. Spasen, etj. Ndërkaq, veprimtaria pedagogjike e tij fillon që nga viti 1957 deri 1996 duke dhënë kontributin e tij me përkushtim maksimal. Edhe unë pata fatin të jem studentja e tij, kur ai ishte i angazhuar edhe pas pensionimit. Më pas edhe si koleg, i cili vinte shpesh në zyrë dhe bisedonim me orë të tëra për çështje të ndryshme. Prof. Xh. Gega, pas diplomimit ka punuar, së pari si profesor i gjuhës dhe letërsisë në Normalen “Zef Lush Marku” të Shkupit, ndërsa si bashkëpunëtor i jashtëm ka ligjëruar edhe në Grupin e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Akademinë e Lartë

Pedagogjike “Kliment Ohridski” të Shkupit. Që nga tetori i vitit 1969 e deri më 1974 ka punuar si profesor i lëndëve histori e letërsisë shqiptare dhe teori e letërsisë në Akademinë Pedagogjike “Kliment Ohridski” në Shkup, ku gjatë një mandati ka qenë edhe zëvendës drejtor i Akademisë Pedagogjike. Gjatë periudhës 1974–78, si bashkëpunëtor i jashtëm, ka ligjëruar metodikën e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Fakultetin Filologjik në Shkup. Që nga viti 1978 e deri në pensionim, tetor 1996, prof. Xhevat Gega punoi në Fakultetin e Filologjisë në Shkup si ligjërues i lartë e në fund, nga viti 1992 pasi doktoroi, edhe si profesor i historisë së letërsisë shqiptare, duke kryer vite të tëra edhe detyrën e shefit të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Nga tetori i vitit 1979 e deri në shtator të vitit 1981 Xhevat Gega ka qenë prodekan, pastaj kryetar i Këshillit të fakultetit, si dhe kryesues i disa komisioneve në Fakultetin e Filologjisë në Shkup.

Krahas punës profesionale në mësimdhënie, në plotësimin dhe realizimin e detyrave të punës që kishte në fakultet, profesor Gega nuk stepej së angazhuari as në hulumtimet dhe studimet shkencore. Ata që kanë vizituar dhomën e punës së tij, kanë mundur të shohin gjithmonë tavolinën e punës plot me libra duke hulumtuar dhe lexuar, kurse biblioteka e tij ishte e pasur me botime të reja dhe gjithmonë e furnizonte e e përditësonte. Falë interesimit dhe angazhimit, dëshirës dhe guximit të tij, ai ka arritur të mbrojë interesat kombëtare dhe të shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut.

Nga ajo që u vu re deri tash, e shohim se veprimtaria e prof. Xh. Gegës është e shumanshme e në rrafshe të ndryshme me qëllim emancipimin kombëtar, por unë do të ndalem vetëm në ndihmesën

e tij për kulturën e gjuhës dhe të përhapjes së shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut. Periudha kur punoi dhe veproi profesori Gega ishte pikërisht në fazat e para të hartimit të shqipes standarde. Detyra kryesore e brezit të tij ishin përhapja dhe sqarimi i shqipes së normuar në mbarë vendin, duke pasur parasysh periudhën kur Maqedonia e atëhershme kishte kontakte të kufizuara me Shqipërinë. Ai këtë e bënte nëpërmjet artikujve në gazetë, ligjëratave në fakultet dhe Abetares, sepse gurrthemeli i ngritjes së kështjellës së shqipes standarde është pikërisht abëcëja dhe tekstet që gjenden në Abetare. Aty është pikënisja e rrugëtimit në arsim dhe e nxënies së gjuhës letrare. Me një paraqitje më të thukët të veprimtarisë së prof. Xh. Gegës, mund të kuptojmë tërësisht punën dhe ndihmesat e tij për arsimin dhe kulturën gjuhësore në Maqedoninë e Veriut. Ai ka luajtur një rol të madh në themelvënien e shqipes së normuar, përhapjen, përvetësimin dhe zbatimin e saj. Si anëtar i Komisionit të ortografisë i vitit 1963, i themeluar për të dhënë kontributin në vendosjen e rregullave dhe shmangies së lëkundjeve në drejtshkrimin e gjuhës shqipe, prof. Xh. Gega jep kontributin profesional për përgatitjen dhe merr pjesë aktive në punën e Konsultës gjuhësore të Prishtinës mbajtur në vitin 1968, duke mbështetur qëndrimin: “Një komb – një gjuhë letrare”. Ai ishte një *forcë lëvizëse* që di t’i përcaktojë dhe t’i përballojë punët e detyrat dhe që ndihmon, drejton e udhëzon brezat e rinj për të zbatuar normat gjuhësore të shqipes.

Përkundër vështirësive të shumta nga politika ditore në vend, mbrojtja e gjuhës standarde ka qenë dhe mbetet një nga shqetësimet e Xhevat Gegës. Krahas shqetësimeve për zbatimin e normave të gjuhës standarde, ai ka vënë në dukje qysh herët edhe probleme që kanë kodet normative të gjuhës, të cilat pasqyrohen në pasiguritë

dhe luhatjet e folësve. Kështu, ai rreshtohet në anën e intelektualëve që janë vënë në mbrojtje të shqipes standarde nga rrënuesit e saj, duke thënë se rruga që duhet ndjekur është jo të sulmohet standardi, por të përvetësohen dhe të zbatohen normat e tij. Në këtë proces të gjithë së bashku, gjuhëtarët, mësimdhënësit dhe mediet duhet të prijnë me çdo përpjekje, secili nga aspekti i vet dhe vetëm kështu mund të arrihet në sukses të përbashkët kombëtar. Një nga këshillat e tij nëpër shkrimet në faqet e gazetave është se nuk duhet braktisur kujdesi për gjuhën amtare në favor të gjuhëve të huaja, por, përkundrazi, duhet të shtohet kujdesi për nxënien dhe përdorimin e gjuhës amtare me normat e saj dhe krahas saj të mësohen edhe gjuhët e huaja. Profesori Xh. Gega shqetësohet shumë për ndikimet që i bëhen shqipes standarde nga diglosia (nga elementet dialektore) dhe nga dygjuhësia ose shumëgjuhësia (kontakti i drejtpërdrejtë me maqedonishten dhe serbokroatishten). Për këtë arsye, ai në varg artikujsh në gazetën “Flaka e Vëllazërimit” trajton shumë çështje lidhur me këto ndikime dhe jep këshillat e tij se si t’u shmangemi këtyre ndikimeve.

Për kulturën gjuhësore në përgjithësi dhe për përhapjen e shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut, prof. Xh. Gega, si zotërues i mirë i normave gjuhësore, ka dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme edhe nëpërmjet redaktimit të shtypit ditor. Ai vite me radhë ka qenë redaktor i rubrikës kulturore në Redaksinë e gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, kurse nga viti 1974 – 1978 ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës “Flaka e Vëllazërimit” si dhe i edicioneve të tjera në gjuhën shqipe, të cilat botoheshin në RMV.

Ndihmesë të madhe prof. Xh. Gega ka dhënë edhe nëpërmjet përkthimeve të teksteve mësimore, sepse për nevojat e ShB

“Prosvetno dello” dhe Entit për botimin e teksteve mësimore nga Prishtina, ka përkthyer 15 tekste mësimore për arsimin fillor e të mesëm, si edhe është autor i një numri të madh tekstesh origjinale. Më të rëndësishmet janë Abetarja – botimi i parë në vitin 1970 e që do të pësojë ribotime gjatë viteve dhe adaptime sipas planprogrameve mësimore të arsimit fillor nëntëvjeçar deri në kohët e tashme, pastaj fletoret e punës për klasat I – IV me disa ribotime, Letërsia me teorinë e letërsisë për klasën e parë të shkollave të mesme, Gramatika për klasën IV dhe V dhe Letërsia me shembuj për klasën e parë të arsimit të mesëm.

Përveç kësaj, ai ka përkthyer edhe 20 libra nga maqedonishtja dhe serbokroatishtja në shqipe si dhe nga shqipja në maqedonishte (B. Koneski, S. Janevski, T. Arsovski, M. Kërlezha, G. Todorovski, J. Plevnesh, R. Shabani, etj.).

Në përmbyllje po them se prof. Xh. Gega është njëri nga profesorët e rrallë, i cili duhet të shërbejë si model për gjeneratat e reja për pedantërinë e punës, përkushtimin e madh, seriozitetin në çdo detyrë dhe atë fytyrë të ëmbël dhe të buzëqeshur gjithmonë teksa ligjëronte. Të gjithë ata që kanë mësuar nga prof. Xhevati qoftë nga ligjëratat e tij, qoftë nga Abetarja, nga librat, studimet apo edhe nga artikujt e gazetave, ku ai me zotësi të rrallë ka dhuruar pareshtur dije, përvojë, profesionalizëm dhe gatishmëri për të ndihmuar, e dinë dhe e ndiejnë mirë kontributin që ka dhënë ai për shqipen dhe shqiptarët në Maqedoninë e Veriut. Ai ka mbjellë pemë të shumta gjatë rrugës së jetës së tij dhe ne sot mbledhim frutat, duke e uruar dhe përgëzuar profesorin. Ai ishte një personalitet kulturor e shoqëror me ndikim në jetën intelektuale të shqiptarëve në vend dhe jashtë.

Do të kisha dashur shumë që kjo tribunë shkencore kushtuar profesorit Xhevat Gega të ishte organizuar derisa ishte ai ende gjallë e të ishte në mesin tonë, që të dëgjonte këto lavde që janë thurur për të.

ZEQIRIJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

ILUMINISTI XHEVAT GEGA

Moderniteti i njeh disa etapa të krijimit të kombit, ndërsa ndër fazat fillestare është iluminizmi. Dhe, çdo kohë i ka iluministët e saj dhe secili komb, që shkon drejt kombndërtimit, në kuptimin modern të këtij nocioni, e përjeton iluminizmin e tij. E tillë është edhe historia e kombformimit të shqiptarëve, në përgjithësi, dhe në atë që sot është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Siç e dimë, arsimi shqip në këtë shtet vetëm viteve të fundit ka shënuar disa përparime, por historia e shkollës shqipe në këtë shtet është e mbushur me plot peripeci, sa të natyrës politike, por edhe me pengesa të tjera të mungesës së kuadrit, mungesës së mjeteve mësimore, mungesës së objekteve e mungesës së infrastrukturës tjetër për zhvillim normal të arsimit shqip.

Duke jetuar në ish–Jugosllavinë socialiste, ku shqiptarët e kishin statusin e kombësisë, ndërsa jetonin në disa republika federale (pos Kosovës si krahinë autonome), rruga e kombformimit të shqiptarëve si komb nuk ka qenë edhe gjithaq e lehtë. Meqë statusi i kombit nuk ishte i njohur për shqiptarët në atë shtet, madje as për shqiptarët e Kosovës, e të mos flasim për shqiptarët në Maqedoni, kjo gjendje detyrimisht është reflektuar edhe në gjendjen e arsimit. Nga historia e re e shqiptarëve në Maqedoni e dimë mirëfilli se sa e vështirë ka qenë rruga e krijimit të disa shkollave të mesme me mësim në gjuhën shqipe, për të mos folur për rrugën e vështirë të ndërtimit të arsimit universitar në gjuhën shqipe, me ç’rast kishte

edhe viktima (më 1994 gjatë themelimit të Universitetit të Tetovës).

Kur kësaj ia shtojmë edhe kuadrin e paktë që atëbotë krijohej në Prishtinë ose në Shkup (në gjuhën maqedonase), por edhe mungesën e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, të jesh intelektual shqiptar në Maqedoni në vitet e komunizmit jugosllav nuk ka qenë edhe gjithaq e lehtë. Duke qëndruar larg patetizimit patriotik të arsimitarëve dhe profesorëve shqiptarë të asaj kohe, e mbajmë mend kohën e diferencimeve politike të intelektualëve edhe për një “gabim” të vogël ideologjik.

Megjithatë, pavarësisht presionit të kohës, intelektualët shqiptarë të asaj kohe ishin të ndërgjegjshëm se kombi nuk bëhet pa arsim dhe ata iu përkushtuan detyrës arsimore si ideali më i lartë kombëtar. Në të vërtetë nacionalizmi progresiv, që si fryt e ka kombin, nuk mund të lindë te një komunitet që nuk ka arsim të organizuar.

Iluminizmi dhe Rilindja Kombëtare Shqiptare

Iluminizmi, që në Europë lindi në shek. XVIII dhe vazhdoi deri në Revolucionin Francez (1789), ishte përpjekje për ta çliruar mendjen njerëzore nga pengesat e paragjyqimeve dhe interpretimeve mitologjike dhe për ta vendosur arsyen (racion) në themel të gjykitimit të njeriut. Vetë fjala “iluminizëm” do të thotë *ndriçim* e, rrjedhimisht, iluministët mund të quhen ndryshe, në gjuhën shqipe, përndritës. Prej kësaj fjale buron edhe folja *iluminioj* në kuptimin *ndriçoj, ndërgjegjësoj për të vërtetën*.

Për Emanuel Kantin, në esenë “Çka është iluminizmi?” (1784), iluminizmi është liri e individit që ta përdorë inteligjencën e tij.

Ndërkaq, në kuptimin më të gjerë, iluminizmi është karakterizuar nga empirizmi, saktësia dhe rreptësia shkencore.

Kjo frymë, që në Europën Perëndimore i prodhoi revolucionet e mëdha, në Shqipërinë e atëhershme, më saktë në Shqipërinë gjeografike, sepse Shqipëria politike do të lindte shumë më vonë, e prodhoi lëvizjen kulturore e arsimore të njohur si Rilindja Kombëtare Shqiptare. Derisa në Europë iluminizmi më shumë ishte lëvizje mendimore, te shqiptarët – përmes Rilindjes Kombëtare – ajo u bë lëvizje që angazhohej për arsimin shqip, për kulturën shqiptare dhe për emancipimin e shqiptarëve për t’u bërë komb më vete. Janë të njohura përpjekjet e tyre për alfabetin shqip, për librin shqip e për shkollën shqipe. Duke jetuar në kushte të një shteti me organizim jokombëtar, siç ishte Perandoria Osmane, intelektualët shqiptarë e shndërruan në kauzë hapjen e shkollave shqipe dhe krijimin e librave në gjuhën shqipe. “Ëvetari” i Naum Veqilharxhit (1844–45), “Alfabetarja” e Sami Frashërit (1879), tekstet për fëmijë të Samiut, Naimit e të Mjedës, si dhe shumë botime të tjera për shkollën shqipe, ishin sythas për emancipimin e shqiptarëve për t’u bërë komb. Dhe, kjo përpjekje do të vazhdojë pareshtur, herë–herë edhe me pengesa, deri në themelimin e shtetit shqiptar më 1912, kur filloi të konsolidohet shkolla shqipe dhe arsimi shqip të marrë trajtë formale të organizimit shtetëror.

Megjithatë, derisa në Republikën e Shqipërisë arsimi shqip do të zhvillohet normalisht dhe kah mesi i shekullit të kaluar do të prodhojë intelektualë që do ta nderojnë emrin e kombit edhe përtej kufijve, shqiptarët në ish–Jugosllavi do ta përjetojnë iluminizmin ose Rilindjen e tyre Kombëtare shumë më vonë, vetëm pas Luftës së Dytë Botërore (pa i llogaritur këtu përpjekjet e shkurtra të shkollës shqipe gjatë viteve të luftës në “Tokat e lirume”), kur u

lejua arsini në gjuhën shqipe. Përkundër kufizimeve, Kosova – si njësi politike e ish-Jugosllavisë – do të bëjë hapa ta shpejtë në këtë drejtim, ndërsa te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut vetëm në shekullin XXI do të mund të flitet për konsolidim formal të arsimit shqip.

E bëme këtë përshkrim për të thënë se njësoj si iluministët europianë, Xhon Loku (John Locke), Tomas Hobsi (Thomas Hobbes) në Angli, Volteri (Voltaire) e Ruso (Rousseau) në Francë ose rilindësit iluministë shqiptarë, si vëllezërit Naim e Sami Frashëri, si Veqilharxhi e Kristoforidhi etj., iluministë ose rilindës shqiptarë në Maqedoni do të ishin ata arsimitarë dhe intelektualë që pas Luftës së Dytë Botërore do ta mbanin dhe ushqenin shkollën shqipe. Një ndër ta, natyrisht jo i vetmi, është edhe prof. Xhevat Gega.

Si një intelektual që u shkollua në kryeqendrën jugosllave të asaj kohe, në Beograd, ai e kishte kuptuar fare mirë se kombi mund të bëhet vetëm nëse konsolidohet arsini, pra nëse krijohen breza të arsimuar. Duke e ditur saktë fuqinë e atij shteti, ai nuk kishte iluzione se përmes përplasjes me atë aparat shtetëror mund të arrihej suksesi i shqiptarëve në Maqedoni. Prandaj, ai gjatë gjithë jetës së tij zgjodhi që me përkushtim gati asketik t'i shërbejë iluminimit të popullit të tij pa patetizëm patriotik dhe pa bajraktarizëm folklorik. Ai ia bëri për detyrë vetes që të jetë iluministi i popullit të tij dhe i tillë mbeti gjithë jetën. Pa pretendime të mëdha, ai ishte i bindur se shkalla e parë e kombformimit është arsini dhe prandaj gjithë angazhimi i tij jetësor mbeti shkolla shqipe. Fillimi dhe fundi i karrierës së tij aktive ishte arsini shqip. Atë e gjejmë gjithkund ku flitet për gjuhën shqipe, për arsimin shqip dhe për kulturën kombëtare. Zaten, edhe teoritë moderne të nacionalizmit sot e kanë

konfirmuar se kombi krijohet vetëm duke e kaluar shkallën e parë të arsimit, të pjekurisë për një identitet të përbashkët politik.

Pedagogu dhe intelektual Xhevat Gega

Karriera e tij profesionale është e përqendruar në punën e tij në shkollë, veçanërisht në arsimin e lartë shqip, që në vitet e Jugosllavisë socialiste ishte një përpjekje e veçantë. Ishin të paktë, sa mund të numëroheshin në gishta, intelektualët shqiptarë të asaj kohe që mund të mbanin mësim në Akademinë Pedagogjike të Shkupit ose në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Shkup. Ndër ta ishte edhe prof. Xhevat Gega, pa të cilin jo vetëm që do të ishte vështirë të mbaheshin në këmbë ato institucione, por sigurisht edhe më vështirë do të ishte të prodhoheshin kuadro të mira, siç ka ditur të prodhojë ai.

Përkundër asaj se ishin të paktë në numër dhe ishin në fillimet e arsimit të lartë shqip, gjenerata e prof. Xhevatit dhe vetë ai, sigurisht edhe duke pasur arsimim të fuqishëm me standarde të larta, do të dëshmojnë kapacitet të veçantë të mësimdhënies, kjo jo vetëm në kuptim të aftësisë oratorike të ligjërimit, por edhe të thellësisë së njohjes dhe interpretimit të lëndës. Ligjëratat e tij për letërsinë shqiptare, teorinë e letërsisë e për metodikën e mësimdhënies së gjuhës e letërsisë ishin leksione prej të cilave – edhe si shënime – mund të bëheshin kumtesa shkencore.

Në të vërtetë, fuqinë e tij studimore ai e ka dëshmuar edhe përmes dhjetëra studimeve e veprave të botuara dhe për kohën e tij është dëshmuar si studiues i thelluar i letërsisë artistike dhe i letërsisë gojore shqiptare. Ai është autor i më shumë se 100 punimeve shkencore, pjesëmarrës në mbi 30 konferenca e simpoziume shkencore, si dhe përkthyes i 20 librave nga maqedonishtja e

serbokroatishtja në gjuhën shqipe. Falë punës së tij, edhe shumë autorë shqiptarë të Maqedonisë u bënë të njohur për mbarë studimet letrare shqiptare (disertacioni i tij i doktoratës është pikërisht në këtë temë – “Letërsia e nacionalitetit shqiptar në Republikën e Maqedonisë 1945–1985”)

Si ndër albanologët e paktë të Maqedonisë, atë e gjejmë edhe në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), ku përveç kontributit shkencor, ai ka dëshmuar se ka ditur të rreshtohet në anën e drejtë të historisë. Duke iu bashkuar këtyre dy ngjarjeve historike të kombformimit, prof. Xhevat Gega e ka kuptuar rëndësinë që ka pasur dhe ka gjuha standarde si indi lidhor i kombit shqiptar të ndarë në disa shtete dhe në disa fe.

Madje, edhe në kohën e pluralizmit ai mbeti intelektual. Në fillim të viteve të '90–ta atë e gjejmë në krye të Unionit të Inteligjencies Shqiptare në Maqedoni, ku ai ka dhënë një kontribut të vyeshëm intelektual për emancipimin e kauzës shqiptare në rrethanat e reja që u krijuan pas rënies së komunizmit. Kështu, ai gjithë jetën mbeti intelektual.

Xhevat Gega si autor i Abetares

Ndonëse secili kontribut pedagogjik dhe shkencor i prof. Xhevatit mbetet i pakontestueshëm, pa dyshim se emri i tij do të mbetet i skalitur në historinë kombëtare të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përmes *Abetares*. Siç e dimë, deri në vitin 1970–të në shkollën fillore shqipe të Maqedonisë së Veriut ishin përdorur disa abetare (A. Dogani, M. Gjevori, J. Shushka), ndërsa viti 1970 e shënnon kohën kur shqiptarët e Maqedonisë e kishin arritur pjekurinë e mjaftueshme për të prodhuar abetare me fuqinë e tyre

intelektuale. Dhe, autor i saj do të jetë pikërisht prof. Xhevati. Kjo abetare do të vazhdojë të përdoret nga shkolla shqipe në Maqedoni edhe në ditët tona, duke përjetuar dhjetëra ribotime. Nuk ka nxënës shqiptar i lindur në vitet e '70-ta e këndej të shekullit të kaluar që nuk ka mësuar nga kjo abetare.

Duke mos ndjerë kompetencë të mjaftueshme për të bërë kritikë ose vlerësim të aspekteve pedagogjike e shkencore të kësaj abetare, për neve është i mjaftueshëm fakti se kjo është abetarja me të cilën secili shqiptar do ta mësojë shkrim–leximin dhe kështu do ta fillojë jetën e tij si lexues.

Për hir të së vërtetës, Abetarja nuk është teksti i vetëm i prof. Xhevatit. Emrin e tij e gjejmë edhe në shumë tekste të tjera të shkollës fillore dhe të mesme, qoftë si autor, si përkthyes, si redaktor ose si recensent, por sigurisht që identiteti i tij i parë mbetet Abetarja. Kështu ai e ka përmbushur misionin e tij iluminist dhe intelektual, duke e ndërtuar rolin e tij përndritës për popullin e tij dhe duke ndihmuar që ky popull të marrë rrugën e emancipimit për t'u shndërruar në komb. Shprehur figurativisht dhe në kontekst të temës sonë, prof. Xhevat Gega – përmes kësaj pune – është kthyer në një “Sami Frashër” për shqiptarët e Maqedonisë.

SEVDAIL DEMIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

XHEVAT GEGA, NJË GAZETAR I GUXIMSHËM DHE MJESHTËR I FJALËS SË SHKRUAR

Përtej faktit se gazetaria është një profesion atraktiv veçanërisht për moshat e reja, ajo shpeshherë përbën çelësin e suksesit të profesionistëve të ardhshëm të profileve tjera. Pra, në njëfarë forme, për shumëkënd gazetaria shërben si trampolinë për të kërcyer në shtigje të reja më të thella. Kështu, shumë emra të famshëm, të mëvonshëm, të fushës së shkencës, kulturës, arsimit, etj., njëherë kanë kaluar përmes profesionit të gazetarit, për t'u bërë të njohur për publikun përmes pendës së tyre, e që më pas të kultivohen edhe si shkrimtarë, studiues, diplomatë, menaxherë apo ligjërues universitar.

Në rastin e Xhevat Gegës e kemi një personalitet që jo tërësisht e ndjek një trajektore të lartpërmendur profesionale, por që megjithatë, në masë të madhe do të lë gjurmë të pashlyeshme në historinë e gazetarisë shqiptare në Maqedoni dhe më gjerë.

Si pikë orientimi për të vrojtuar angazhimin e tij gazetaresk dhe publicistik, jemi shërbyer me gazetën e vetme më të madhe shqipe në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore “Flaka e vëllazërimit”, si dhe derivatet e saj mediatike të kohës – revistat “Jehona”, “Fatosi” e “Gëzimi”.

Në të vërtetë, emrin e gazetarit të talentuar Xhevat Gega e hasim që në vitet e '60-ta të shekullit të kaluar, me tekste kryesisht të natyrës kulturore, pedagogjike e arsimore. Madje, në vitin 1960 e lexojmë edhe një poezi të tij ("Magjypja") në rubrikën e re që i bashkëngjitet faqeve të gazetës "Flaka", që titullohej "Panorama poetike"³⁹. Aty përpos Gegës, me krijimet e tyre letrare paraqiten emra të rinj dhe të njohur të letërsisë shqipe, si: Halit Basha, Abdulaziz Islami, Jakup Ceraja, Ali Podrimja, etj.

Por emri i Xhevat Gegës si gazetar afirmativ e i guximshëm, dhe me një formim të lartë jo vetëm se kulturor, por edhe kombëtar, do të na e tërheq më tepër vëmendjen gjatë vitit të vrullshëm 1968. Meqë ky vit përkonte me 500-vjetorin e vdekjes së heroit kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, shumë faqe të kësaj gazete ishin të mbushura me tema rreth këtij personazhi të madh historik. U mbajtën disa manifestime kulturore e konferenca shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe trojet tjera shqiptare, të cilat lidheshin me emrin e Skënderbeut. Kështu, p.sh., më 16.5.1968, në ballinën e gazetës lexojmë tekstin në jubileun e 500-vjetorit të vdekjes së trimit legjendar: "Simpozium kushtuar Skënderbeut – kontribut për ndriçimin e një epoke", shkruar nga Xhevat Gega dhe Ali Aliu, ku bëhet fjalë për mbajtjen e simpoziumit shkencor në Prishtinë, me pjesëmarrjen e një numri të madh të studiuesve nga vendi dhe jashtë, të cilët e kanë nxjerrë në pah figurën historike të Skënderbeut. Edhe shtojca në format të vogël e kësaj date, i kushtohet përgjithësisht këtij simpoziumi shkencor. Është me interes të veçantë edhe një intervistë me studiuesin gjerman nga

³⁹ Gezeta "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 12.6.1960. Mbase do të ishte me interes për letërsinë shqipe që të tubohen të gjitha krijimet letrare të Xhevat Gegës në një botim të veçantë, apo ndonjë specialist i fushës të bëjë vlerësime profesionale edhe për poezinë e tij.

Universiteti i Vjenës, prof.dr. Karl Trajmer, pjesëmarrës në këtë simpozium, i cili që nga titulli i intervistës na e jep edhe mesazhin kryesor: “Ilirët në parahistori – kulmi i kulturës evropiane”. Autor i tekstit – intervistës është sërisht Xhevat Gega, kurse tema është nxitur nga historia e hershme e këtyre trojeve, e cila i kishte paraprirë periudhës së Skënderbeut.⁴⁰



Gazeta “Flaka e vëllazërimit”, një kujdes të veçantë i kushtonte kultivimit të gjuhës letrare shqipe, e cila ende nuk i kishte marrë konturat e duhura të drejtshkrimit. Kështu, duke përdorur moton kryesore të Konsultës gjuhësore të Prishtinës, të mbajtur më 22–23 prill të vitit 1968, gazetari dhe gjuhëtar Xhevat Gega, shkruan artikullin me titullin shumë të guximshëm: “Për një komb – një gjuhë letrare – një drejtshkrim”⁴¹. Siç dihet, kjo konsultë e organizuar nga Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhësisë e

⁴⁰ Sevdail Demiri, *Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991) - aspekti kulturor-arsimor*, ITShKSh, Shkup, 2015, fq.116

⁴¹ Gezeta “Flaka e vëllazërimit”, Shkup, 1.5.1968.

Universitetit të Prishtinës, ku kishin marrë pjesë studiues të njohur të gjuhësisë, i kishte paraprirë Konferencës së Drejtshkrimit të mbajtur në Tiranë më 1972. Në këtë konsultë, ishin dhënë bazat e formimit të një drejtshkrimit të unifikuar, i cili do të përdorej në të gjitha trojet shqiptare dhe nga të gjithë shqiptarët kudo që gjendeshin. Në artikullin e lartpërmendur, autori Xhevat Gega, ndër të tjera shkruan: “Tradita jonë letrare bukur e pasur, dhe për nga koha mjaft e lashtë, flet qartë për përpjekjet e gjithë atyre që me pendë, e shpesh edhe me pushkë, janë përpjekur për sendërtimin e idealit më të lartë, për fitimin e lirisë, e cila do të mundësonte të ndërtohet e të zhvillohet në baza të shëndosha ajo që do të ishte ushqim i domosdoshëm shpirtëror, e që ne e quajmë kulturë kombëtare”.

Gjatë po atij viti, gazeta “Flaka e vëllazërimit” mjaft do ta aktualizojë edhe çështjen e hapjes së Katedrës së Albanologjisë në kuadër të Universitetit të Shkupit, për çka do t’i botojë disa artikuj edhe atë në ballinat e shtojcës për arsim e kulturë. Më 12.9.1968, botohet artikulli “Katedër e Albanologjisë në Shkup”, ku mendimet e tyre rreth nevojës së hapjes së kësaj katedre, i shprehin disa profesorë universitarë dhe punëtorë kulturorë, si Petro Janura, Xhevat Gega, Islam Karanfili, Fejzi Bojku, etj., të cilët shprehen se nevojat për një gjë të tillë janë të mëdha, si dhe kushtet janë shumë më të pjekura se në vitin 1922, kur prof.Bariqi kishte hapur Seminarin e Albanologjisë në Universitetin e Beogradit⁴². Në opinionin e shprehur nga prof.Gega, hapja e katedrës albanologjike në Shkup, përveç nevojës për përgatitjen e kuadrove të reja, do të jetë edhe një shteg i ri i për lëvrimin shkencor dhe zhvillimin e gjuhës sonë.

⁴² Sevdail Demiri, *Shtypi shqiptar në Maqedoni...*, fq. 119.

Në vitin 1971, do të vërejmë që kolegjiumit të redaksisë revistës për fëmijë “Fatosi” – i prirë nga Mehmedali Hoxha, i bashkëngjiten edhe redaktorët Xhevat Gega e Ali Huruglica. Si rezultat i hapjes së vazhdueshme të revistës për bashkëpunëtorët e rinj, gjithnjë e më tepër kemi prezantimin e punimeve të ndryshme nga nxënësit e gjithë vendit, të cilët kryesisht prezantoheshin me vjersha.

Duke u dëshmuar si një punëtor i zellshëm shoqëror, pedagog universitare dhe veçanërisht duke pasur parasysh përvojën e tij shembullore si gazetar, në periudhën e viteve 1974–1978, Xhevat Gegës i besohet posti i lartë i kryeredaktorit të gazetës “Flaka e vëllazërimit”, të cilën do ta udhëheqë me shumë sukses. Si rezultat i punës së tij vetëmohuese, si dhe kreativitetit gazetaresk që e posedonte, në vitin 1975, në kuadër të gazetës, Gega themeloi tri shtojca të reja javore të cilat u adresoheshin kategorive të veçanta të lexuesve. Kështu filloi botimi i shtojcës profesionale për çështje teorike e praktike të arsimit – “Pedagogu”, si dhe i shtojcave “Valët” e “Shkollari”, që në të vërtetë reflektonin pasionin e veçantë të prof. Gegës për profesionin e shenjtë të pedagogut dhe arsimdashësit të pashoq.

Gjatë kohës sa ishte në krye të kësaj gazete Xhevat Gega si kryeredaktor, ajo u konsolidua njaftueshëm, zgjeroi rrjetin e gazetarëve dhe korrespondentëve dhe u ngrit në cilësi, duke rritur edhe shifrat e tirazhit të saj.

Një kontribut të çmuar në sferën e gazetarisë e publicistikës shqiptare, Xhevat Gega e dha edhe në revistën e parë dhe të vetme për kulturë, për art dhe për shkencë në gjuhën shqipe në Maqedoni “Jehona”, e cila kishte nisur botimin e saj që nga viti 1962. Xhevat Gega ishte kryeredaktor i revistës “Jehona” në periudhën e viteve 1976 – 1978.



„Lufte per kualitet

Xhevat Gega, kryredaktor e redaktor përgjegjës i »Flakës së vëllazërimit«

Në gazetari gjithmonë do të vlejë deviza: »Çdo informatë e vonuar që në fillim ka dështuar«. Nëse e respektojmë këtë, atëherë angazhimi i mjeteve të informimit në drejtim të të qenit aktual dhe vetëm aktual duhet të jetë preokupimi numër një. Mendoj se edhe në të Redaksisë »Flaka e vëllazërimit« këtë devizë po orvatemi ta respektojmë, kuptohet brenda mundësive tona objektive. Kjo më së miri shihet sidomos në kohët e fundit kur gazeta jonë bëri ndryshime të qenësishme jo vetëm në pikëpamje të noviteteve në kuadrin e rubrikave ekzistuese e shumë të reja që u çelën, por edhe me shitojat »Pegagogu«, »Valët« e »Shkollari«. Këtë e vërtetojnë letrat e shumta të lexuesve tanë të respektuar, këtë e vërteton edhe rritja permanente e tirazhit të shitur të vetë gazetës. Është e udhës që me këtë rast të përmendim kualitetin dhe tirazhin shumë të madh edhe të botimeve tjera të Organizatës sonë: »Gëzimis«, »Fatosi« dhe »Jehona«.

Tani, kur gjendemi në fillim të vitit të ri kalendaresk, OBPB — »Flaka e vëllazërimit« është e do të jetë e preokupuar që njeriu ynë punues, si prodhues e vetëqeverisës, me të gjitha preokupimet e tija, që shoqëria jonë socialiste me të gjitha poret e jetës së vet, që sistemi ynë i trasuar gjatë disa dekenieve e prej vitit në vit vazhdimisht i perfeksionuar në të mirë të njerëzve tanë të bashkuar e të vëllazëruar, të trajtohen në mënyrë sa më të ofrueshme, sa më adekuate vetëm e vetëm që gazeta »Flaka« të jetë tribunë e vërtetë e të gjithëve.

34 FLAKA E VELLAZERIMIT — 30 DHJETOR — 1975

Shfletojmë disa nga numrat e kësaj reviste serioze shkencore të vitit 1976, dhe ndryshimet në strukturën e revistës janë të dukshme. Shtohet volumni i studimeve mbi gjuhësinë, letërsinë, folklorin, etj., ndërsa poezia është më pak e pranishme se sa paraprakisht.

Tekstet e Xhevat Gegës të botuara qoftë në gazetë apo revista, dallohen jo vetëm se për nga forma e përmbajtja, por edhe nga stili i

veçantë i të shkruarit dhe mesazhi që jepte që në titujt e artikujve. Ai ishte një mjeshtër i vërtetë i fjalës së shkruar. Secila fjalë dhe shprehje e kishte vendin e vetë dhe kuptimin e caktuar. Përshkrimi i temave rëndomë ishte i lirë dhe shumë qartë i kuptueshëm për një gamë më të gjerë të lexuesve. Brenda tekstit të tij asnjë fjalë nuk përsëritej, ndërsa fjalitë kishin rrjedhim logjik, që sqaronin mjaftueshëm problematikën që shtjellohej. Fjalori i Gegës ishte mjaft i pasur me shprehje dhe terme të qëndrueshme profesionale, të cilat e ngjatin nivelin e tij shkrimor dhe jepnin përshtypje të një njohësi të avancuar të problematikave konkrete.

Një tjetër karakteristikë dalluese e tij është guximi për t'ju qasur temave të thella historike, siç ishin ato për origjinën ilire të shqiptarëve, për Skënderbeun apo edhe për kulturën gjuhësore të shqiptarëve. Në vitin e largët 1968, nuk ka qenë e lehtë në ish-Jugosllavi të shkruhen tituj sikurse atë që e përmendëm më herët (“Për një komb – një gjuhë letrare – një drejtshkrim”), që në mënyrë të drejtpërdrejt afirmonte kombin shqiptar dhe bashkimin e tij rreth një gjuhe, sikurse shumë vite më herët bënë thirrje rilindësit.

Të gjitha këto cilësi, Xhevat Gegën e dallojnë si një gazetar dhe publicist i kompletuar, profesionist i guximshëm, mjeshtër i fjalës së shkruar shqipe, dhe një shembull i shkëlqyer që duhet ndjekur gjeneratat e reja.



HIDAJETE AZIZI & LAURA PAPRANIKU BEJTULLAU

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

ABETARJA E PROFESOR XHEVAT GEGËS VAZHDIMËSI E ABETAREVE SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT

Zgjerimi i të drejtave kolektive të shqiptarëve dhe i të drejtës për shkollim në gjuhën amtare në kuadër të ish-RSFJ-së, mundësuan krijimin e kuadrove profesioniste dhe cilësore, të cilët do të mbanin mbi supe proceset për zhvillimin dhe përparimin arsimor e kulturor të popullatës shqiptare në Maqedoni. Profesor Xhevat Gega (1934 – 2017) do të bëhet njëra ndër figurat më në zë të këtij kuadri që ka lënë gjurmë si pedagog, studiues, përkthyes, hartues tekstesh shkollore e gazetar. Në çdo lëmi ku ai u angazhua, la pas shëmbëlltyrën e profesionistit të mirëfilltë, sidomos me hartimin e teksteve shkollore të gjuhës e letërsisë shqipe. Spikati me tekstet e abetareve të cilat i transformoi në aspektin metodik e didaktik, i avancoi në asketin pedagogjik e estetik dhe i lartësoi në aspektin gjuhësor. Me këto libra profesor Gega bëri epokën, e cila e ngjiti në majat më të larta të historisë së hartimit të abetareve shqipe jo vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe në gjerë, sepse tekstet e librave të tij janë të denja për t'u krahasuar me ato të bashkëkohësve të tij – me abetaret e Kolë Xhumarit në Shqipëri, Qamil Batallit në Kosovë apo Gjokë Gjokajt dhe Fran Camajt në Mal të Zi.

Me Abetaret e profesor Gegës mësuan breza të tërë nxënësish në shkollat e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ato u bënë

bazamenti mbi të cilin u ndërtua ura që lidhi traditën e deriatëhershme me atë të abetareve të tjera që do të pasojnë. E tradita e botimit dhe e përdorimit të abetareve në gjuhën shqipe na kthen mbrapa në shek. XIX, tek abetaret e para të rilindësve (*Ëvetari* i Naum Veqilhargjit – 1844, *Abetari* i Konstatin Kristoforidhit – 1866, *Abetarja e Stambollit* – 1879 apo *Abetarja* e Sami Frashërit – 1886). Për përdorimin e tyre në trojet shqiptare që sot i takojnë Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mungesë të shkollave shqipe, studimet e deritanishme nuk na ofrojnë fakte të qëndrueshme. Megjithatë, nuk është aspak e tepërt të thuhet se që në fillim të shekullit XX, në këto troje u krijua një traditë e mirë në fushën e hartimit e të botimit të abetareve të gjuhës shqipe. Kujtojmë këtu vitin 1900 kur në Shtypshkronjën “Mbrothëria” të Sofjes u botuan tri vepra të dibranit Sait Najdenit (Hoxhë Vokës) në mesin e të cilave edhe “*Abetare e gjuhës shqip. Ndë të folë gegënish*”⁴³. Nëntë vjet më vonë (1909) u botua në Manastir nga Shoqëria “Bashkini i Kombit” “*Abetare për shkollat e para shqipe*” e Mësueses së Popullit, Parashqevi Qiriazit. E vitit 1911 është “*Abeceja shqype*” e Jashar Erebarës, të cilën e shtypi dhe e shpërndau gazeta e parë shqipe në trevat e Kosovës e të Maqedonisë “Shkupi”. Kjo abetare u zbulua nga studiuesi Sherif Osmani dhe u mbiquajt nga ai si *Abetarja e Kumanovës*, pasi ishte e destinuar për nevojat e një qendre shkollore që kishte hapur në atë kohë një klub shqiptar i Kumanovës⁴⁴ në krye me Jashar Erebarën. Të gjitha abetaret e deritanishme, për shkak të rrethanave të njohura historike në të cilat cenohej e drejta për mësim në gjuhën shqipe, janë përdorur fshehurazi.

⁴³ Kujtim Bevapi, Mendimi pedagogjik mbi abetaret shqipe, SHB Onufri, Tiranë, 1996, fq.80

⁴⁴ Po aty, fq. 91.

Sa i takon hapjes së shkollave shqipe, e me këtë edhe përdorimit të librave shqip, gjërat filluan të ndryshojnë pak pas Luftës së Parë Botërore⁴⁵ e në veçanti gjatë Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur në kuadër të Tokave të lirueme (1941–1944) do të përfshihen Kosova dhe pjesa perëndimore e Maqedonisë së sotme dhe kur do të hapen edhe shkollat e para në të cilat zyrtarisht u përdorën abetaret e përpiluara në Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër e gjetiu. Sakaq, me përfundim e LDB-së, kur Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës mbetën në kuadër të RSFJ-së, sistemi dhe rrethanat e reja politike hapën një faqe krejt të re të zhvillimit të shkollave dhe përdorimit të teksteve shkollore. Tekstet e para të abetareve për nevojat e shkollave shqipe në ish-RSFJ janë “Këndimi im i parë” (1945)⁴⁶, “Abetare për të rritun” (grup autorësh: M. Gjevori, I. Riza, R. Shpendi, Prizren, 1946) dhe “Abetare për klasën e parë të shkollave fillore” (grup autorësh: M. Gjevori, S. Kostari, J. Gjino, Beograd, 1947). Sipas prof. Avzi Mustafës, në dy vitet e para të pasluftës, është përdorur edhe një abetare e botuar në Firencë në vitin 1942, e cila kishte shërbyer deri në vitin 1944 për nevojat e shkollave shqipe, të cilat ishin hapur dhe zgjeruar gjatë LDB-së. (Po sipas tij, Abetarja është pa autor ndërsa në faqen e parë të saj ka fotografinë e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit–Skënderbeut. Megjithatë, edhe shqiptarët e Maqedonisë

⁴⁵ Në vitin 1917 arbëreshi Marko la Piana boton në Vlorë *Abetar shqyp*; më 1928 drejtori i arsimit të qarkut të Korçës, Viskë Pula, boton *Abetare për shkollat fillore*; më 1919 Thoma Papano boton në Vlorë abetaren *Shkëndijat e para*; po të njëjtin vit botohet në Elbasan *Abetare e re për shkolla fillore t'ulta djemsh e vajzash*; më 1920 në Vlorë botohet *Abetar nga Mati Logoreci*; 1927 në Tiranë botohet *Abetare për shkollat fillore të Shqipërisë*; 1931 – *Abetare* e A. Xhuvanit. Gjatë viteve 1925–1939 janë botuar edhe abetare të autorëve L. Gurakuqi, J. Minga e të tjerë. Shih për më tepër: “Mendimi pedagogjik mbi abetaret shqip” nga Kujtim Bevapi.

⁴⁶ Autorësia e këtij tekstit mbetet jo e sigurt. Shih më tepër: Revista Pedagogjike, nr. 4, 1999, Tiranë, f. 132.

nuk u vonuan në këtë proces. Po të njëjtin vit kur u botua “Abetarja për të rritun” në Kosovë (1946), edhe në Shkup, në shtypshkronjën “Kultura”, u botua abetarja me autor Abdylaqim H. Dogani “Abetare – punuem nga Abdylhaqim H. Dogani, mësues në Gostivar, 1946”, në bashkëautorësi me Kamber Xherinë dhe Mahmut Dumanin. Këtë abetare me 75 faqe studiuesit e konsiderojnë si abetare të parë zyrtare për shkollat e ish–Republikës Socialiste të Maqedonisë. Këtë periudhë, u përgatitën edhe tekste të tjera të abetareve nga autorë shqiptarë të ish–RSM–së. Në vitin 1947 kemi Abetaren e Mehmetali Hoxhës, e cila u botua në Prishtinë, ndërsa në vitin 1949 u përgatit Abetarja e autorëve Abdi Haxhiu, Sami Lamçe dhe Zydi Karanjaku por që nuk u botua fare. Ndonëse abetarja e A. H. Doganit ka një vlerë historike, meqë është e para e botuar pas LDB–së për nxënësit shqiptarë të ish RSM–së, ajo nuk arriti të krijojë një traditë përdorimi.

Një epokë e re në hartimin dhe botimin e abetares nis nga viti 1970 me daljen në skenë të abetareve të prof. Xhevat Gegës. Në shtëpinë botuese “Prosvetno dello” në Shkup do të botohet abetarja e parë e profesor Gegës me titull “Abetare, zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit dhe të dorës” me 120 faqe. Nëntë vjet më vonë, më 1979 do të botohet në shtëpinë botuese “Prosvetno dello” abetarja e dytë me titull “Abetare, zhvillim veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës” me 110 faqe. Janë këto abetaret e para që krijuan një traditë të gjatë të përdorimit të shqiptarët e Maqedonisë dhe të cilat ndër vite patën shumë ribotime. Vetë ky fakt flet për rëndësinë, vlerën e peshën që kanë abetaret e profesor Xhevat Gegës për shqiptarët e Maqedonisë në këtë periudhë. Ndonëse që nga botimi i abetareve të profesor Gegës e këndej do të vazhdojë tradita e përdorimit të abetareve të botuara edhe nga autorë shqiptarë të trojeve të tjera,

emri i profesor Xhevat Gegës për një hark kohor mbi njëzet vjet, do të bëhet sinonim i abetares për shqiptarët e këtyre trojeve. Më vonë do të botohet edhe abetarja e Avzi Mustafës, në bashkëautorësi me Feriz Mjakun, “Abetare”, Shkup, 2006, Logos–A e cila po ashtu do të përdoret në shkollat shqipe këtu te ne.

Profesor Gega i takon brezit të intelektualëve, i cili, megjithëse në një kohë mjaft të vështirë për shqiptarët, ia doli të bartë mbi supet proceset për zhvillimin dhe përparimin arsimor e kulturor të popullatës shqiptare në Maqedoni. Atë gjejmë si autor dhe bashkautor të një numri të konsiderueshëm tekstesh shkollorë (abetare dhe tekste mësimore nga fusha e gramatikës e letërsisë për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni)⁴⁷. Në këtë punim do të fokusohemi në tekstin “Abetare, zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës”. Për herë të parë kjo abetare u botua në vitin 1979 dhe pati gjithsej dymbëdhjetë ribotime. Ne kemi shkoqitur botimin X të shtëpisë botuese “Prosvetno dello”, Shkup, 2000. Kjo abetare ka gjithsej $103 + 2$ faqe dhe është e ndarë në katër pjesë.

Një rëndësi e posaçme i kushtohet anës përgatitore apo paraabetares, sikurse quhet shpeshherë pjesa e librit para fillimit të mësimit të shkrimit dhe leximit të shkronjave, si dhe anës përvetësuese apo pjesës së përsëritjes së shkronjave të mësuara në kuadër të teksteve më të zgjeruara.

⁴⁷ Avzi Mustafa, *40 vjet veprimtari arsimor dhe shkencor të prof. Xhevat Gegës*, Shqyrtime Albanologjike 3, 1997, f. 7-15.



Në pjesën përgatitore (faqet 3 – 23) ofrohen tema të afërta dhe të konceptueshme për botën e fëmijëve, por çdo herë me tendencën për të avancuar aftësitë e tyre krijuese (përmes tregimit dhe shpjegimit të fotografive) dhe për të ngulitur tek ta shprehi dhe sjellje të karakterit edukativ–arsimor. Kështu, krahas temave të tipit *Familja ime* (f. 6); *Dita e parë në shkollë* (f. 9); *Tregu i perimeve* (f. 13); *Kafshë dhe shpezë shtëpiake* (f. 14); *Kafshë dhe shpezë të egra* (f. 15); *Në kopshtin zoologjik* (f. 18); *Në lluna–park* (f. 20) dhe *Në*

Plazh (f. 21) vijnë të gërshetuara me njëra-tjetrën tema, si: *Ne jemi gëzimi i botës* (f. 4–5); *Gjinnastika e mëngjesit* (f. 7); *Unë shkoj në shkollë* (f. 8); *Klasa jonë* (f. 10); *Një rrugë qyteti* (f. 11); *Vjelja e pemëve* (f. 12); *Bujqësia – Blegtoria* (f. 16); *Zejet dhe zejtarët* (f. 17); *Dy shokë*; *Mjete qarkullimi* (f. 22) dhe *Postieri* (f. 23). Vendosja e temave me qëllim të mësimin të koncepteve të reja, bëhet natyrshëm dhe gradualisht, sipas shkallës së vështirësisë, nga e thjeshta tek e vështira, në raport të drejtë me aftësitë psikologjike të moshës së fëmijëve.

Në pjesën përvetësuese (faqet 55 – 63) me qëllim që nxënësit të përforcojnë mirë dijet që kanë fituar nga mësimi i shkronjave (në pjesën paraprake) autori ndërthur mësimet përkatëse me vjersha (*Margaritarët e gjuhës* – f. 56; *Republikës* – f. 59; *Viti i Ri* – f. 61); me tregime (*Treni* – f. 57; *Liria është e shtrenjtë* – f. 58; *Askush s'ka shokë sa unë* – f. 60); me tregime me piktografi (*Si udhëton letra* – f. 62) dhe me *Tregim pa falë* (*Dashi mendjelehtë* – f. 63). Ana përvetësuese e shkronjave nuk vjen në fund të librit, por në mes, si pjesë e ndërmjetme mes shkronjave të shtypit dhe të dorës. Kjo e bën prof. Gegën të dallojë prej autorëve të tjerë dhe të mos bëhet peng i klisheve dhe modeleve të abetareve që janë shkruar para tij.

Përmes mësimin të shkronjave veçmas të shtypit (faqet 24 – 55) dhe veçmas të dorës (faqet 66 – 103), prof. Gega shënon një hap para dhe largohet nga metoda e deritanishme e mësimin të shkronjave përmes rrokjezimit, avancon në nivele të larta përdorimin e metodës sintetike analitike në përpilimin e teksteve të Abetares. Radhitja e mësiminve (shkronjave të shtypit) është në funksion të krijimit të fjalëve dhe jo të ndonjë ndarjeje klishe në fillim zanore pastaj bashkëtingëllore, apo sipas renditjes alfabetike. Prandaj, pas

shkronjës A, vjen shkronja M, pas tyre shkronjat I, U, apo pas shkronjës N kemi shkronjën E, e kështu me radhë. Kësisoj ndodh përzierja, pas një zanore dhe një bashkëtingëllore (A – M), vijnë dy zanore, një bashkëtingëllore (I, U – N) pastaj një zanore, dy bashkëtingëllore (E – L, R), një zanore një bashkëtingëllore (Ë – K), një zanore shtatë bashkëtingëllore (O – T, P, D, B, J, S, H), një zanore 17 bashkëtingëllore (Y – F, V, C, Ç, G, Ll, Q, Sh, Rr, Nj, Gj, Th, Dh, X, Xh, Z, Zh).

Për një libër të parë mësimi, është shumë e rëndësishme që nxënësit të mësojnë se jo çdo herë pas A-së vjen M-ja. Pra, për t'i mbajtur larg grackës së mësimiit përmendësh, tek pjesa e mësimiit të shkronjave të dorës kemi një renditje krejt të ndryshme të shkronjave, krahasuar me renditjen e shkronjave të shtypit: pas A-së vjen I-ja, pas N-së vjen M-ja, pas E-së vjen Ë-ja, pas L-së Ll-ja e kështu me radhë. Mësimi në këtë pjesë nuk është në funksion të ndërtimit të fjalëve (sepse tekstet janë kryesisht me shkronja të shtypit edhe pse mësohen shkronjat e dorës) por të kaligrafisë. Në 36 mësimet e kësaj pjesë, me shkronja të dorës shoqërohen tekstet për mësimin e tetë shkronjave të dorës, si K – f. 74, O – f. 75, P – f. 76, J – f. 84, Q – f. 85, F – f. 88, V – f. 90, Y – f. 92. Për secilën shkronjë të dorës, autori jep detyra shkrimi ku nxënësve u kërkohet të përshkruajnë fjalitë me shkronja përkatëse, si dhe t'u përgjigjen pyetjeve që dalin nga kuptimi i mësimiit. Në dy raste, si postulate të teksteve, gjejmë thënie që lartësojnë moralin e punës, si: “*Punë, punë natë e ditë që të shohim pak dritë!*” – ka thënë Naim Frashëri (f. 76); *Puna e nderon njeriun!* (f. 76). Mësimi i 36 shkronjave të dorës përmbyllet me *Urimet e Zhoze finës – për Vitin e Ri*, që, në fakt, është një formë e ngjashme me traditën e disa autorëve të abetareve të mëparshme (që përmbyllin mësimin e

shkronjave me Letra që u dërgohen shokëve apo prindërve). Në të gjitha rastet, qëllimi është i përbashkët: t'i mësojnë nxënësit si të shkruajnë letra/urime. Profesor Gega mësimet e kësaj natyre i ka shtuar edhe atë të shkrimit të kumtesave (mësimi **V** e dorës f. 90). Abetarja mbyllet me 36 shkronjat e gjuhës shqipe të shoqëruara me figura që fillojnë me shkronjën korresponduese.

Me “Abetare – zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës”, profesor Gega jo vetëm që avancoi në nivele të lavdërueshme metodologjinë e përpilimit të këtyre teksteve shkollore (zbatoi kryesisht metodën analitike–sintetike, të përzier në disa raste me metoda të tjera të mëimit të shkronjave) por me përdorimin për herë të parë të piktografisë (figurës në vend të fjalës) tregoi aftësi të reja krijuese të cilat e ngritën në nivelin e një didakti të jashtëzakonshëm. Vlera tjetër shkencore e këtyre abetareve qëndron në përshtatjen e teksteve në bazën e kriterëve psikopedagogjike të moshës së nxënësve të klasës së parë. Ato janë njaft praktike në përdorim. Kanë një vijë harmonike të interpretimit dhe të shpjegimit të fjalëve që lidhen logjikisht me njëra–tjetrën. Janë të pasura me shprehje që nguliten vetvetiu gjatë nxënies së dijeve (*Ku ka pastërti nuk ka sëmundje, Libri është shoku më i mirë i jetës*), apo fraza dhe ndërtim fjalish që pasi t'i kesh mësuar në fëmijëri, nuk të shqiten nga mendja as në pleqëri (*Pata bën ga, ga, ga; Kërkon bibat ku i ka; ...Ga, ga, ga e mak, mak, mak; Gimi i vogël pse u lag?; Ringe, xhinge u–ja; ç’janë këto kuja; Dhelprën e zu dhëmbi; Ujku e shpoi gjembi e të ngjashme si këto*). Aspekte tjera të rëndësishme përbëjnë faktet se librave të tij nuk i mungojnë as vlerat estetike dhe as fryma e përcjelljes së mesazheve dhe lidhjeve me veçoritë kombëtare shqiptare.

Edhe pse abetaret u botuan dhe ribotuan në një kohë kur ishte i pashmangshëm politizimi i teksteve shkollore⁴⁸, Gega kishte kurajën të qëndrojë fort pas tabanit kombëtar të emërtimit të personazheve me të cilët përpiloi tekste mësimore. Po përmendim në këtë rast vetëm disa nga antroponimet e pastra e të bukura shqipe që mbizotërojnë në këtë libër, si *Luli, Luani, Zamiri, Zogëza, Zana, Besa, Emira, Mirake* e shumë e shumë të tjerë me të cilat profesori arrin ta përçojë mesazhin në drejtimin e duhur, pikërisht te brezat e rinj të cilët jo rrallë luajnë rolin e denominuesit në familje dhe jo rrallë bëhen edhe burim i ngritjes së nivelit të vetëdijesimit onomastik. Të kësaj natyre, megjithëse me etimologji të huaj, janë edhe emrat që trajtohen si tradicionalë shqiptarë, ata të nomenklaturës krishtere katolike dhe që kanë një peshë për zhvillimin historik të shqipes, si: *Gjini, Gjoni, Pali, Leka, Kola, Mrika* e të tjerë. Megjithatë, profesori është shumë i vetëdijshëm edhe për faktin që kjo botë e emrave vetjakë medoemos do të duhet të korrespondojë me botën reale në të cilën ndodhen këta vogëlushë. Me këtë fondi i emrave vetjakë vjen e shtohet edhe me mjaftë emra të nomenklaturës islame, si: *Emine, Ali, Sali, Omer* e të ngjashme, që janë aq të zakonshëm ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Nuk mungojnë edhe emrat ndërkombëtarë, si: *Zhozefina, Veronika, Ema, Ana* dhe në veçanti emrat hipokoristikë a përkëdhelës të sajuar me anë të shkurtimit të cilët janë të përshtatshëm për karakterin e abetareve dhe për botën fëmijërore, si: *Nina, Mimi, Cufi, Gimi, Leci, Xoxi* e të ngjashëm.

Madhështia e Abetares së profesor Xhevat Gegës qëndron në thellësinë e mendimit dhe lehtësinë e të kuptuarit të tekstit, çdo

⁴⁸ Në botimin X të vitit 2000, vendi i botimit të librit është shkruar sipas natyrës së gjuhës maqedonase. Në vend të trajtës shqipe *Shkup*, është përdorur trajta maqedonase *Skopje*.

herë në përputhje me aftësitë psikopedagogjike të moshës së nxënësve 6 –7 vjeçar. Duke njohur mirë këtë aspekt pedagogjik dhe duke qenë një mjeshtër i gjetjes së fjalëve në vendin dhe formën e duhur, Gega natyrshëm dhe pa asnjë sforcim u ngjit në nivelin e një didakti të mirëfilltë – një afinitet ky i cili do ta ndjekë gjatë gjithë përvojës së tij pedagogjike. Të gjitha këto tipare si dhe risitë që i sjell me një mjeshtëri të jashtëzakonshme e bëjnë prof. Gegën të dallojë nga autorët e tjerë dhe të mos jetë peng i klisheve dhe modeleve të abetareve që janë shkruar para tij. Këtë e dëshmon edhe fakti që mbështetur në numrin e madh të ribotimeve të të njëjtit tekst si dhe jetëgjatësisë së përdorimit për shumë dekada, abetaret e Xhevat Gegës u bënë librat më të pëlqyer të këtij lloji në shkollat e Maqedonisë së Veriut.

Profesor Xhevat Gega do të lë gjurmë edhe si një altruist i cili, ani pse vetë ishte autor abetaresh, përkrahi fuqishëm përdorimin e një abetareje mbarëkombëtare për të gjithë shqiptarët.

SHPRESA PURDE MEMEDI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

XHEVAT GEGA – KOLOS I ARSIMIT SHQIP***Abstrakt***

Detyra dhe suksesi më i madh i një intelektualit dhe ideologu është që popullit të vet t'ia tregojë rrugën e përparimit. E rruga e përparimit për një popull është gjithmonë dija, e cila si njohuri e përvetësuar në një fushë pasqyrohet në çdo segment të jetës. Punimet shkencore të dr. Xhevat Gegës mund të grupohen në tri fusha të ndara. Dëshiroj të theksoj se vëmendje të veçantë tërheqin punimet e natyrës komparative (krahasuese) të prof. Gegës respektivisht punimet ku vihen në pah pikat puthitëse të letërsisë shqiptare dhe të asaj maqedonase. Gjatë punës së tij shumëvjeçare, duke e përkthyer në vazhdimësi letërsinë maqedonase, duke marrë pjesë aktive në tubimet shkencore e duke e studiuar dhe hulumtuar në themel letërsinë shqiptare, dr. Xhevat Gega shfaq një sens të jashtëzakonshëm për studime krahasuese të një vargu procesesh të përbashkëta, të përcaktimeve të ngjashme motivore e stilistike midis letërsisë maqedonase e asaj shqiptare.

Në studimin shkencor “Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit” profesor Xhevat Gega në mënyrën e vet arrin që t'i vë në pah urat lidhëse midis krijimtarisë letrare të Migjenit dhe Koço Racinit.

Fjalët çelës: Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit, pikat puthitëse mes dy letërsive.

Prof. dr. Xhevat Gega lindi në Strugë në vitin 1934. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa normalen në Shkup e Tetovë. Pas diplomimit punon si mësues në fshatin Kishavë të Manastirit. Në vitin 1957 regjistrohet në Fakultetin Filozofik në Beograd ku edhe diplomohet në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Pas diplomimit ka punuar si profesor i gjuhës dhe letërsisë në Normalen “Zef Lush Marku” të Shkupit, ndërsa si bashkëpunëtor i jashtëm ka ligjëruar në Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe pranë Akademisë së Lartë Pedagogjike “Kliment Ohridski” në Shkup. Që nga viti 1978 e deri në pensionim, profesor Xhevat Gega punoi pranë Fakultetit të Filologjisë në Shkup si ligjërues, e më vonë si profesor i historisë së letërsisë shqipe duke kryer vite të tëra edhe detyrën e shefit të Katedrës. Është autor i një numri të madh tekstesh origjinale. Më të rëndësishmet janë Abetarja, fletoret e punës për klasën I – IV, si dhe librat Letërsia me teorinë e letërsisë për klasën e parë të shkollimit të mesëm. Në pasqyrën bibliografike të veprave të dr. Xhevat Gegës përfshihen 72 punime profesionale. Listën selektive të punimeve mund ta grupojmë në tri fusha karakteristike studimi:

1. Punime nga letërsia e re dhe e vjetër shqiptare;
2. Punime për pikat puthitëse midis letërsisë shqiptare dhe asaj maqedonase;
3. Punime nga fusha e letërsisë shqiptare në Maqedoni.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të vërtetohet ndikimi apo pikat puthitëse në veprat e dy shkrimtarëve. Me bagazhin e pasur studiues dhe letrar profesor Xhevat Gega në mënyrën e vet arrin që t'i vë në pah urat lidhëse në krijimtarinë e Migjenit dhe Koço Racinit. Detyra dhe suksesi më i madh i një intelektual dhe

ideologu është që popullit të vet t'ia tregojë rrugën e përparimit dhe jo rrugën e cila çon pas.

Në studimin shkencor “Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe Koço Racinit” në paraqitjen e mëtejme, në një pikë referuese, profesor Xhevat Gega për poezinë e Migjenit “Të lindet një njeri”, shprehet kështu: “Poeti shqiptar do të kërkojë të lindë një njeri që do të jetë i aftë që nëpërmjet rrugës revolucionare ta përmbysë botën e vjetër dhe të krijojë një jetë të re”⁴⁹

Të lindet një njeri

Nga gjin'i dheut tonë të rim' me lotë të vakët

Nga thalb'i i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të flakët

për një gen të ri—

të dali një njeri!

Të mkambi një Kohë të Re!

Të krijojë një Epope!

Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re!

Ndërsa sqarimin për poezinë e Racinit “Makinës së çeliktë” e rrumbullakon me këto fjalë: “Kjo është rruga revolucionare e Racinit dhe vizioni i tij për një botë të re”.⁵⁰

...drejtimin do t'i caktojmë

Kaosit më të ndytë se ne!

⁴⁹ Xhevat Gega, Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit, “Jehona” nr. 10, 1987, Shkup, f. 159.

⁵⁰ Po aty

Fryma dhe bindja e njëjtë penetron edhe në poezinë “Fishekzjarri”. Por, në dallim nga poezia “Makinës së çeliktë”, kjo poezi përshkohet nga tonet e optimizmit për një të ardhme më të lumtur.⁵¹

...kjo është agonia e një rendi që po shuhet

Thyerje e shpartallim

Shenjë misterioze e atyre që padurim presin ndërrimin

Është çlirim i gjithmbarshëm

në ne,

jashtë nesh,

për here të fundit

përgjithmonë!

Shikoni!

Po agon!

Në kundërthënie

Në kontekst të ndikimit është e qartë që ekzistojnë pika puthitëse në mes krijimeve të Migjenit dhe të Koço Racinit. Janë këto shenja dhe elemente që mbajnë afër dhe të pashkëputur lidhjen mes njëra-tjetrës. Kjo është koha dhe hapësira e të vërtetës së Migjenit dhe Kosta Racinit. Dy poetët, së bashku me popullin që e përfaqësojnë, janë të ballafaquar me një jetë të rëndë, me një jetë të paskrupullt. Njeriu i njerimit fillon të ngrihet nga rrënja e Jetës në mes të konfliktit që synon të zhdukë një sistem të rëndë shekullor represiv, që ishte karakteristikë e dy shteteve fqinje ku jetonin poetët

⁵¹ Po aty, f. 160.

Migjeni dhe Kosta Racini. Rrugëtim i mjerimit është rrugëtim ekzistencial dhe kjo na thotë se rrugëtimi i mjerimit është i barasvlefshëm me rrugëtimin e jetës. Ndaj lind pyetja se cila është perspektiva e Njeriut të mjerimit në rrugëtimin e tij ekzistencial? Në shumë raste ky fenomen, kjo dëshirë për mbijetesë qëndron gjithmonë ndezur me të vetmin qëllim që të arrihet ndriçimi në rrugën e dëshiruar. Në qoftë se shohim nga një këndvështrim tjetër, Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni, sipas disa të dhënave, nën ndikimin e fuqishëm të “Mbinjeriut” të Niçes, arriti të nxjerrë në sipërfaqe dy këngët e tij më të bukura “Të lindet njeriu” dhe “Trajatat e mbinjeriut” (Ditiramb i Niçes), poezi e cila i dedikohet Fridrih Niçes si DITIRAMB – ose këngë korale që në Greqinë e lashtë i këndohej Dionisit, perëndisë së rrushit dhe verës. Përmendja e Mbinjeriut këtu është realizuar në një mënyrë konkrete dhe të drejtpërdrejtë.

DITIRAMB I NIÇES

Një zbrazëti shpirtërore në errësirën e pafundme

Në botën e mjerimit, një rreze dielli

Më ngrohu zemrën e ngrirë të kësaj bote të mjeruar.

Në një të ardhme të trashëguar, mbinjeriu shihet,

Me vetëdije dhe pa dyshim

Me vetëdije dhe pa gënjeshtër

Me grusht si granit që kurrë nuk thyhet.

Poezia “Ditiramb i Niçes” na vjen me një dozë të fortë ekspresionizmi, duart e shkrimtarit janë gjithmonë në formën e një grushti të madh të revoltuar, gjithmonë në pozitë të gatshme, në

kohë të caktuar për të derdhur gjithë helmin e zemëruar që kishte grumbulluar brenda vetës, kundër sistemit ekzistues eksploatues shekullor.

Në një pjesë të caktuar të punimit shkencor, profesor Xhevat Gega rrëfen që poetët Millosh Gjergj Nikolla dhe Koço Racini, për shkak të veprimtarisë së tyre, shpesh kanë qenë të ndjekur nga sistemi ekzistues represiv.

“E tërë krijimtaria e Migjenit dhe e Racinit paraqet një përpjekje vetëmohuese për trajtimin e problemeve jetësore të shoqërisë me qëllim që të mbrohen të drejtat njerëzore të të shtypurve dhe atyre pa të drejta. Vepra e tyre, në të vërtetë, është një revoltë e madhe kundër klasave sunduese, kundër absolutizmit të regjimit antipopullor e monarkik në këto dy vende fqinje. Por në të njëjtën kohë, ajo është edhe shprehje e simpatisë dhe e përkrahjes ndaj lëvizjes punëtore dhe komuniste, lëvizje kjo që prej dite në ditë bëhej gjithnjë e më revolucionare. Migjeni dhe Racini në të njëjtën kohë bëhen paralajmërues të luftës revolucionare çlirimtare, e cila shumë shpejt edhe do të pasojë. Prandaj që të dy kanë qenë edhe të ndjekur dhe të keqtrajtuar nga ana e sistemit në pushtet.”⁵²

Prej rreshtave më lart kuptojmë se në çfarë gjendje të mjerueshme kanë qenë poetët apo shkrimtarët e asaj kohe. Për një poezi të shkruar ose të lexuar në një qark, kanë qenë të përndjekur, si bie fjala, Osip Mandelshtami, poet rus. Kur ky ia lexon poezinë e vet “Epigrami për Stalinin” shkrimtarit të famshëm Boris Pasternak, ky i fundit “reagoi në mënyrë të vrullshme duke i thënë: Nuk e kam dëgjuar këtë, ti nuk ma lexove, pasi edhe ti e di, se shumë gjëra të çuditshme ndodhin tani – i mbledhin njerëzit. Kam frikë se edhe

⁵² Po aty, f.157.

muret kanë veshë ose këto stole në Bulevard mund të dëgjojnë. Për atë shkak unë nuk dëgjova kurrgjë. Një muaj më vonë, në maj të vitit 1934, Osip Mandelshtam burgoset në prapun e shtëpisë së vet.”⁵³ Pas kësaj pason dhe djegia e shkrimeve të tij si dhe asgjësimi i tij fizik nga ana e pushtetit të kriminalizuar. Për këto ndodhi është një thënie shumë e qëlluar e shkrimtarit më të madh bashkëkohor shqiptar Ismail Kadare, ku mes tjerash thotë: “Çdo sistem është represiv, por shkrimtari është armiku më natyral i çdo diktature.”

Në faqen 158 të revistës Jehona, në punimin shkencor “Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit”, profesor Xhevat Gega thotë: “Regjimet antipopullore të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë ndaluan shpërndarjen e botimit të parë të “Vargjeve të lira” më 1936 në Tiranë dhe të “Agimeve të bardha” më 1939 në Samobor. Se sa janë të ngjashëm, madje edhe identikë këta dy autorë në krijimtaritë e tyre poetike, le të na bindin edhe shembujt në vijim. Derisa Racini në poezinë “Bijtë e urisë”, shkruan:

...S’kam gjë....jam bir urie:

Vulën e saj mbi trupin tim nëpër botë e bart.

Migjeni në poezinë me titull “Poema e mjerimit” do të na ofrojë vargjet:

„Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla mjerimi,

Mjerimi asht një njollë e pashlyeshme

Në ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.

Dhe kët njollë kurr nuk asht e mundshme

⁵³ Shpresa Memedi, Ismail Kadare: “Kur sunduesit grinden”, Studime Albanologjike 20, ITSHKSH-Shkup, 2020, f. 214.

ta shlyjnë paçavrat që zunë myk ndër tempuj.

Mjerimi s'do mshirë. Por don vetëm të drejtë!

Përfundim

Profesionalizmi dhe dekadat e punës që barti mbi supe profesor Xhevat Gega, janë dëshmi nëpërmjet të inventarit të pasur lënë pas për gjeneratat që pasojnë, dhe një punë utilitare e kolosale e cila nuk ka arshin matës. Rugëtimi jetësor e mësoi të qëndrojë me tërë fuqinë në drejtim të diturisë, duke bërë klasifikim dhe sistematizim në mënyrë shumë të kujdesshme të materialit që e kishte në dorë për studim. Kjo punë e frytshme nga ana e tij u arrit vetëm me durim, vigjilencë dhe përkushtim maksimal në atë çka ai i vuri për detyrë vetes së tij si intelektual dhe studiues i shkëlqyer.

Për punën e mrekullueshme që la pas, i qoftë i lehtë dheu, e pastë shpirtin në parajsë!

Bibliografia

Çabej, Eqrem. Studime Gjuhësore IV. Rilindja, Prishtinë, 1975.

Gega, Xhevat. Nota sociale në krijimtarinë e Migjenit dhe të Racinit. Jehona, nr. 10, Shkup, 1987.

Mustafa, Avzi. 40 vjet veprimtari arsimore dhe shkencore të prof. dr. Xhevat Gegës. Shqyrtime Albanologjike 3, Lidhja e Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare në Maqedoni, Shkup, 1997.

Vinca, Agim. Kurs i Teorive Letrare. Libri Shkollor, Prishtinë, 2000.

FARKETA DIBRA-ZEQIRI

Fakulteti i Filologjisë "Blazhe Koneski" – Shkup

ZBATIMI I METODËS ANALITIKE – SINTETIKE NË ABETAREN E PROFESOR XHEVAT GEGËS

Figurat e ndritura të arsimit, dijes, kulturës, shkencës dhe historisë së një populli nuk mund të shuhen aq lehtë, meqenëse vlerat dhe gjurmët që kanë lënë ndër vite janë aq të mëdha dhe të panumërta, saqë emri i tyre është sinonim në çdo bisedë që lidhet në çdo sferë të jetës.

Historia jonë kombëtare do t'i kujtojë ata patriotë, mësues, poetë, mendimtarë që asgjë nuk kursyen për shqiptarinë, ata që për ne janë fytyrat më eminente të historisë sonë kombëtare. Ata që rilindën shpresën për një gjuhë, për një komb, për një shkollë shqipe, rilindësit e shqiptarizmit, si: Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Jani Vreto, Zef Jubani, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jeronim de Rada, Hasan Tahsini, Thimi Mitko, Aleksandër Xhuvani, Ndue Paluca, Jani Minga, Mati Logoreci, Gaspër Benusi, Lumo Skendo, Jani Risto Terova e deri te më të rinjtë, si Qamil Guranjaku, Kol Xhumari, Qamil Batalli, Mehmet Gjevori etj.⁵⁴

Në mesin e këtyre figurave nuk ka se si të mungojë edhe emri i profesorit të nderuar Xhevat Gega. Ai, me dijen dhe përvojën e tij la një fond të pasur në thesarin e bibliotekës shqiptare, krijoi një traditë, vuri themelet në disa metoda të shkrim–leximit të gjuhës

⁵⁴ https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB_Mesonjetorja.pdf

sonë, duke krijuar në brezni të tëra kënaqësinë e përvetësimit të shprehive të leximit dhe të shkrimit të gjuhës amtare, duke vënë në duart e qindra e mijëra të miturve shqiptarë, librin që u mësonte lexim–shkrimin shqip, pra librin e quajtur Abetare.

Viti 1970 është ogurbardhë për shqiptarët e Maqedonisë. Në këtë vit prof. Gega hartoi librin e titulluar *"Abetare – zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës."* Me botimin e Abetares, profesori Gega u ra kambanave të një epoke të re për shkollën shqipe në Maqedoni, për didaktikën e arsimit fillor, duke konceptuar drejt nevojën urgjente të kohës.

Abetarja e prof. Gegës është fryti i një veprimtarie të gjerë dhe të larmishme arsimore, pedagogjike, profesionale–shkencore. Gjatë gjithë kohës sa punoi e veproi, rrethanat diktuan që profesori ynë i nderuar të merret me çështje të ndryshme shkencore, arsimore, kulturore etj. Fillimisht duke punuar si mësimdhënës në shkollë fillore, të mesme, e më pas si ligjërues në universitet; përkthyes; hartues tekstesh mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollë fillore dhe të mesme; bashkëpunëtor në përgatitjen e plan–programeve mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe; bashkëpunëtor në seminare për ngritjen permanente të arsimtarëve për shkollat e mesme me tema të ndryshme nga fusha e letërsisë dhe metodikës së mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe, të organizuar nga ana e Entit Pedagogjik Republikan të Maqedonisë etj.

S'do mend se një personalitet me një bagazh kaq të pasur shkencor–kulturore dhe me njohuri të jashtëzakonshme në fushën e arsimit do na linte si trashëgimi një Abetare kaq të çmuar, e cila edhe pas gjysmë shekulli frymon me po të njëjtën vlerë dhe rëndësi.

a) Rëndësia gjuhësore, didaktike dhe edukative e Abetares së prof. Xhevat Gegës

Abetarja e profesorit Xhevat Gega është një dokument me shumë rëndësi për gjuhën shqipe, për historikun e shkrimit dhe të përdorimit të saj në shkollë, për edukimin dhe arsimin e fëmijëve shqiptarë në Maqedoni, por edhe më gjerë. Në këtë Abetare, sikurse edhe në Abetaret kudo në botë, shfaqet tharmi kombëtar, kjo ndjenjë kombëtare vjen si domosdoshmëri e gati mbijetesë referuar kushteve historike në të cilat ajo është hartuar.

Hartimi i librave shqip dhe i Abetares shqipe tregon vullnetin e mirë dhe ndërgjegjen e lartë atdhetare të autorit. Prof. Gega me kompetencën e një dijetari shkel në disa shtigje të vështira dhe përgjithësisht të parrahura apo të rrahura fare pak në Maqedoni. Në një kohë kur tradita e hartimit të teksteve shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut ishte e paktë, profesori Gega arriti të hartojë tekst të unifikuar që kanë pasur mundësi ta kuptojnë dhe përdorin si nxënësit e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe ata të Kosovës dhe të Shqipërisë. Kjo dëshmon se, ai ka qenë metodist i mirë, mjeshtër i denjë e mbi të gjitha mësues praktik, se ka njohur në thelb traditën e shkrimit shqip. Nëse sot luftohet për një Abetare të unifikuar Shqipëri–Kosovë–Maqedoni, një nxënës i Maqedonisë së Veriut që në vitet e ‘70–ta përmes Abetares së profesorit Gega e ka pasur një mundësi të tillë.

Pra, prof. Gega me hartimin e Abetares kontribuoi në unifikimin e gjuhës shqipe për mbarë trevat shqipfolëse, për të pasur një kod të lexueshëm dhe të kuptueshëm për të gjithë, në një kohë kur mungonin standardet në lëndën e gjuhës dhe të leximit letrar. Kjo pjesë e veprimtarisë së tij lidhet me nevojën e kohës, për ta shkruar gjuhën shqipe me germa të vetat, autentike. Abetarja ishte libri që

ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni *"ishte arma më e fuqishme për të shkëputur arsimin tonë nga varësia e arsimit në gjuhë të huaj. Me përmbajtjen e saj, ajo ndikoi fuqishëm në edukimin e gjeneratave të tëra me ndjenjat më të larta atdhetare dhe fisnike.*⁵⁵

Abetaren e prof. Gegës mund ta konsiderojmë si vepër historike, kulturore, arsimore, linguistike, patriotike, e cila u hapi rrugën teksteve mësimore në gjuhën shqipe në Maqedoni por edhe më gjerë, duke u dhënë autorëve pasardhës modelin e shkëlqyer të Abetares, si libër fillestar për mësimin e shkrim–leximit. Me botimin e Abetares prof. Gega dëshmoi se vlera e një vepre nuk qëndron aq në vëllimin e saj, sesa në rrugën që hap e në idetë që përçon.

Në tekstin *"Abetare–zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës*, dëshmohet puna e prof. Gegës edhe si një linguist i denjë, copat e leximit dallohet nga aspekti gjuhësor për qartësinë e shprehjes dhe pastërtinë e gjuhës. Brenda faqeve të Abetares nuk ndeshim shprehje abstrakte dhe konfuze që e detyrojnë nxënësin ta mësojë lexim–shkrimin përmes kujtesës mekanike, por ndodh e kundërta, çdo frazë ose copë leximi lexohet dhe mësohet përmes kujtesës logjike.

Në Abetare ka një organizim të kombinuar të mësimin të leximit dhe të shkrimit fillestar, i cili ecën sipas hapave metodikë të mësimin të shkronjave, duke evidentuar veçoritë grafike dhe ato fonetike të tyre, si bukurshkrimin edhe ortografinë. Një kujdes të veçantë prof. Gega i ka kushtuar drejtshkrimit të grupeve të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve, përdorimit të theksit etj. Te fjalët që e kanë

⁵⁵<https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-shefik-osmani-prof-as-dr-njazi-kazazi-abetaret-e-para-shqipe-dhe-trajektorja-historike-e-tyre/>

theksin në rrokjen parafundore, autori nuk vendos asnjë shenjë, pasi theksin parafundor e merr si model theksor të zakonshëm të fjalëve të shqipes. Kështu, faktori didaktik lidhet me: njohjen e shkrimit me sy, shqiptimin e fjalëve dhe me kuptimin e tyre.

Përkitazi me këtë, profesori Gega ndalet edhe në përdorimin e shenjave të pikësimit. Përmes copave të leximit synon që mësuesi, përveç të lexuarit dhe të shkruarit të gjuhës amtare, t'u mësojë nxënësve edhe: pikën, pikëpresjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen, dy pikat, vizat, kllapat, thonjëzat, tri pikat, paragrafët e kështu me radhë. Nëpërmjet udhëzimeve të shkurtër, krijon një terminologji gramatikore shqiptare, e cila ka zënë vend në traditën tonë gramatikore.

Karakter i edukativ i Abetares nuk është më i paktë se ai arsimor e kombëtar. Me përmbajtjen e saj, kjo Abetare ka shërbyer tri dekada me radhë si mjet i fuqishëm për edukimin etik, estetik dhe artistik të fëmijëve në këtë etapë të parë të shkollimit të tyre. Ana edukative jetësohet përmes figurave dhe tablove të Abetares, në bazë të bisedave dhe përshtypjeve të drejtpërdrejta nga jeta, puna, natyra, shoqëria, shkolla etj., duke ngjallur te nxënësit dashurinë për atdheun, gjuhën amtare, shkollën, për punën, shokun etj. Njëkohësisht, u zgjon atyre ndjenjën e urrejtjes për çdo gjë të keqe e të shëmtuar, urrejtjen për armikun, dembelizmin, intrigën, thashethemet etj.

Prof. Gega me botimin e Abetares dha ndihmesë të madhe në shumë drejtime, para se gjithash: ndihmoi në zhvillimin dhe pasurimin e fjalorit dhe kulturës folëse të nxënësve nismëtar të shkollës fillore; shtoi numrin e fjalëve dhe përdorimin e drejtë të tyre në praktikën e komunikimit të përditshëm gjuhësor; korrigjoi trajtat e të folmes lokale; ushtroi të folurit dhe gjuhën e normuar;

ndihmoi edhe në përvetësimin gradual të diturive të para nga gramatika dhe drejtshkrimi etj.

b) Struktura e Abetares

Abetarja konsiderohet si libri më i rëndësishëm në jetën shkollore të një nxënësi, ajo u mëson nxënësve të lexojnë me kuptim tregime e tekste të ndryshme me karakter letrar e jo letrar, të shkruajnë tekste të shkurtra, fjali, fjalë dhe ushtrime të ndryshme me karakter analitik, sintetik dhe krijues.

Libri *"Abetare – zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"* i profesorit Xhevat Gega është me paraqitje të bukur dhe ilustrime dinjitoze. Ajo është moderne, bashkëkohore, cilësore dhe me nivel shkencor e pedagogjik, pavarësisht se ka kaluar gjysmë shekulli që nga botimi i parë. Këto vlera dhe merita u dëshmuuan me ribotimet e shumta që pësoi dekada me radhë. Një pasqyrë kronologjike e ribotimeve të Abetares së profesorit Xhevat Gega duket si vijon:

1. *"Abetare – zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"*, Xhevat Tahir Gega, Shkup, Prosvetno Dello, 1970, 1971, 1973, 1975, 1976.

2. *"Abetare: zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"*, Xhevat Gega, Shkup, Prosvetno dello, 1978, 1979, 1986, 1987, 1989, 1990, 1991, 1998, 1999, 2000.

Botimi i parë është titulluar *"Abetare – zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës"*, d.m.th. janë mësuar paralelisht edhe shkronjat e shtypit edhe të dorës, por ky titull ka figuruar deri në ribotimin e vitit 1976. Në ribotimet që fillojnë nga viti 1978–2000 ndryshon emërtimi, radhiça dhe struktura. Libri titullohet *"Abetare – zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"* pra, në fillim mësohen të gjitha shkronjat e shtypit dhe më pas të dorës.

Ndryshime në përmbajtjen e librit dhe në temat që janë veçuar për t'u punuar vërejmë në botimin e vitit 2000, krahasuar me ribotimin e tri dekadave më parë, shohim se pjesa dërrmuese e temave ndryshojnë dukshëm për nga përmbajtja, hera-herës hasen ndryshime në radhitjen e shkronjave e të ilustrimeve.

Ky fakt dëshmon se profesori Gega vazhdimisht është ngritur profesionalisht dhe shkencërisht për të qenë në hap me kërkesat e kohës, duke e pasuruar dhe përsosur vazhdimisht, ngase edhe vetë Abetarja ka një rol të tillë, ajo duhet të jetë sa më e bukur, tërheqëse dhe argëtuese, që ta mbushë fëmijën plot me gëzim për faktin që ka ardhur në shkollë apo që po mëson të lexojë e të shkruajë shqip.

Kjo Abetare e realizon synimin e saj nëpërmjet metodave dhe formave pedagogjike e psikologjike nga më të ndryshmet. Ajo është mjaft e kompletuar. Materiali i leximit është në formë të ndryshme, si: tregime, poezi, lojëra të shumta, nga krijimtaria popullore ka përralla, anekdota, këshilla moralizuese etj.

Në përzgjedhjen e copave të leximit që ka përdorur në Abetaren e tij, profesori Gega, duke respektuar kriteret e programit, ka zgjedhur krijime vërtet të arritura, si nga ana artistike, ashtu edhe nga ajo ideore. Në Abetare ndeshim mesazhe të fuqishme humaniste, mesazhe të mirësisë dhe bujarisë, mesazhe të paqes dhe tolerancës, mesazhe të punës dhe, mbi të gjitha, mesazhe të dashurisë ndërnjerëzore në të gjitha format e saja. Të gjitha këto vlera janë menduar se duhet t'i jepen një brezi që është në zhvillim për ta formuar identitetin e tij, për të qenë krenar për historinë, kulturën, traditën dhe përkatësinë e tij kombëtare. Shembuj të kësaj natyre kemi në copat e leximit: *"Thimi në mulli"*, faqe 53; *"Punëtori i mirë"* faqe 95, *"Qaniu mekanik"*, faqe 48, *"Pali zejtar"*

faqe 76, "*Ç'do të bëhem*" faqe 77, "*Punëtori*" faqe 76, ku prof. Gega me mjeshtëri na njofton mbi dashurinë dhe dëshirën që kanë fëmijët për punën.

Dashurinë për atdheun e hasim në pjesët e leximit: "*Liria është e shenjtë*" faqe 58, "*Republikës*" faqe 59, "*Flamuri i kuq*" faqe 101.⁵⁶

Duke dashur të ngjallë dashurinë për shkollën si vendi më i dashur ku nxënësit edukohen, argëtohen e mbi të gjitha arsimohen, nëpërmjet pjesës së leximit: "*Shkolla ime*" faqe 77, "*Askush s'ka shokë sa unë*" faqe. 60, prof. Gega arrin ta realizojë një qëllim të tillë. Një vend të veçantë zënë tregimet ku ushqehet dashuria për mësuesen, ku me fjalët më të ëmbla përshkruhet kjo ndjenjë fisnike. Shembuj të tillë na ofrojnë copat e leximit: "*Klasa jonë*" faqe 81, "*Mësuesja jonë*" faqe 86, "*Shkronja Zh*" faqe 106. Dashuria ndaj prindërve pasqyrohet me shumë kujdes në vjershat: "*Nënë e baba unë i dua*" faqe 69, "*Nëna*", faqe 72, "*Nënë, u rrita*" faqe 87.

Respektin ndaj të moshuarve e gjejmë në tregimet: "*Një plak*" faqe 52 dhe "*Tre shokë*" faqe 72. Në Abetare nuk mungojnë edhe këshillat moralizuese, të cilat me mjeshtëri janë përzgjedhur për t'u paraqitur në tregimet: "*Dhepra para gjyqit*" faqe 103 dhe "*Macja dhe miu*" faqe 71. Në disa faqe të Abetares, prof. Gega na jep si model fjalë të urta dhe shprehjet edukative, të cilat ndikojnë në ngritjen e ndërgjegjes dhe moralin e nxënësit, si p.sh.: "*Punë, punë natë e ditë që të shohim pakëz dritë!*" faqe 76; "*Libri është shoku më i mirë i jetës!*" faqe 60, "*Puna e nderon njeriun!*" faqe 77; "*Mësim, mësim e vetëm mësim!*" faqe 88; "*Liria është shoku më i mirë i jetës!*" f. 99.

⁵⁶ Shembujt e lartpërmendur janë marrë nga botimi i parë i Abetares e vitit 1970.

Një nga anët më të forta të Abetares është lidhja e fuqishme ndërlëndore. Teksti krijon lidhje të ngushta me lëndën e matematikës. Disa herë nxënësit i duhet të numërojnë, të krahasojë, të klasifikojë apo të plotësojnë tabela. Shembuj të kësaj natyre paraqiten në faqen 38, 42, 98; por jo të grupuara në mësimet të përbashkëta për njohuritë matematikore, por të integruara në mësimet e abetares, si p.sh., numrat nga 1 – 4, mbledhje (dy plus dy sa bëjnë?; (një edhe një bëjnë dy); shumëzimi (3 herë 1 bëjnë tre; 5 herë 1 bëjnë 5).

Lidhja me letërsinë realizohet përmes shembujve të letërsisë artistike. Ndërthurja e këtyre njohurive me tekstet eseistike dhe ndërtimi i pyetjeve dhe ushtrimeve synojnë aftësimin praktik të nxënësve për të konkretizuar në shkrimet e tyre njohuritë gjuhësore.

Lidhja e nxënësit me pikturën sigurohen nëpërmjet ushtrimeve të shumta që kërkojnë herë të vizatohet një objekt e herë të ngjyrosët, si edhe nga ilustrimet e shumta të bukura që figurojnë në abetare.

Për renditjen dhe mësimin e tingujve dhe shkronjave, në Abetare profesori Gega u ka kushtuar rëndësi parimeve të njohura në metodologjinë bashkëkohore të hartimit të Abetareve, siç janë: parimi i vështirësisë shqiptimore të tingujve (parimi fonetik); parimi i vështirësisë grafike të shkronjave; parimi i dendurisë ose frekuencës së përdorimit të tingujve në gjuhën e folur e të shkruar. Mësohen më parë tingujt që shqiptohen më lehtë dhe shkronjat me strukturë grafike më të thjeshtë, si p.sh. fillohet me shkronjat *A, M, I, U, N, E, L, R, Ë, K, O, T.....*(f. 24–35), e më pas vazhdohet me shkronjat më të ndërlikuara si: *P, D, B, J, S, H, Y, F, V, C* (f. 36–

45) e për të pasuar më tej me shkronjat G, LL, Q, Sh, Rr, Nj, Gj, Th, Dh, X, Z, Zh, f. 46–55.⁵⁷

Renditja dhe mësimi më parë i tingujve dhe shkronjave me shkallë më të lartë përdorimi në komunikimin e përditshëm në të folur dhe shkruar mundëson që fëmijët nismëtar të shkollës fillore, brenda një kohe më të shkurtër të aftësohen të flasin dhe të shkruajnë.

Parimi udhëheqës i fotografimit të figurave–fjalë dhe të fjalive–figurë, si dhe i fjalëve kyçe është një kriter që respektohet në këtë Abetare dhe që ndihmon në mënyrë të ndjeshme në kapërcimin e vështirësive të para tek nxënësit, të tilla si ato të përdorimit të fjalëve kyç dhe lidhëse, apo siç janë foljet e para që duhen përdorur, si: *ka, kam, jam, luan*; fjalëzat *me, në* etj. Njohja pamore e strukturës së këtyre fjalëve jep dorë për lidhjen logjike të fjalëve në struktura fjalish, fillimisht të thjeshta e më pas edhe më të zgjeruara.

Parimi i rimarrjes zë vend të dukshëm në Abetare. Ai nis me rimarrjen e shkronjave në çdo faqe të librit dhe më pas vijon me rimarrjen për analizë të fjalëve të vështira, si dhe të fjalëve me probleme drejtshkrimore, kryesisht me ato grupe shkronjash tri–katër rrokëshe, si dhe me rrokje të vështira (të mbyllura) për t'u përvetësuar nga nxënësit që në çastin e parë të paraqitjes së tyre. Rimarrja zë një vend të rëndësishëm edhe gjatë punës me shkronjat, në çdo 6 shkronja bëhet një rimarrje: në këto çaste, nxënësit ushtrohen për të lexuar tekste të ndryshme dhe për të bërë ushtrime sinteze e analize të fjalëve e fjalive të veçanta, të rimarra nga mësimet e mëparshme, pa përjashtuar ato të rejtat.

⁵⁷ Radhitja e lartpërmendur i referohet ribotimit të fundit të Abetares, viti 2000.

c) Zbatimi i metodës analitike–sintetike

Për problemin e të mësuarit të lexim–shkrimit të fëmijët, mendime të ndryshme dhe mbarëkombëtare ngulin këmbë me të drejtë se, për mësimin e tij të përdoren metoda jo të improvizuara, por metoda që kanë vlerë të sigurt shkencore, të jenë eksperimentuar gjerësisht dhe që mund të japin garanci për suksesin dhe që kanë të bëjnë me arritjen dhe përvetësimin e disa aftësive e mjeteve që lidhen me teknikën e leximit dhe të shkrimit.

Po cilat janë tipat e metodave që janë përdorur historikisht dhe të atyre që kanë të bëjnë me kërkimet që janë bërë dhe po bëhen aktualisht? Më shumë se për metoda të veçanta, këtu mund të flitet për prirje metodologjike, d.m.th. për një grup metodash të cilat me gjithë ndryshimet që kanë midis tyre, kanë të përbashkët një skemë, një substrat, një procedim e një mbështetje shkencore. Të tilla grupime metodologjike janë në një numër të kufizuar, por brenda tyre mund të dallojmë një numër të madh metodash specifike me variante të përbashkëta, mbi një skemë referimi, që bën të mundur futjen e tyre në një grup të gjerë.

Hulumtimet në fushën e psikologjisë së edukimit kanë provuar se leximi dhe shkrimi, si procese psiko–fiziologjike, kanë rrjedhë të kundërt, njëri është analitik (leximi) dhe tjetri sintetik (shkrimi). Bazuar në këtë kriter në Konferencën e 12–të Ndërkombëtare për Edukim Publik të UNESCO–s e të Byrosë Ndërkombëtare për Edukim, u miratua klasifikimi i metodave të mësimit të leximit–shkrimit fillestar në këto tri grupe bazë:⁵⁸

1. Metoda sintetike (këtu përfshihen edhe ato fonetike, globale);

⁵⁸ https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha_Shqipe/3.pdf

2. *Metoda analitike;*

3. *Metoda analitike–sintetike;*

4. *Metoda mikse.*

Varianti më i përhapur dhe më i zbatueshëm në mësimin e lexim–shkrimit fillestar në shkollat tona është metoda analitike–sintetike e tingullit, që i përshtatet më mirë natyrës së gjuhës shqipe. Mbështetur në këtë metodë, profesori Xhevat Gega e ka hartuar tekstin *"Abetare – zhvillim veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"*, pra orientimi metodologjik në këtë abetare është drejt metodës analitike–sintetike.

Zbatimin e metodës analitike–sintetike në *"Abetare – zhvillim veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës"*, profesori Xhevat Gega e jetësoi përmes tri periudhave kryesore:

a) *periudha përgatitore për lexim–shkrim, ndryshe e quajtur **Paraabetarja**;*

b) *periudha e dytë lidhet me mësimin e shprehive themelore të teknikës së lexim–shkrimit, ndryshe e quajtur **Abetarja**;*

c) *Periudha e tretë lidhet me përf forcimin e teknikës së lexim–shkrimit, kjo periudhë ndryshe njihet si **Pasabetarja**.*

I. *Periudha përgatitore për lexim–shkrim – Paraabetarja* fillon që ditën e parë të ardhjes së fëmijës në shkollë dhe zgjat rreth dy javë. Qëllimi është që gjatë kësaj periudhe nxënësi të përgatitet për të mësuar shkrimin dhe leximin sipas metodikës analitike–sintetike. Prandaj, në këtë periudhë mësuesi duhet të punojë në shumë drejtime, me qëllim që t'i nxisë dhe zhvillojë të gjitha aftësitë e fëmijëve dhe t'u zgjojë atyre interesin për mësimin e shkrim–leximit. Duke i dhënë karakter emocional e të gëzueshëm mësimin

në këtë periudhë, mësuesi nxit vëmendjen dhe interesimin e nxënësve, i përgatit ata gradualisht që të kalojnë nga loja (që në periudhën parashkollore ishte forma kryesore e veprimtarisë së tyre) te puna e disiplinuar. Gjithashtu, në këtë periudhë, duhet bërë një punë këmbëngulëse për ta përgatitur nxënësin që të jetë në gjendje të perceptojë sa më mirë realitetin. Bëhen ushtrime për zhvillimin e të vëzhguarit, të dëgjuarit, të shqiptuarit, si dhe për shkathtësimin e dorës, sidomos të gishtërinjve për të mbajtur lapsin dhe për të lëvizur në drejtime të ndryshme gjatë shkrimit. Nga faqja 4–23 të Abetares, prof. Gega ka paraqitur materiale shumë të bukura për këtë qëllim, siç janë figurat e ndryshme, skicat dhe vizatimet, elementet e shkronjave në nënfletat e Abetares, materiale për dëgjimin e fjalëve një, dy ose trerrokëshe, për shqiptimin dhe dëgjimin e tingujve e kështu me radhë.⁵⁹

Në fazën e dytë të kësaj periudhe profesor Xhevati i orienton nxënësit drejt mësimit të fjalisë së thjeshtë me dy gjymtyrë kryesore dhe asaj të zgjeruar me një fjalë plotësuese. Shumë të përshtatshme për këtë qëllim janë figurat e dhëna në faqet 6, 9, 10 ku nxënësit me ndihmën e mësuesit, duke u bazuar në figurat krijojnë fjali me dy e me tre fjalë, e pastaj i ndajnë fjalët e fjalisë. Më tej, duke u mbështetur në figurat e faqeve 11–14 nxënësit ushtrohen edhe për ndarjen e fjalës në rrokje, d.m.th. për analizën e fjalës në pjesë përbërëse më të vogla. Kështu, në etapën përgatitore nxënësit mësojnë se ligjëratat përbëhet nga fjalitë, fjalitë nga fjalët, fjalët nga rrokjet dhe rrokjet nga tingujt.

Ndër detyrat kryesore të periudhës përgatitore është edhe zhvillimi i ligjëratës së nxënësve. Ndër format më të përshtatshme që na ka

⁵⁹ S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 10.

ofruar prof. Gega është shfrytëzimi i figurave që pasqyrojnë aspekte të veçanta nga veprimtaria e një njeriu, tiparet e një kafshe a sendi. P.sh. duke e parë figurën e parë që gjendet në faqen 7 të Abetares nxënësi thotë: *Dritani ngrihet nga shtrati*. Për figurën e dytë thotë: *Dritani bën gjimnastikën e mëngjesit*, e kështu me radhë vazhdon për të gjitha figurat e paraqitura. Në këtë mënyrë, mësuesi u bën me dije nxënësve se çdo figurë paraqet një mendim, çdo figurë mund ta përshkruajmë me fjalë dhe se fjalët e lidhura mes tyre për nga kuptimi do t'i quajmë fjali.

Punën sistematike për ndarjen e fjalës në rrokje prof. Gega e fillon në faqen 27 të Abetares. Forma e punës që ka zbatuar profesori për të zbuluar para nxënësit rrokjen është shumë e përshtatshme, pasi i nxit nxënësit që duke krahasuar shqiptimin e dy fjalëve, të arsyetojnë dhe me ndihmën e mësuesit, të nxjerrin konkluzionin duke përcaktuar rrokjen e parë dhe rrokjen e dytë të këtyre fjalëve.⁶⁰

Pas përforcimit të nocionit të ndarjes së fjalës në rrokje, vjen identifikimi i tingullit. Identifikimi i tingullit është një lloj veprimi fare abstrakt për moshën e fëmijëve 6–7 vjeçarë, pasi tingulli si element përbërës i fjalës, duke mos pasur asnjë kuptim në vetvete, mezi mund të kapet prej nxënësve. Puna për dhënien e nocionit si dhe për të përgatitur nxënësin për identifikimin e tingullit fillon qysh në periudhën përgatitore dhe vazhdon deri në fund të Abetares. Vetëm atëherë kur nxënësi, me ndihmën e mësuesit, arrin ta veçojë tingullin nga rrokja ose fjala, ai e kupton se tingulli është pjesë përbërëse e rrokjes dhe e fjalës dhe vetëm atëherë mund të fillojë të mësojë të lexojë e të shkruajë. Për ta bërë më të kapshëm

⁶⁰ S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 13.

këtë proces, prof. Gega në abetare ka pasqyruar tri modele pune për veçimin e tingullit:

1. Mënyra e parë e analizës bëhet duke shqiptuar qartë fjalën në rrokje, pastaj rrokja që ka tingullin e ri shqiptohet duke ia zgjatur tingujt. Në qoftë se duam të veçojmë tingullin *m* marrin p.sh. fjalën *mama*, këtë fjalë e shqiptojmë rrokje më rrokje si (ma—ma), pastaj u themi nxënësve të dëgjojnë me vëmendje shqiptimin e rrokjes *ma*. Mësuesi e shqipton rrokjen ngadalë, duke i zgjatur tingujt *mmmmma*, për ta përkapur atë sa më mirë.

2. Mënyra e dytë e analizës bëhet duke e veçuar tingullin e ri në fund të fjalës. Tingujt që të mund të veçohen më lehtë në këtë mënyrë janë, p.sh.: tingulli *j* i cili mund të veçohet nga fjalët *kuaj*, *muaj*; tingulli *p* nga fjalët *top*, *shkop*. Shqiptimi i këtyre fjalëve duhet të bëhet duke e artikuluar qartë tingullin e fundit të fjalës.

3. Mënyra e tretë e analizës mund të bëhet në fjalë ku tingulli që duam të veçojmë të jetë në fund, sikurse për mënyrën e dytë, por me ndryshim që fjala shqiptohet nga mësuesi me mungesë të tingullit të fundit, për t'u plotësuar nga nxënësit. Për të veçuar tingullin *k* nga fjala *shok*, mësuesi thotë se do të shqiptojmë fjalën *shok* dhe në atë çast shqiptohet vetëm *sho*, duke pritur që fjala të plotësohet me tingullin *k* nga fëmijët. Fëmijët e plotësojnë duke shqiptuar *k—në*.

Pas analizës së tingujve kalohet në një fazë tjetër, në atë të sintezës së tingujve. Për t'i prerë rrugën leximit sipas mënyrës jo të përshtatshme të bashkimit të shkronjave, prof. Gega në "*Abetaren — zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*" ka përdorur këto forma pune për sintetizimin e tingujve:

1. Leximi i rrokjes dhe i fjalës pasi të jetë bërë analiza e plotë e saj. Në këtë mënyrë lexohen të gjitha fjalët që paraqesin një farë vështirësie në të lexuar e në të shkruar e që mësuesi mendon t'i ushtrojë. Kështu, veprohet për t'i lexuar fjalët: *u-ra*, *mi-u* etj. Pas bisedës së përgjithshme kërkohet që nxënësit t'i ndajnë në rrokje e tinguj, pastaj t'i lexojnë të plota këto fjalë. Shembuj të tillë janë pasqyruar në faqen 27 të Abetares.⁶¹

2. Leximi i plotë i rrokjeve dhe i fjalëve pasi të jenë analizuar dhe punuar më parë. Kështu, veprohet për ta lexuar të plotë ose për ta shkruar fjalën *mu-ri*. Fjala ndahet në rrokjet: *mu* dhe *ri*. Rrokja *mu* ndahet në tinguj. Nxënësit gjejnë shkronjën e tingullit të parë **m**, pastaj gjejnë shkronjën e tingullit të dytë **u**, të cilën e vendosin pranë të parës (m), kështu rrokja *mu* lexohet e plotë. Merret pastaj rrokja e dytë *ri*, bëhet analiza dhe gjendet shkronja e tingullit të parë, pastaj edhe e tingullit të dytë, pastaj lexohet si rrokje e plotë. Në fund mësuesi i afron rrokjet pranë njëra-tjetrës dhe nxënësit lexojnë fjalën *mu-ri*.

3. Leximi i rrokjeve dhe i fjalëve duke u mbështetur në ngjashmërinë e tyre me rrokjet dhe fjalët e mësuara më parë. Kështu, sipas kësaj mënyre mund të lexohet fjala *ma-mi* pas fjalës *ma-li*, fjalët *Ma-ra* dhe *Mi-ra*, shembujt janë pasqyruar në f. 31 të Abetares. Duke i lexuar fjalët sipas kësaj mënyre nxitet mendimi krijues i nxënësve dhe fitohet kohë, pasi një pjesë e fjalës lexohet drejtpërdrejt, pa punuar më parë me shkronjat e shtypit.

4. Leximi i rrokjeve të plota, duke u mbështetur në zgjatjen e tingullit të tyre bashkëtingëllor dhe në kalimin e shpejtë në zanoren që vjen pas. Veprohet kështu: Fjala **lu-le** ndahet në rrokje dhe në

⁶¹ S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 22.

tinguj. Rrokja e parë shkruhet me shkronjë të shtypit. Mësuesi kërkon që nxënësit të shqiptojnë bashkëtingëlloren *l* më të zgjatur dhe të mos e ndërpresin, derisa ai t'u tregojë zanoren *u* që vjen pas. Kështu lexohet më parë rrokja *lu*, pastaj *le* dhe në fund e gjithë fjala *lllu-lllle* etj. Shembuj të tillë profesor Gega ka pasqyruar në f. 30 të Abetares.

5. Leximi i rrokjeve dhe i fjalëve duke u shtuar atyre ose duke u hequr tinguj të ndryshëm nga fillimi, fundi ose mesi. Kjo mënyrë e sintezës gjen zbatim të gjerë kudo, si në mësimet për paraqitjen e tingujve e të shkronjave, ashtu edhe në ato të përpunimit të faqeve, të përsëritjes, në mësimet e shkrimit etj. Edhe në këtë mënyrë, prof. Gega na ndihmon që t'i drejtojmë nxënësit nga e njohura tek e panjohura, duke lehtësuar kështu kalimin e vështirësisë në të lexuarit e fjalëve të reja e duke kursyer kohë. Mund të veprohet kështu, p.sh.: meqenëse rrokja *ra* është e njohur, i aktivizojmë nxënësit ta shkruajnë dhe ta lexojnë. Pastaj marrim në dorë shkronjën *o* – të vogël të shtypit dhe u themi nxënësve ta lexojnë. Kështu e vendosim pranë rrokjes *ra*. Nxënësit lexojnë *o-ra*.⁶²

II. *Në periudhën e dytë të mësimin të shkrim–leximit, ndryshe e njohur si Abetarja* fëmijët duhet të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë shkronjat, të lexojnë dhe të shkruajnë fjalë që formohen me ato shkronja. Mësimi i leximit dhe i shkrimit duhet të shkojnë paralelisht dhe të mësohen njëkohësisht. Mësimi i shkrimit nuk duhet të quhet si mësimi i teknikës së shkrimit të shkronjave, por si mësimi i vërtetë për të mësuarit e shkrim–këndimit. I gjithë sistemi i punës, për të mësuarit e shkrim–këndimit, mbështetet në një punë të mirë, të kujdesshme dhe sistematike për zhvillimin e të folurit të

⁶² S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica, *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë, 1973, f. 23-24.

nxënësve (punë me fjalorin për pasurimin e tij, përgjigje pyetjeve, përralla, zbërthimi i fjalisë në fjalë, komentim figurash, bisedë rreth fjalive dhe copave të vogla etj.). Periudhën e mësimit të shkrim–leximit prof. Gega e ndan në tri etapa.

Në etapën e parë studiohen në mënyrë praktike 12 tingujt dhe shkronjat sipas radhës që janë paraqitur në Abetare. Gjatë kësaj etape vërejmë se profesori Gega ka zbatuar këto mënyra pune:

- a. zbërthim fjalësh në rrokje e tinguj dhe bashkim tingujsh në rrokje e fjalë.
- b. shtim zanoresh dhe bashkëtingëlloresh në fjalë të caktuara (ra, o–ra, mo–ra).
- c. shkëmbim zanoresh dhe bashkëtingëlloresh ndërmjet fjalëve (e–ra, a–ra, ma–li, me–li. te–li, me–li).
- ç. kalim nga leximi i rrokjeve të hapura në leximin e rrokjeve të mbyllura me anë të pakësimit (ma–li, mal).

Fëmijët mësojnë t'i ndajnë fjalët në rrokje e tinguj dhe me rrokjet dhe tingujt të formojnë përsëri fjalët. Në çdo faqe të Abetares nxënësit komentojnë figurat, lexojnë fjalët e renditura në shtylla dhe fjalitë. Detyrë tjetër e mësuesit është që t'u zhvillojë nxënësve mënyra të drejta leximi, t'i mësojë se si t'i lidhin tingujt bashkëtingëllore me tingujt zanorë, d.m.th. të lexojnë në mënyrë të përngjitur rrokje të hapura të përbëra prej dy shkronjash, të tipit *ra*, *me*, *ta*; *mi*, *nu*, *li*, *rr*i dhe fjalë dyrrrokëshe të tipit *ura*, *mana* dhe njërrokëshe.⁶³

⁶³ Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, *Metodika e gjuhës amtare për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore*, Prishtinë, 1971, f. 28.

Në etapën e dytë – përpunohen në mënyrë praktike 10 shkronjat dhe tingujt që vijnë sipas renditjes së Abetares. Në rrokje si vështirësi të re kanë leximin dhe shkrimin e tyre me dy bashkëtingëllore njëra pas tjetrës. Mësohen të lexojnë fjalë dyrrrokëshe me të dytën të mbyllur (*pu-non*), fjalë trirrokëshe të hapura (*ko-she-re*, *mu-sha-ma*), fjalë dyrrrokëshe me të dytën të mbyllur në zanoren **ë** (*a-rën*); fjalë dyrrrokëshe që fillojnë me bashkëtingëllore e që mbarojnë me zanore (*lo-dra*, *dhë-mbi*), por rrokjet e dyta që kanë grup bashkëtingëlloresh.

Në etapën e dytë nxënësit lexojnë tekste më të vështira që përbëhen prej 4–8 fjalish, shkruajnë fjalë dhe fjali që kanë shkronja të reja. Si rezultat i punës që bëhet në etapën e dytë, fëmijët përvetësojnë praktikisht një seri rregullash të ortografisë, si: të shkruajnë fjalë të ndara nga njëra–tjetra; të shkruajnë para-fjalën veç nga fjalët; të ndajnë fjalët më të thjeshta në fund të rreshtit; të vënë pikën në fund të fjalisë; të fillojnë me shkronjë të madhe emrat e njerëzve dhe fjalitë.

Etapë e tretë – zhvillon në mënyrë praktike edhe 14 shkronjat dhe tingujt që vijnë sipas renditjes së Abetares. Veçori karakteristike të cilës i ka kushtuar rëndësi profesori Xhevat Gega në këtë etapë është rrënjësja e shkathtësisë për të lexuar dhe shkruar fjalë me 3–4 rrokje të vështirësive të ndryshme. Në fillim të etapës së tretë, nxënësit duhet të lexojnë lirisht rrokjet e hapura dhe të mbyllura me shkronjat që kanë mësuar. Gjatë punës me tinguj është mirë të bëhet krahasimi i disa tingujve si, p.sh. **f** me **th**, **s** me **z**, **l** me **ll**, **ll** me **dh** etj.

Një vëmendje të veçantë prof. Gega i ka kushtuar ushtrimeve të rrokjeve që kanë bashkëtingëllore njëra pas tjetrës, si në leximin e

tyre ashtu edhe në shkrim, mbasi këto rrokje paraqesin vështirësi për fëmijët, si p.sh.: *lis – plis, shtati – fshati, guri – gruri*.

III. *Periudha e tretë* lidhet me përforcimin e teknikës së lexim–shkrimit, kjo periudhë ndryshe njihet si *Pasabetarja*. Pas mbarimit të të gjitha shkronjave, në fund të Abetares, prof. Gega ka pasqyruar tekste me tematika nga më të ndryshmet, ku nxënësit ushtrojnë të lexuarit, me anë të copave të leximit që janë dukshëm më të gjata e më të pasura nga ana e brendisë. Një rëndësi të veçantë kanë ushtrimet që ka paraqitur prof. Gega për lexim korrekt, të vetëdijshëm e me shpejtësi mesatare. Nxënësi duhet të ushtrohet të lexojë me intonacionin e duhur e të kuptojë çdo gjë që lexon. Të vazhdohet rregullisht analiza fonetike e rrokjeve dhe e fjalëve të vështira e të reja, duke përdorur mënyrat kryesore të analizës dhe të sintezës. Stërviten që t'u përgjigjen pyetjeve të mësuesit ose atyre në fund të copave të leximit, duke u mbështetur në brendinë e asaj që lexojnë.

Zbatimi me mjeshtëri i metodës analitiko–sintetike në Abetaren e prof. Xhevat Gegës, siguron këto efekte pozitive në mësimin e shkronjave dhe lexim–shkrimin fillestar:

- ndihmon njohjen më të mirë të nxënësve me strukturën fonetike të tekstit, të fjalive e fjalëve.
- lehtëson kuptimin më të mirë të përmbajtjeve që lexon.
- kontribuon edhe për zotërimin më të lehtë të shkathtësisë së shkrimit, duke i njohur nxënësit me strukturën grafike të fjalëve e fjalive.

Si rrjedhojë e këtij mbarështrimi, mund të themi se kontributi më i rëndësishëm i profesor Gegës në fushën e arsimit është pasuria e madhe që ai ka krijuar si hartues i Abetares, programeve e teksteve shkollore, që përbëjnë një bazë të fuqishme metodike dhe

shkencore për zhvillimin e arsimit fillor, të mesëm dhe të universitar.

Me hartimin dhe realizimin e Abetares, profesor Gega e vuri Maqedoninë në radhën e vendeve të qytetëruara, duke treguar se ky vend i vogël ka një popull me karakteristikat e tij, me gjuhën dhe zakonet e veta dhe me një thesar të trashëguar nga brezat, prandaj me të drejtë mund të thuhet se prof. Gega i ngriti një ndërtesë madhështore jo vetëm gjuhës e kulturës shqiptare, por edhe mbarë qytetërimin kombëtar.

Bibliografia:

Gega, Xhevat. (1970). *Abetare – zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Gega, Xhevat. (1986). *Abetare – zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Gega, Xhevat. (2000). *Abetare – zhvillimi veçmas i shkronjave të shtypit e të dorës*, Shkup.

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. (1971). *Metodika e gjuhës amtare për shkollën normale dhe për mësuesit e shkollës fillore*. Prishtinë.

S. Hoxha, L. Franja, H. Podgorica. (1973). *Metodika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme pedagogjike*, Tiranë.

https://www.academia.edu/35836533/Konferenc%C3%AB_Mesonjetorja.pdf, shkarkuar me 20.08.2021.

<https://www.radiokosovaelire.com/prof-dr-shefik-osmani-prof-as-dr-njazi-kazazi-abetaret-e-para-shqipe-dhe-trajektorja-historike-e-tyre/>, shkarkuar më 20.08.2021.

https://www.ribashkimi.com/Simboli/Gjuha_Shqipe/3.pdf, shkarkuar me 20.08.2021.

LINDITA AHMETI

Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup

EROTIKA SI HARMONI E BOTËS NJERËZORE

(Rreth zgjedhjes “Lirika erotike shqipe I”, Sh. B. “Vatra”, 1995, Shkup, të Prof. Dr. Xhevat Gegës)

Prof. dr. Xhevat Gega i takon brezit të dytë të intelektualëve shqiptarë të Maqedonisë, të cilëve nuk u jepej hapësira që e meritonin për ta realizuar talentin e tyre dhe thuajse të gjithë këta intelektualë deshën apo s’deshën kanë qenë të detyruar ta fillojnë punën kryesisht si mësues nëpër fshatra.

I dhënë pas dijes, dy vjet pas punës si mësues, prof. dr. Xhevat Gega, pra në vitin 1953, regjistrohet në Fakultetin Filozofik të Beogradit, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, të cilin e mbaron në vitin 1957. Pas mbarimit të fakultetit karriera e prof. dr. Xhevat Gegës merr udhë të tjera: punon si profesor në shkollën normale “Zef Lush Marku” dhe si bashkëpunëtor i jashtëm ligjërën gjuhën shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike (me vonë Akademia Pedagogjike) në Shkup. Përveç kësaj, ka ushtruar edhe detyra të tjera – redaktor në “Flakën e vëllazërimit”, ku katër vjet ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës. Përfundimisht angazhohet si ligjërues i rregullt në Fakultetin e Filologjisë në Shkup – Grupi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Siç po shihet, veprimtaria e tij është e gjithanshme, por preokupimi dhe suksesi më i madh i tij do të mbetet puna pedagogjike. Ai ka botuar një varg tekstesh shkollore dhe ka

përkthyer shumë tekste të tjera të kësaj natyre nga maqedonishtja dhe serbishtja.

Prof. dr. Xhevat Gegën e tërhiqte mjaft edhe letërsia dhe në këtë drejtim zënë vend studimet kushtuar Filip Shirokës e Luigj Gurakuqit, Naim Frashërit, Jeronim de Radës e Sterjo Spasses, kurse vepër qendrore e tij do të mbetet disertacioni i doktoratës “Letërsia e nacionalitetit shqiptar në Republikën e Maqedonisë 1945 – 1985”. Këtu medoemos duhet të theksojmë se ai ka qenë shumë i kujdesshëm për rëndësinë që kanë vlerat e traditës sonë letrare dhe në këtë kontekst janë përcaktimet për temat të cilat i ka hulumtuar. Natyrisht, një libër që meriton një vend të mirë në raftet e bibliotekave tona është “Lirika erotike shqipe I”. (Autori me siguri është përgatitur ta bëjë edhe vëllimin e dytë të këtij libri).

Ky është portreti i shkurtër krijues i prof. dr. Xhevat Gegës.

Por, çka më shtyn mua që ta them ndonjë fjalë, të shpreh ndonjë mendim modest, ose t’i përgjigjem pyetjes se pse prof. dr. Xhevat Gega i hyri punës ta bëjë një përmbledhje/zgjedhje të poezisë erotike shqipe? E para është se poezia shqipe i arriti sukseset e saj më të mëdha në kohën e Rilindjes Kombëtare dhe si e tillë si preokupim kryesor kishte çlirimin e tokave shqiptare, krijimin e shtetit shqiptar dhe shpëtimin e gjuhës shqipe, që do të thotë se ishte një poezi e angazhuar. Ky “fat” do ta ndjekë poezinë shqipe edhe më tutje, për shkak të paraqitjes së realizmit socialist kur poezia duhej t’u nënshtrohej kërkesave ideologjike dhe politike që është në kundërshtim me mendimin e Pol Valerisë, i cili thotë: “Ideja *Poezi* shpeshherë i kundërvihet idesë *Mendim* e veçmas

idesë *Mendim abstrakt*".⁶⁴ Në këtë kontekst duhet të themi se poezia erotike, si një kategori e idesë *Poezi*, në letërsinë shqipe ka mbetur pak e lënë anash, le të themi – në margjina për shkak se prej poezisë është kërkuar më shumë "Mendimi" sesa "Poezia" që do të thotë se është kërkuar në radhë të parë realizimi i një ideje kolektive, diçka që lidhet me "Mendimin" kolektiv, me ideologjinë, dhe Erosi, pra bota intime, universi i emocioneve të njeriut, ka mbetur në plan të dytë. Me një fjalë, në krijimtarinë poetike shqipe më pak vend kanë gjetur Erosi e Afërdita, këta patronë aq të rëndësishëm të ndjenjave fisnike të dashurisë. Lidhur me këtë, prof. Xhevat Gega në parathënien e librit vë në dukje se dashuria synon harmoninë e jetës njerëzore. Nuk ka brenda saj triumfalizëm, ekzagjerime të natyrave të ndryshme. Poezia erotike në të vërtetë është poezia më e dashur, më e kërkuara dhe më e lexuara kudo dhe e tillë ka qenë gjatë gjithë historisë, sepse ajo është lirika më e kulluar.

Këto do të jenë arsyet që prof. Xhevat Gega i ka hyrë punës për përpilimin e zgjedhjes me titull "Lirika erotike shqipe I". Në këtë libër janë përfshirë autorët nga koha e humanizmit e deri në kohën para fillimit të Luftës së Dytë Botërore, pra nga Mikel Maruli (1453–1500) deri te Migjeni (1911–1938).

Prof. Xhevat Gega ka qenë i vetëdijshëm se poezia e shkruar erotike shqipe është vëllimisht shumë më e vogël se lirika erotike gojore, e cila vjen nga potencialet e mëdha krijuese të këngëtarëve popullorë. Po kjo e fundit kërkon punë në terren që të mblidhet e të ruhet, sepse edhe brenda saj gjejmë margaritarë të rrallë. Fatkeqësisht, punën në terren e kanë penguar rrethanat ekonomike

⁶⁴ Pol Valeri, *Poezia i abstraktno mišljenje; Radanje moderne književnosti* 'Poezija, Beograd, 1975, f. 253.

dhe politike në tërë hapësirën etnike shqiptare, kështu që edhe kjo lirikë mbetet njafit e cunguar dhe një pjesë e madhe e saj ka mbetur thuajse e humbur përgjithmonë.

Sado e bukur qoftë poezia gojore, ajo nuk mund të “matet” me poezinë e shkruar për shkak se poezia e shkruar ka autorë të njohur, të arsimuar, dhe që janë njohës të mirë të poezisë së shkruar që nga antika e këndej. Veç kësaj poetët i kanë respektuar të gjitha rregullat e poetëve të njohur të së kaluarës të Perëndimit dhe Lindjes.

Megjithatë, çdo poezi kombëtare rrënjët e veta i ka në këngën popullore. Por nuk mbetet pa ndikime nga poezia e madhe perëndimore dhe lindore. Kjo shihet edhe te autorët që kanë gjetur vend në zgjedhjen që e ka bërë prof. Xhevat Gega.

Zgjedhja fillon me dy poezi të humanistit Mikel Maruli. E para “Akcsinqerit” (I,25) dhe e dyta “Mbi Leukoten” (I,26) që janë poezi tipike të ndikuara nga poezitë e kohës së artë të Augustit kur kanë shkruar poetët më të mëdhenj të gjuhës latine. Janë këto poezi shumë të bukura ku dashuria e një djali për vajzën del si provë më e madhe se lufta me shpata e heshta dhe vuajtjet që i shkakton ajo janë thuajse të papërshkrueshme. Në frymën e lirikëve latinë është poezia “Akcsiqnerit” (I, 25) e Marulit, por ndjehet në të fuqia e madhe e Amorit romak i cili di të jetë më i tmerrshëm se luftërat, nga tërbimi i detit dhe nga shtrëngatat. Këto janë të përballueshme për autorin, por jo kur “...ajo vajzë që mund të më mohojë, kur ta dua”. Të të refuzojë, të të sprapsë ajo vajzë që ti i ke lejuar të bredhë lirshëm nëpër ëndrrat tua plot trëndafila, kjo është shumë për poetin. Ky është halli më i madh. Këtu Maruli e gjen

ëmbëlsinë⁶⁵ dhe forcën që ka dashuria dhe këtu gjendet edhe lirika e pastër. Vuajtjet e Marulit për vajzën që e do dhe nuk ia del t'ia pushtojë zemrën i gjejmë edhe në poezinë e tij me titull “Mbi Leukoten”. Poezi tipike ku përshkruhet vuajtja e thellë e poetit për dashurinë e tij të pafat. Pena e Mikel Marulit është një nismë e mirë për ngritjen e një këshjtjelle të madhe letrare. Por nuk ndodhi kështu. Për fat të keq, pas Mikel Marulit do të ketë një “heshtje” të gjatë të lirikës erotike. Ose, dora e hulumtuesve tanë shkencorë nëpër arkivat dhe bibliotekat e mëdha, nuk ka arritur t'i shfletojë e t'i gjejë krijimet letrare nga e kaluara. Dhe, kështu të pasurohet fondi i krijimeve të njerëzve tanë, fond dhe krijime këto të bëra ndër shekuj.

Ndërkohë, situata politike me shumë luftëra në trojet tona nga koha e humanizmit e më pas bën që poezi erotike të ketë rrallë e më rrallë deri në paraqitjen e bejtexhinjve ku dallohen Sulejman Naibi e Hasan Zyko Kamberi. Ia vlen të ndalemi te disa vargje të Sulejman Naibit, i cili pa dyshim është poeti më i mirë i erotikës i kohës së bejtexhinjve. Janë tri poezi që prof. Xhevat Gega i ka përfshirë në antologjinë e tij: “Bandilli i djegurë”, “Kumria në kafast” dhe “Mahmudeja e stolisurë”. Që të tria këto poezi janë lirika të kulluara, ku na dalin në shesh plotësisht ndjenjat fisnike të S. Naibit. Le ta shohim vetëm një strofë të poezisë “Bandilli i djegurë”:

...Të këndonj për qafën, të këndonj për supat,

Për krahët e llërët, dritë e ergjënd;

⁶⁵ Xhevat Gega, Lirika erotike shqipe, Vatra, Shkup, f. 15.

Të këndonj kraharorin, për ato dy kupat

*Që një botë të tërë e kanë lëni pa mënd...*⁶⁶

Kjo vjershë tregon se S. Naibi është një poet i veçantë. Gjykuar sipas fuqisë krijuese të këtij autori, mund të themi se është fyes, mospërfillës termi bejtexhi për të tre poetët e përfshirë në antologji nga ana e prof. Xhevat Gegës. Është meritë e prof. Xhevatit që këta poetë i ka përfshirë në këtë antologji, duke e mënjeluar kështu sadopak kuptimin fyes që ka marrë fjala bejtexhi. Ndoshta kjo pse kanë shkruar në alfabetin arab ose pse janë krijime nën ndikimin e poezisë së lindjes.

Vargu i S. Naibit është i bukur dhe i pastër. Ai me përshkrim të drejtpërdrejt i këndon bukurisë së vajzës që e dashuronte. Por nuk mungojnë këtu metaforat të fuqishme: “Dritë e ergjënd”, Gjyl (trëndafili), bilbili etj. Vargu i butë e i ndjeshëm, na e sjell para vetes bukurinë e paparë të vajzës. Me këtë forcë krijuese janë edhe dy vjershat e tjera të Sulejman Naibit “Kumria në kafast” dhe “Mahmudeja e stolisurë”. E vetnja vërejtje të cilën do të kishte mundur t’ia bëjë lexuesi janë orientalizmat, të cilat i ka edhe Hasan Zyko Kamberi, i cili është përfshirë me një poezi, e cila nuk e ka fuqinë e poezive erotike të Sulejman Naibit.

Përsëri poezia e shkruar, veçanërisht ajo erotikja, haset gjithnjë e më rrallë deri në kohën e romantizmit të cilit i prin Jeronim de Rada i madh me “Këngët e Milosaos” dhe me “Serafina Topinë”. Pasojnë Frano Anton Santori me “Këngëtoren arbërore”, Gavril Dara i Riu me “Këngën e sprasme të Balës”, Zef Serembe me

⁶⁶ Xhevat Gega, *Lirika erotike shqipe*, Vatra, Shkup, 1995, f. 16.

përmbledhjen “Vjersha”, nga e cila prof. Xhevat Gega me të drejtë zgjedh shumë vargje sepse, sa i përket poezisë erotike, Zef Serembe mbetet njëri ndër poetët më të mëdhenj deri në ditët e sotme.

Nga rilindësit e tjerë, prof. Xhevat Gega i prezanton me mjaft vargje poetin tonë kombëtar Naim Frashërin, pastaj Çajupin, Mihal Gramenon, Hilë Mosin, Risto Siliqin, Asdrenin, Fan Nolin, Ali Asllanin e Lasgush Poradecin, duke e mbyllur zgjedhjen me Migjenin. Për këta poetë dhe për rilindësit e hapësirës etnike të Shqipërisë së sotme politike është shkruar shumë. Për ta do të duhej të bëhen kërkime të tjera.

Ndonëse e pakët kjo poezi në thesarin e letërsisë shqipe, autorët e saj të përfshirë në këtë zgjedhje kanë lënë gjurmë të rëndësishme dhe bashkë me erotikën popullore do të bëhen guri themeltar i rritës së poezisë së mëvonshme erotike shqipe të cilën do ta lërojnë me sukses Dritëro Agolli, Azem Shkreli, Ali Podrimja e të tjerë. Po me këtë rast me rëndësi të dorës së parë është kjo zgjedhje ku poetët e brezave të ndryshëm i këndojnë të dashurës së tyre. Aty përshkruhet bukuria magjike e femrës. Pason zjarri i dashurisë që i djeg poetët brenda. Pra, kështu ngrihet lart poezia erotike që, siç e thamë edhe më lart, në thelb është lirikë e kulluar. Këtu poeti, krahas poezisë patriotike, e shpreh me shqetësimin e tij patosin dhe ndjenjën më solemne dhe sublime e cila përjetohet nga shigjeta e Erosit.

Këtë shkrim të shkurtër po e përfundoj me fjalët e Dilan Tomasit i cili, duke folur për poezinë lirike, thotë: “Ajo doemos duhet të

nxjerrë në dritë shumë më tepër shkaqe se sa që do t'i kishte marrë me mend Frojdi”.⁶⁷

Kjo thënie i përgjigjet më së miri punës së Prof. Xhevat Gegës për përpilimin e kësaj zgjedhjeje. Me fjalë të tjera, autori i kësaj vepre i ka rënë pikës qendrore duke na dhënë një pasqyrë të shkurtër të erotikës së shkruar shqipe, të kësaj poezie aq të rëndësishme.

Bibliografia:

Gega, Xhevat. *Lirika erotike shqipe I*, Vatra, Shkup, 1995.

Tomas, Dilan. *Pisma, Rađanje moderne književnosti – Poezija*, Beograd, 1975.

Valeri, Pol. *Poezija i abstraktno mišljenje; Rađanje moderne književnosti – Poezija*, Beograd, 1975.

⁶⁷Dilan Tomas, *Pisma, Rađanje moderne književnosti - Poezija*, Beograd, 1975, f. 373.

SHTOJCË
FOTO – ALBUM



Xhevat Gega në vitet e rinisë



Xhevat Gega në vitet e rinisë



Xhevat Gega në mesin e kolegëve dhe studentëve





Xhevat Gega në mesin e kolegëve





Xhevat Gega me bashkëshorten



Xhevat Gega (1934 – 2017)

Botues:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 34 – 2022
FIGURA POLIEDRIKE E PROFESOR XHEVAT GEGËS

Kryeredaktore: Hidajete Azizi
Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: DataPons – Shkup
Rr. 1550, nr. 52, Vizbeg

Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion i SCUPI-t botohet me vendimin e Këshillit të
ITSHKSH–Shkup, nr. 0201-109/4, të datës 24.01.2022, si pjesë e
programit të punës së Institutit për vitin 2022.*

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

811.18:929Гера, Џ.(062)
821.18:929Гера, Џ.(062)

FIGURA poliedrike e profesor Xhevat Gegës : (tribunë shkencore –
1 shtator 2021) / [kryeredaktor Hidajete Azizi]. - Shkup : Instituti i
trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2022. - 194 стр. :
илустр.; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v. 34)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4897-57-6

а) Гера, Џеват, 1934-2017 -- Албански јазик и книжевност -- Собири

COBISS.MK-ID 57375493